





# ANALIZË

## KORNIZË JURIDIKE, RESURSEVE DHE PROCESIVE DHE KOMPETENCAVE TË TJERA NË SISTEMIN E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT FORMAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

---

GJENDJA NË VITIN 2018

---

## Falënderim

Autorët u falënderohen të gjithë bashkëpunëtorëve të përfshirë në procesin e realizimit të hulumtimit, veçanërisht shkollave, përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale dhe punëdhënësve, si dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, të cilët me përgjigjet e tyre të instrumenteve të llojllojshme mundësuan që të sigurohen të dhëna relevante për gjendjen.

Autorët i janë falënderues edhe Njesisë së Projektit të E4E@mk, veçanërisht Anica Aleksovës dhe Nadire Latifit për këshillat praktike dhe për mbështetjen profesionale.

## Autorë

Misho Dokmanoviq, PhD

Darko Spasevski, PhD

Katerina Shapkova Kocevaska, PhD

Sanja Giçevska, M.A.

## Dizajn

Zoran Runçev - Runo

Kjo analizë është përpiluar nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim – IHSE. Qëndrimet e shprehura në këtë analizë janë të autorëve dhe nuk është e thënë të përputhen me mendimet dhe politikën e Projektit, organizatave që e implementojnë projektin dhe donatorit

# SHKURTESA

- APRM** – Agjencia për Punësim
- BZHA** – Byroja për Zhvillimin e Arsimit
- QSHP** – Qendra Shtetërore e Provimeve
- ISHA** – Inspektorati Shtetëror i Arsimit
- KE** – Komisioni Evropian
- BE** – Bashkimi Evropian
- LBZHA** – Ligji për Byronë për Zhvillimin e Arsimit
- LAL** – Ligji për Arsimin e Lartë
- BNJVL** – Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
- LZ** – Ligji për zejtarin
- LARR** – Ligji për Arsimin e të Rriturve
- LUHQ** – Ligji për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm
- LIA** – Ligji për Inspektoratin e Arsimit
- LAM** – Ligji për Arsim të Mesëm
- LATP** – Ligjin për Arsim dhe Trajnim Profesional
- MASH** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- MPPS** – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
- RMV** – Republika e Maqedonisë së Veriut
- ATP** – Arsim dhe Trajnim Profesional
- SHMP** – Shkolla të Mesme Profesionale
- QAMP** – Qendra për Arsim të Mesëm Profesional
- QARR** – Qendra për Arsimin e të Rriturve

# KONSTATIME THEMELORE NGA HULUMTIMI

## Qëllimi i hulumtimit

Hulumtimi i situatës para fillimit të projektit kishte për qëllim që të përpilohet një analizë e gjendjes aktuale dhe sfidave me fokus të posaçëm në kornizën juridike, resurset, si dhe proceset dhe kompetencat tjera në arsimin formal profesional në rajonet dhe sektorët qëllimorë në Maqedoninë e Veriut.

## Më konkretisht

1. Të hetohen trendët aktuale në arsimin e mesëm profesional në 7 sektorë qëllimorë (shëndetësi dhe përkujdesje sociale, shërbime personale, hotelieri, sektor bujqësor, sektor ushqimor-teknologjik, makineri dhe IT sektor) në 4 rajone të planifikuara në shtet (Juglindor, Jugperëndimor, Pollogdhe Shkup);
2. Të analizohet korniza juridike në të cilën realizohet arsimi dhe trajnimi i mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë dhe të formulohen rekomandime për përmirësimin e tij për zhvillimin e shkathtësive profesionale;
3. Të hetohet financimi, burimet, shumat dhe resurset e tjera financiare që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnimin formal profesional, si dhe shpërndarjen/shfrytëzimin e tyre.

## Realizimi i hulumtimit

Lidhur me kornizën ligjore, ekipi hulumtues bëri një analizë të hollësishme të 17 ligjeve, 11 strategjive dhe dokumenteve konceptuale, 24 akteve mbikëqyrëse, normativeve dhe standardeve, dokumenteve programore, raporteve dhe dokumenteve të tjera relevante.

Për grumbullimin e të dhënave janë përdorur në përgjithësi 4 lloje të instrumenteve:

1. kërkesë-përjasjederiteinformacionet e karakterit publikpërshkollat;
2. kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik për komunat;
3. pyetësor për anketë elektronike të punëdhënësve që bashkëpunojnë me shkollat dhe

4. intervista gjysmë të strukturuar për institucionet kryesore të niveleve të ndryshme.

Lidhur me resurset dhe situatat, me kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik ekipi hulumtues u është drejtuar 30 shkollave të mesme profesionale dhe 11 komunave, gjegjësisht të gjitha shkollave dhe komunave nga rajonet qëllimore të projektit.

Në hulumtimin empirik janë grumbulluar informacione për implementimin e kornizës ligjore përmes intervistave nga tetë shkolla, gjegjësisht prej gjithsej katër komunave dhe janë realizuar intervista me 30 bashkëbisedues nga bartësit kryesor të intereseve.

Ndonëse të dhënat janë grumbulluar prej më shumë se 30% të shkollave të mesme profesionale dhe më shumë se 25% të komunave dhe Qytetit të Shkupit, në të cilat ka shkolla të mesme profesionale, të dhënat lidhur me financimin nuk mund të përgjithësohen.

Analiza e kornizës juridike me të cilën rregullohet arsimi dhe trajnim profesional tregoi disa të dhëna dhe konstatime kryesore që janë të lidhura ngushtë me mandatin e projektit, të cilat janë sublimim i përgjithshëm i pasqyrës së përgjithshme edhe atë:

Së pari, ekzistojnë një numër i madh i ligjeve, të cilat vetëm se e dispersojnë dhe segmentojnë materien, që rezulton me jokonsistencë në zbatimin e tyre dhe humbet koherenca që duhet ta kenë (Ligji për arsim të mesëm, Ligji për arsim e lartë, Ligji arsim dhe trajnim profesional, Ligji për arsimin e të rriturve, Ligji për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm, etj.). Nga këtu, mendimet dhe rekomandimet tona janë në drejtim të miratimit të rregullës së sublimuar ligjore që do t'i integrojë të gjitha format e arsimit dhe trajnimit profesional;

Së dyti, numri i madh i ligjeve rezulton me formimin e një numri të madh të institucioneve dhe trupave këshillëdhënës që mbulojnë arsimin dhe trajnimin profesional në të shumtën e rasteve me kompetenca të papërkufizuara. Nga këtu, nuk shihet se cili prej këtyre institucioneve në terren e ka rolin e koordinatorit dhe kryesuesit. Ndonëse supozohet se kjo është kompetencë e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional, kjo duhet të jetë e rregulluar në mënyrë të qartë dhe të saktë në rregullat e ndryshme ligjore;

Së treti, mungojnë rregulla të sakta dhe formale juridike me mekanizma dhe programe të definuara qartë për mbështetje financiare dhe logjistike nga organet shtetërore dhe vetëqeverisjet lokale të ofertuesve dhe organizatorëve të arsimit dhe trajnimit profesional;

Së katërti, korniza ekzistuese nuk është e përshtatur sa duhet me nxënësit, gjegjësisht pjesëmarrësit me nevoja të posaçme arsimore. Nuk ekzistojnë norma të posaçme ligjore që detyrimisht do të kërkojnë sigurimin e kushteve të nevojshme për realizimin e arsimit dhe trajnimit profesional për këtë kategori të personave, e që janë në drejtim të sigurimit të kushteve të përshtatura në mënyrë përkatëse për trajnim praktik te ndonjë punëdhënës, si dhe sigurim të mjeteve përkatëse mësimore dhe konkretizuese, e para së gjithash teksteve shkollore, dhe

Së pesti, nuk ekziston koordinim mes organeve kompetente inspektuese në pjesën e gjithëpërfshirjes së vëzhgimit. Kjo veçanërisht shihet në pjesën e mbulimit të mbikëqyrjes në pjesën e kushteve për siguri gjatë punës gjatë trajnimit praktik te punëdhënësi, si dhe në pjesën e ndjekjes së cilësisë së trajnimit praktik që e organizojnë punëdhënësit.

Në tabelën A janë dhënë sipas komponentëve, konstatimet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e kornizës ligjore të arsimit të mesëm profesional.

**TABELA A: KONSTATIME DHE REKOMANDIME KRYESORE PËR PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE**

Komponentë	Konstatime	Rekomandime
OFERTUES	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bartës më të rëndësishëm të arsimit dhe trajnimit profesional janë shkollat e mesme profesionale. Ofertuesit e tjerë marrin pjesë me vëllim shumë më të vogël. Të njëjtit nuk kanë në dispozicion resurse të mjaftueshme.</li> <li>Iniciativat private dhe ofertuesit privat (atje ku është e mundur në përputhje me ligjin aktual nuk janë zhvilluar fare).</li> <li>Nuk ekzistojnë ofertues të themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, përveç shkollave të mesme profesionale.</li> <li>Mjetet që ndahen nga shteti për nxitjen dhe mbështetjen e ofertuesve janë të pakonsiderueshme, thuhet nuk ekzistojnë (përveç mjeteve të buxhetit për arsimim të detyrueshme të mesëm profesional).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillim i ofertuesve ekzistues të arsimit dhe trajnimit profesional dhe themelim të ofertuesve të rinj përmes nxitjes së iniciativës te bashkësia afërisht dhe vetëqeverisja lokale. Të përkufizohen me ligj mënyrat konkrete të mbështetjes së këtyre subjekteve (ndihmë shtetërore, subvencione, lehtësime, lirim prej taksave dhe kompensimeve për verifikimin e programeve dhe investimeve, etj.).</li> <li>Zhvillim i partneritetit publik privat në pjesën e themelimit dhe organizimit të ofertuesit.</li> <li>Nxitje të themelimit të shkollave të mesme private profesionale.</li> <li>Vendosje të konceptit të vetëvlerësimit të orientimit personal të tregut të ofertës së ofertuesvetë arsimit formal dhe joformal në periudhë të caktuar kohore.</li> </ul>

## PLANE DHE PROGRAME MËSIMORE

- Në parim planet dhe programet mësimore nuk janë të përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe nuk janë të harmonizuara me zhvillimin tekniko-teknologjik në aspektin e përfshirjes së mjeteve konkretizuese dhe mësimore dhe mjeteve ndihmëse.
- Nuk ekziston lidhje formale mes kreatorëve të planeve dhe programeve mësimore dhe bashkësisë afariste.
- Në konceptimin për modernizimin e arsimit teknik janë potencuar nevoja dhe mënyrat e bashkëpunimit me bashkësinë afariste, por mungon implementimi. Ekzistojnë disa përgjashime të caktuara, por ato janë zgjidhje stihike dhe ad-hoc.
- Përveç analizave të tregut të punës nga Agjencia për Punësim, nuk ekzistojnë analiza të tjera më serioze veçanërisht në nivel lokal në kuadër të njësisë së vetëqeverisjes lokale.
- Te një pjesë e programeve mësimore, vëllimi i lëndëve profesionale dhe trajnimit praktik është më i vogël, në krahasim me lëndët e përgjithshme arsimore.
- Ridizajnim të planeve dhe programeve mësimore.
- Rishqyrtim i dimensionimit të lëndëve të përgjithshme arsimore deri në nivelin që është i nevojshëm për nxënësit nga sektorët e analizuar në arsimin profesional.
- Rritje e numrit të lëndëve profesionale si dhe rritje të vëllimit të trajnimit praktik dhe vendosje të peshës pikërisht në pjesën profesionale dhe praktike

## KAPACITETE TË SHKOLLAVE DHE MËSIMDHËNËSVE

- Shkollat e mesme profesionale në përputhje me Ligjin për Arsim të Mesëm nuk kanë pavarësi të madhe në menaxhimin dhe marrjen e vendimeve. Në këtë drejtim janë të lidhura fortë me themeluesin (komunën) dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Këshilli i shkollës është organ drejtues i shkollës dhe si lidhje me bashkësinë afariste në të shumtën e rasteve tregohet si joefikase. Anëtari i bashkësisë afariste është vetëm formalisht pjesë e Këshillit, ndonëse shumë rrallë merr pjesë në punën e Këshillit dhe në marrjen e vendimeve. Përfshirja e përfaqësuesve të prindërve në Këshillin me iniciativa të tyre është e pavërtetë.
- Nuk ka trajnime të mjaftueshme të mësimdhënësve të cilët marrin pjesë në arsimin e mesëm profesional. Thuajse nuk ekzistojnë trajnime në të cilat mësimdhënësit kanë mundësi drejtpërdrejt të përvetësohen me sendërtim te punëdhënësit (madje edhe në komplekset e mëdha industriale).
- Duke marrë parasysh specifikat për menaxhim të shkollave të mesme profesionale, nuk ekzistojnë trajnime të posaçme për menaxhmentin e këtyre shkollave, të harmonizuara me nevojat e të njëjtëve.
- Rritje të nivelit/të drejtës së vendim-marrjes nga shkollat (veçanërisht në pjesën për lidhje më të madhe me bashkësinë afariste).
- Mundësimin e së drejtës së votës për përfaqësuesin e bashkësisë afariste në Këshillin e shkollës. Rritje të numrit të përfaqësuesve nga bashkësia afariste në këshillat e shkollës (në dy përfaqësues).
- Krijim i strategjisë për pjesëmarrje më aktive në punën e këshillit të shkollës të përfaqësuesve të prindërve, si dhe vendosje të anëtarit të Këshillit të shkollës nga nxënësit.
- Parashikim i dispozitës në Këshillin e shkollës, që në shkollë të mesme profesionale të ketë detyrimisht përfaqësues të mësimdhënësve që japin lëndë profesionale/mësim praktik.
- Rekomandohet që përfaqësuesit në Këshillin e shkollës të deleguar nga themeluesi (vetëqeverisja lokale ose shteti), të jenë të ndërlidhur me procesin arsimor (më konkretisht, me arsimin e mesëm profesional).
- Ndërmarrje të masave të posaçme për përmirësimin e kapaciteteve të mësimdhënësve që janë të obliguar për lëndët profesionale dhe menaxhmentin e shkollave përmes pjesëmarrjes më të madhe të tyre në trajnime.

### NXËNËS ME NEVOJA TË POSAÇME

- Në përgjithësi, shkolla dhe ofertuesit e tjerë nuk kanë kapacitete t'u përgjigjen nevojave të nxënësve me nevoja të posaçme.
- Financimi i këtij segmenti është shumë i vogël.
- Planet dhe programet mësimore nuk janë të përshtatura me specifikat e nxënësve me nevoja të posaçme.
- Mungojnë mjete përkatëse ndihmëse për pjesëmarrje më të madhe të këtyre nxënësve.
- Nxënësit me nevoja të posaçme përballen me probleme në, qasjen në shkollë, qasjen dhe kushtet në konviktet (kapshëmëria e transportit, etj.).
- Nuk vërehen mundësi për trajnim praktik te punëdhënësi i përshtatur me specifikat e nxënësve me nevoja të posaçme të cilët janë të përfshirë në shkollat e mesme profesionale.
- Në një pjesë të madhe të shkollave mungojnë defektologë si dhe personel plotësues ndihmës.
- Vendosije të kornizës së saktë dhe konkrete për mbrojtjen e diskriminimit të nxënësve me nevoja të posaçme.
- Nevojitet implementim përkatës i konceptit të inkluzionit në Ligjin për Arsim dhe Trajnim Profesional.
- Vendosja e dispozitave për qasjen e nxënësve me nevoja të posaçme në objektet e arsimit dhe trajnimit profesional, në objektet e ofertuesve dhe te punëdhënësit e verifikuar (përmesushja e këtyre kushteve do të ishte bazë për marrjen e verifikimit).
- Plotësim i rregullave ligjore në pjesën e obligimit të detyrueshëm për përpunimin e materialeve të përshtatshme mësimore në përputhje me nevojat e nxënësve.
- Të mbahet llogari për vlerësimin cilësor të mundësive dhe aftësive të nxënësve me nevoja të posaçme.
- Angazhim i detyrueshëm i defektologëve dhe asistentëve për mbështetjen e shkollave.
- Forcimi i sistemit për mbështetje financiare për nxënësit me nevoja të posaçme dhe grupet tjera të marginalizuara (për shembull, përmes Ligjit për standard të nxënësve ose përmes ndonjë ligji tjetër ose përmes parimit „mjetet e ndjekin nxënësin”).

### ZHVILLIM I ARSIMIT PROFESIONAL PAS ARSIMIT TË MESËM

- Nuk ekzistojnë modalitete që i lidhin shkollat e mesme profesionale dhe ofertuesit e tjerë nga njëra anë, universitetet dhe institucionet e larta arsimore dhe bashkësinë afariste në një proces të vetëm të bashkëpunimit.
- Universitetet dhe fakultetet nuk i shfrytëzojnë format e ndryshme të rregulluara në Ligjin për arsim e lartë (byroinxhinierike, punëtori, qendra për këshilla juridike dhe afariste, qendra për punë sociale dhe ndihmë tjetër e qytetarëve, qendra provuese prodhuese, galeri, radio dhe TV stacione, parqe teknologjike) për ofrimin e formave të arsimit joformal profesional.
- Përfshirje e institucioneve të larta arsimore në procesin e arsimit profesional (përmes studimeve formale profesionale ose arsimit joformal).
- Për rritjen e potencialit për zhvillimin e arsimit profesional dhe orientim i politikave shtetërore, universiteteve që të shfrytëzojnë mundësinë e njësive të organizuara të brendshme në të cilat do të ndërliken praktika dhe dituria dhe në punën e së cilës mund të marrin pjesë edhe studentët.
- Forcimi të arsimit profesional pas arsimit të mesëm.

### ARSIM JOFORMAL

- Nuk ekziston lidhshmëri e dukshme e fuqishme mes bashkësisë afariste dhe universiteteve të hapura qytetare për mësim të përjetshëm. Këto universitete, nuk arrijnë që të lidhen më seriozisht veçanërisht me investitorët e mëdhenj të huaj.
- Harmonizim i dispozitave në Ligjin për universitete të hapura qytetare për mësim të përjetshëm me qëllim të përfshirjes së përfaqësuesve nga bashkësia afariste në këshillat drejtuese (së paku një). Kjo dispozitë do të mund të vlente edhe për universitetet e hapura private qytetare duke marrë parasysh faktin që edhe ato ushtrojnë veprimtari me interes publik.

## NXËNËS

- Në pjesën më të madhe nxënësve u është shkurtuar mundësia për trajnim efikas dhe efektiv praktik te punëdhënësi. Kjo pjesë shpesh realizohet në kabinetet e shkollës kushtet e të cilave nuk janë në përputhje me situatat dhe nevojat e punëdhënësve dhe nuk mund të jenë zëvendësim për trajnimin praktik te punëdhënësi.
- Lidhur me të drejtat e nxënësve, rregullat ekzistuese nuk e garantojnë të drejtën e kompensimit gjatë trajnimit praktik te punëdhënësi, e as nga ana tjetër, të drejtat e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, si dhe të drejtat e përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie të punës (për nxënës nën moshën 18 vjeçe).
- Përmbajtja e marrëveshjeve mes nxënësve (gjegjësisht pjesëmarrësve në trajnimin) dhe punëdhënësve nuk i përfshin të gjitha aspektet e nevojshme për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella.
- Të qenët çirak si proces për përvetësimin e shkathtësive dhe kualifikimeve në esencë është jashtë sistemit të arsimit dhe trajnimit profesional.
- Nuk ekziston vëzhgim dhe kontroll serioz dhe i organizuar i cilësisë (duke përfshirë edhe ato inspektuese) mbi realizimin e trajnimit praktik te punëdhënësi në kuadër të vetë vendit të punës.
- Ka institucione kur punëdhënësit i përdorin nxënësit për punë ndihmëse-teknike që janë jashtë programit dhe qëllimeve që duhet të realizohen me trajnimin praktik.
- Rregullim më i hollësishtëm dhe më i saktë i të drejtave të nxënësve dhe pjesëmarrësve në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional me rregullativë juridike, si dhe me zgjerimin dhe saktësimin e përmbajtjes së marrëveshjeve. Të vihet theksi në të drejtën e kompensimit, si dhe të drejtat e sigurisë gjatë punës (harmonizim dhe parashikim të zbatimit të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës), por edhe të drejtat e parashikuara në Ligjin për marrëdhënie të punës, më konkretisht pjesën XXIII.
- Të shqyrtohen mundësitë për subvencionimin e së drejtës së kompensimit të nxënësve dhe pjesëmarrësve në trajnimet në frymën e Ligjit aktual për veprimtari zeytare (pagesë të kompensimit mujor nga ushtruesi i veprimtarisë zeytare ose Buxhetit të RM-së përmes Planit Operativ për programe dhe masa aktive për punësim të APRM-së, ose projekte dhe burime të tjera).
- Vëmendje të posaçme gjatë dizajnimit të kornizës ligjore dhe përcaktimit të së drejtës së kompensimit duhet t'i kushtohet proporcionit me të drejtat nga papunësia.
- Rregullat obliguese duhet të përfshihen në marrëveshjen për rregullimin e marrëdhënieve mes pjesëmarrësve në procesin e arsimit. Rekomandohet që të përdoren përpunime të formularëve të standardizuar.
- Përmbajtja dhe përmbushja e marrëveshjeve në të gjitha aspektet duhet të jetë objekt i mbikëqyrjes më gjithëpërfshirëse inspektuese. Duhet gjetur zgjidhje më përkatëse për mbajtjen e regjistrave të marrëveshjeve (zgjidhja e tanishme tregon se nuk është sa duhet efikase dhe e plotë).
- Nevojitet të rregullohet në mënyrë më të hollësishtëm e drejta e mungesës nga puna për shkak të pjesëmarrjes në programin arsimor për të rritur, si dhe të bëjë dallimin kur nxënësi është i dërguar për trajnim nga punëdhënësi ose nga ana tjetër me iniciativë personale.
- Të përkufizohet strategji e veçantë për zhvillimin e zeytarisë në kontekst të arsimit të mesëm profesional dhe zyrtarizimit të kësaj forme të përvetësimit të kompetencave. Strategjia e tillë duhet të përkufizojë nëse të qenët praktikant do të afrohet drejt formave të LATP-së ose do të mbetet në këtë nivel.

### BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË AFARISTE

- Nuk ekziston lidhje sistemore efkase mes bashkësisë afariste dhe institucioneve shtetërore.
- Nuk ekziston harmonizim në planifikimin e potencialeve të arsimit profesional me nevojat e tregut të punës.
- Bashkësia afariste nuk i shqyrton sa duhet mundësitë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me shkollat profesionale dhe ofertuesit tjerë. Nuk ekziston lidhshmëri afatgjate (për shembull: nuk ekziston sistem serioz i dhënies së bursave nga bashkësia afariste që do t'i tërheqë nxënësit e mirë te punëdhënësit potencial). Në të shumtën e rasteve të gjitha iniciativat (në numër të vogël) në këtë drejtim paraqiten kur bashkësia afariste do të jetë e detyruar të sigurojë punëtorë dhe të njëjtat janë në formë të zgjidhjeve afatshkurtra.
- Zhvillim dhe avancim i shkathtësive ose kualifikimeve të nevojshme të menaxherëve për t'i dalluar përparësitë e trajnimit praktik të shkollarëve të mesëm në kompanitë.
- Saktësimi plotësues i dispozitave ligjore që parashikojnë përfshirje të përfaqësuesve të bashkësisë afariste në segmente të ndryshme të arsimit dhe trajnimit profesional duke i përfshirë edhe mundësitë për subvencionim.
- Duke marrë parasysh mundësitë e kufizuara të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që të paraqiten si punëdhënës në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional, rekomandohet harmonizim i kornizës ligjore në drejtim që këto subjekte të vogla të grupohen dhe të paraqiten së bashku si organizatorë të trajnimit praktik me qëllim që t'i racionalizojnë resurset e tyre.

### BASHKËPUNIM MES ORGANEVE SHTETËRORE

- Sistemi ka numër të madh të institucioneve shtetërore (ministri dhe trupa të tjerë) që shpesh herë vepron në mënyrë të paharmonizuar. Imponohet nevojë e identifikimit të lidhjen/bashkimit të tyre (kompetenca të shumta janë të përcaktuara në një ose dy institucione), me qëllim që të sigurohet koordinim dhe efikasitet i sistemit.
- Në nivel lokal nuk ekziston koordinim mes të gjitha palëve të interesuara, (komuna, bashkësi afariste dhe punëdhënës, shkolla, nxënësit, prindër, njësi rajonale të ministrive, etj).
- Vetëqeverisja lokale (komuna dhe Qyteti i Shkupit) janë anashkaluar, roli dhe rëndësia e tyre janë kufizuar në mënyrë të paarsyeshme në favor të organeve të pushtetit qendror.
- Në kuadër të institucioneve profesionale (BZHA, QATP, QARR, ISHA, QSHP) si dhe trupave profesionale (Këshillat në përputhje me Ligjin për arsimin profesional të të rriturve dhe Ligjin për arsim dhe trajnim profesional), trupat dhe komisionet kompetente (në përputhje me Ligjin për libra shkollorë), gjithashtu nuk ka bashkëpunim efikas, koordinim dhe sinkronizim.
- Është i domosdoshëm koordinimi dhe komunikimi më efikas mes organeve kompetente shtetërore. Ky sistem mund të ndërtohet përmes përkufizimit të organit të posaçëm të pushtetit (një ministri e caktuar) që do të jetë marrës i vendimeve, si dhe institucion të vetëm dhe posaçëm, efikas, profesional qendror, që do të jetë kompetent për sistemin e arsimit dhe trajnimit profesional.
- Rekomandohet koordinim qendror i aktiviteteve operative, që do të rezultonte me dialog efektiv mes bashkësisë afariste dhe institucioneve, gjegjësisht ofertuesve, rritje të rolit të Agjencisë për Punësim si dhe koordinim në nivel lokal.
- Rekomandohet që të gjithë regjistrat që mbi baza të ndryshme mbahen nga institucione të ndryshme të jenë të kapshme publikisht në faqet e internetit e institucioneve që janë të autorizuara me ligj për t'i mbajtur këto regjistra.
- Rritja e rolit, pavarësia dhe kompetencat e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional (në pjesën e planeve dhe programeve mësimore, përpunimit të teksteve shkollore, koordinimit me bashkësinë afariste).
- Rishqyrtim të kompetencave që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnimin profesional, e që janë në mandat të BZHA-së.

Në kuadër të analizës së të ardhurave të shkollave të mesme është konstatuar se të ardhurat e përgjithshme të shkollave të mesme nga katër rajonet në vitin 2017 kanë arritur më shumë se 1,1 miliardë denarë. Me këtë rast, shkollat në pjesën më të madhe financohen përmes transfereve nga nivelet tjera të pushtetit (pushteti qendror dhe lokal) edhe atë 96,6 përqind e të ardhurave të përgjithshme, më pas vijojnë të ardhurat nga taksat dhe kompensimet që i marrin shkollat prej 2,9 përqind, ndërsa pjesa e mbetur 0,5 përqind janë të ardhura të tjera jotatimore dhe donacione. Shkollat e përfshira në hulumtimin nuk kanë realizuar të ardhura kapitale në

vitin 2017. Pjesën më të madhe të mjeteve shkollat i kanë dedikuar për paga dhe kompensime për të punësuarit edhe atë 65 përqind (590 mil. den.), furnizim të mallrave dhe shërbimeve në 33,5 përqind (304 mil. den.), shpenzime kapitale 1 përqind (thujse 9 mil. den.), dhe subvencione, transferime dhe pagesa interesi 0,5 përqind (gjegjesisht 4 mil. den.).

Në tabelën B, sipas komponentëve janë paraqitur konstatimet dhe rekomandimet për financimin e arsimit dhe trajnimit formal.

TABELA B: KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET KRYESORE PËR FINANCIIMIN E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT FORMAL		
Komponentë	Konstatime	Rekomandime
<b>TË ARDHURA TË SHKOLLAVE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekzistojnë dallime evidente në të ardhurat e përgjithshme të shkollave sipas rajoneve. Shumë më të lartë të të ardhurave të përgjithshme ka në rajonin e Shkupit.</li> <li>Të ardhurat e përgjithshme të pjesëtuara me numrin e përgjithshëm të nxënësve (mesatarisht për nxënës) janë më të ulëta për rajonin e Shkupit.</li> <li>Thuajsetë gjitha të ardhurat nga shkolla (më shumë se 96 përqind) paraqesin transferenga nivelet tjera të pushtetit. Pjesëmarrja e të ardhurave jokatimore është e pakonsiderueshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nevojitet të tejkalohen disproporcionet rajonale në sigurimin e mjeteve për arsimin dhe trajnimin formal profesional, me qëllim që të sigurohet arsim cilësor.</li> <li>Të nxiten shkollat që të kërkojnë dhe krijojnë burime alternative të financimit dhe rritje të të ardhurave personale.</li> </ul>
<b>SHPENZIME TË SHKOLLAVE</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Thuajse 2/3 e shpenzimeve në shkolla janë të dedikuara për paga dhe kontribute të të punësuarve.</li> <li>Shpenzimet kapitale të shkollave, në të cilat bëjnë pjesë blerja e pajisjes dhe makinave, objekte ndërtimore, orendi, etj., arrijnë rreth 1 përqind të buxhetit të tyre të përgjithshëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të ulët pjesëmarrja e shpenzimeve joproduktive.</li> <li>Detyrimisht të nxitet rritja e shpenzimeve kapitale, para së gjithash furnizimi i pajisjes dhe makinave për kabinetet për mësim praktik.</li> <li>Nga fundi i vitit 2018, MASH-i filloi me furnizim të centralizuar të pajisjes për shkollat e mesme profesionale (furnizimi është i planifikuar në disa faza dhe sipas profesioneve).</li> </ul>
<b>TRAJNIM PRAKTIK</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>12704 nxënës prej gjithsej 17646 nxënësve në arsimin katërvjeçar profesional realizojnë mësim praktik (72 përqind) në 553 kompani (nga rreth 30 nxënës në kompani).</li> <li>1903 nxënës prej gjithsej 1990 nxënësve në arsimin profesional për profesion realizojnë mësim praktik te 348 punëdhënës (nga 5 nxënës në kompani).</li> <li>Shkollat deklarojnë se nuk kanë pasqyrë për lartësinë e shpenzimeve që kanë të bëjnë me procesin arsimor dhe obligimet nga ndjekja e trajnimit praktik te punëdhënësi që janë në barë të prindërve.</li> <li>Një pjesë e vogël e shkollave ndajnë resurse financiare për organizimin ose ndjekjen e trajnimeve nga të punësuarit dhe për trajnim praktik te punëdhënësi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të rritet niveli i realizimit të mësim-it praktik te punëdhënësi në arsimin katërvjeçar profesional.</li> <li>Të përmirësohet komunikimi mes nxënësve, gjegjesisht prindërve të tyre dhe shkollave në drejtim të përcaktimit të saktë të shpenzimeve që kanë të bëjnë me procesin arsimor dhe obligimet nga ndjekja e trajnimit praktik te punëdhënësi në barë të prindërve si pjesë e rëndësishme e resurseve financiare që kanë të bëjnë me arsimin e mesëm profesional.</li> <li>Nevojitet të stimulohen investimet në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe të veçohen shuma më të larta për trajnimin e kuadrit mësimdhënës të shkollave.</li> </ul>

<sup>1</sup> Në këtë dokument termi nxënës përdoret edhe për nxënësit e gjinisë femërore edhe për nxënësit e gjinisë mashkullore.

<p><b>DONACIONE</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistojnë dallime evidente në shumën e përgjithshme të donacioneve sipas rajoneve. Donacionet drejt shkollave në rajonin jugperëndimor dhe juglindor ngecin prapa atij të Pollogut dhe Shkupit. Në të shumtën e rasteve donatorë janë MASH-i dhe komuna (Qyteti i Shkupit), me ç'rast komunat nuk u donojnë shumë të konsiderueshme të mjeteve shkollave të mesme profesionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të nxitet donatorizmi, nevojitet qasje (dhe trajnim) proaktive nga shkollat për gjetjen e burimeve alternative të financimit.</li> <li>• Duhet të nxitet vetëdija për nevojën e përgjegjesisë shoqërore korporative dhe donacione nga kompanitë.</li> <li>• Komunat duhet t'u ndihmojnë në mënyrë aktive shkollave në bashkësinë.</li> </ul>
<p><b>NJVL-VE HA EЛC</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunat nuk kanë ndikim në shumën e dotacionit.</li> <li>• Komunat nuk kanë praktikë të ndajnë mjete për mbështetjen e grupeve të marginalizuara tënxënësvenë arsimin e mesëm.</li> <li>• Mungojnë aktet e komunës (rregullore, vendime, udhëzime, etj.) me të cilat do të ishte rregulluar shuma ose dedikimi i mjeteve financiare për arsimin e mesëm profesional.</li> <li>• Komunat e plotësojnë formalisht obligimin e tyre ligjor për të dërguar propozime deri te MASH-i për numrin e nevojshëm të paraleleve dhe nxënësve në shkollat e mesme profesionale për vitet e ardhshme shkollore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunat duhet të ndërlihen më mirë me shkollat dhe bashkësinë afariste në mjedisin e tyre dhe t'i identifikojnë nevojat e tyre reale për realizimin konsekuent të procesit arsimor.</li> <li>• Nevojitet të përpilohen aktet plotësuese që do ta kishin rregulluar procesin e financimit të arsimit dhe trajnimit formal profesional nga komunat duke marrë parasysh specifikat e profesioneve.</li> </ul>

Ekipi hulumtues është i vetëdijshëm se ky dokument nuk mund t'i përfshijë të gjitha aspektet e një problemi, por mund t'i identifikojë sfidat kryesore dhe, të ofrojë rekomandime dhe alternativa.

Siç është shpesh rast, në kuadër të hulumtimit përballemi me kufizime të caktuara:

#### 1. Reagim i dobët:

- Shkollat përgjigjen pjesërisht në pyetjet e parashtruara në pyetëtorin dhe një pjesë e përgjigjeve janë të pasakta;
- Shkollat nuk i respektojnë obligimet e bartësve të informacioneve të parashikuara në Ligjin për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik;
- Punëdhënësit treguan mosinteresim të madh për t'u përgjigjur në pyetësorët e dorëzuar (ndoshta mënyra më e mirë e marrjes së përgjigjeve nga kompanitë është që të bëhet intervistë e drejtpërdrejt në kompaninë, gjë që nga ana tjetër, do të thotë se nevojitet më shumë kohë dhe resurse për grumbullimin e të dhënave);
- Institucionet nuk janë të hapura/të gatshme sa duhet për t'u përgjigjur në pyetjet dhe kanë vështirësi në qasjen deri te personat që posedojnë informacionet, gjatë caktimit të intervistës.

2. Jokonsistencë e të dhënave – një pjesë e të dhënave statistikore që merreshin nga shkollat, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim dhe Enti Shtetëror i Statistikës, dalloheshin, ndonëse dallimi nuk është i rëndësishëm në aspektin statistikor.

3. Ndonëse të gjitha shkollat dhe institucionet tjera kanë ueb-faqe, shumë rrallë në to mund të gjenden informacionet themelore rrjedhëse (p.sh. për shkollën, numër i paraleleve, nxënësve, profesioneve, kuadrit mësimdhënës dhe ngjashëm).

## PARATHËNIE

Arsimi profesional në Republikën e Maqedonisë një periudhë më të gjatë kohore përballat me një numër të madh të sfidave që rezultojnë prej më shumë faktorëve: ulja e numrit të nxënësve, gjendja e keqe ekonomike, kompetenca e ndarë mes disa institucioneve në nivele të ndryshme, rregullat e pa-harmonizuara juridike dhe mungesë të zbatimit të tyre të plotë, mosinteresim i bashkësisë afariste, mungesë të motivimit dhe kapaciteteve të mësimdhënësve dhe drejtorëve për inovacione.

Nga ana tjetër, arsimi dhe trajnimi profesional është sistem i cili edhe në shtetin tonë është i prekur nga proceset globale transformuese. Inovacionet teknologjike shkaktojnë ndryshime të shpejta në llojin e vendeve të punës dhe përmbajtjes së punës, ndryshime permanente në kërkesën për kualifikime, si dhe shkathtësi të reja të rinjtë. Këto nevoja në tregun e punës imponojnë risi dhe shpërndarje të resurseve në arsimin dhe trajnimin profesional.

Duke marrë këtë parasysh, në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fillim të muajit mars të vitit 2018, filloi të realizohet projekti “Arsimim për Punësim në Maqedoni” (E4E@mk). Qëllimi kryesor i Projektit është që të kontribuojë drejt punësimit më dinjitoz të të rinjve, e veçanërisht të grupeve të rrezikuara, në mënyrë inkluzive dhe të qëndrueshme. Kjo pritet të arrihet përmes qasjes sistemore që do të synojë të sigurojë zhvillim të shkathtësive profesionale me orientim të tregut përmes arsimit dhe trajnimeve joformale, bashkëpunimit të përmirësuar mes arsimit të mesëm profesional dhe punëdhënësve veçanërisht në pjesën e mësimin praktik të nxënësve, si dhe përmes kornizës së përmirësuar ligjore për zhvillim të shkathtësive profesionale. Në fazën e tij të parë (2018 – 2022), në fokus të posaçëm të projektit janë shtatë sektorë (shëndetësi dhe përkujdesje sociale, shërbime personale, hotelieri, sektori bujqësor, sektori ushqimor-teknologjik, sektori i makinerisë dhe elektroteknikës – IT profile) në katër rajone të planifikuara në shtet (juglindje, jugperëndim, Pollog dhe Shkup). Projekti është i implementuar nga konzorciumi të cilin e përbëjnë interkorporata zvicerane Helvetas, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, në bashkëpunim të ngushtë me Minis-

trinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Qendrën për Arsim dhe Trajnim Profesional, sektorine biznesit dhe shumë organizata të tjera relevante qeveritare dhe joqeveritare.

Nga ana e projektit E4E@mk, ekipi i Institutit për Hulumtime Strategjike dhe Edukim (IHSE) është angazhuar që të përpilojë analizë të gjendjes aktuale dhe sfidave me fokus të veçantë në kornizën ligjore, resurset dhe proceset dhe kompetencat tjera në arsimin joformal profesional. Analiza mbështetet në hulumtimin empirik të zbatuar gjatë periudhës prej gushtit deri në tetor të vitit 2018.

Në këtë dokument janë prezantuar proceset dhe konstatimet e grupuara në kapitujt vijues:

1. Informacione fillestare për situatat në arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut: paraqitje e shkurtër statistikore e trendeve në pesë vitet e fundit në arsimin e mesëm në përgjithësi, si dhe gjendja në vitin 2017 (një vit para fillimit të projektit) në arsimin e mesëm profesional në rajonet, shkollat dhe për sektorët që janë me interes të posaçëm për projektin;
2. Metodologjia e hulumtimit: instrumente dhe të anketuar për grumbullimin e të dhënave, kornizë kohore e hulumtimit dhe analizës së të dhënave;
3. Rezultate:
  - Konstatime në raport me arsimin dhe trajnimin profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut: përshkrim i gjendjes aktuale, konstatime kryesore, rekomandime.
  - Konstatime në raport me financimin e arsimit dhe trajnimit profesional (burime, shuma, resurse të arsimit dhe trajnimit formal profesional, shpërndarja e tyre, shfrytëzimi).

## 1.


# INFORMACIONË FILLESTARE (STATISTIKORE) PËR ARSIMIN E MESËM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në këtë kapitull janë paraqitur lëvizjet e numrit të shkollave të mesme të rregullta në vend, numrit të përgjithshëm të paraleleve, nxënësve dhe mësuesve për pesë vitet e fundit shkollorë. Gjithashtu janë prezantuar informacione specifike për arsimin dhe trajnimin profesional në vitin 2018 në rajonet dhe në sektorët që janë në interes të projektit Arsimit për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut (E4E@mk).

## 1.1 Trende në arsimin e mesëm

Duke i krahasuar të dhënat zyrtare gjatë periudhës së vitit shkollor 2012/2013 deri në vitin shkollor 2016/2017 (Foto 1), mund të vërehet se ekziston trend i rritjes së numrit të shkollave të rregullta të mesme në vend (publike dhe private) për 16 përqind më 2016/2017 në raport me vitin 2012/2013. Ndonëse, numri i shkollave është relativisht më i lartë, numri i paraleleve nuk e ndjekë këtë rritje. Kështu, në vitin shkollor 2016/2017 janë formuar vetëm 14 paralele më shumë në raport me vitin 2012/2013 viti, gjë që paraqet rritje prej 0,4 përqind. Ajo që bëhet karakteristike imanente e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit, gjë që vërehet edhe në arsimin e mesëm. Kështu, sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në vitin 2016/2017 në arsimin e rregullt të mesëm, ka pasur 16.100 shkollarë të mesëm më pak në raport me 2012/2013, gjë që paraqet ulje për 18 përqind. Numri i mësuesve prej vitit 2012 deri në vitin 2016 shënon rënie të vazhdueshme. Përfundimisht bën viti i fundit i analizuar, 2016/2017, kur numri i mësuesve rritet për 244, gjegjësisht 3,3 përqind në raport me vitin paraprak shkollor.


**Foto 1. Numri i shkollave të mesme, paralele, nxënës dhe mësimdhënës në arsimin e rregullt arsimor (periudhë prej 2012-2017)**



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Është interesante të shikohen të dhënat nga aspekti i rajoneve të planifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut (foto 2). Analiza e të dhënave për vitin shkollor 2016/2017 tregoi se lider absolut është rajoni i Shkupit, me numër më të madh të shkollave, paraleleve, nxënësve dhe mësimdhënësve në raport me rajonet tjera. Pas tij, vijojnë ai i Pollogut dhe Pellagonisë.

Foto 2. Numri i shkollave të rregullta të mesme, paraleleve, nxënësve dhe mësimdhënësve në arsimin e rregullt të mesëm, sipas rajonit (viti shkollor 2016/2017)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Të dhënat gjithashtu tregojnë se në arsimin e mesëm (në vitin shkollor 2016/2017) ka pasur gjithsej 131 shkolla të mesme, në të cilat kanë mësuar 72 482 nxënës të sistemuar në 3 481 paralele (mesatarisht nga 21 nxënës në paralele). Mësimin në shkollat e kanë realizuar 7 533 mësimdhënës (proporcioni mësimdhënës:nxënës ka qenë 1:10).

Sipas përkatësisë etnike (foto 3) në vitin e njëjtë shkollor, numri më i madh i shkol-larëve të mesëm në arsimin e rregullt kanë qenë maqedonas, më pas shqiptarë, turq, romë, boshnjakë, serbë dhe vllahë.

Foto 3. Nxënës në arsimin e rregullt të mesëm sipas përkatësisë në bashkësinë etnike (viti shkollor 2016/2017)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Kuadri mësimdhënës në arsimin e rregullt të mesëm është angazhuar si: kuadër udhëheqës, mësimdhënës për mësim lëndor (lëndë të përgjithshme-arsimore dhe profesionale) dhe mësimdhënës për mësim praktik. Me këtë rast, dominojnë mësimdhënësit e mësimit lëndor në raport me mësimdhënësit e mësimit praktik.

**Tabela 1. Numri i kuadrit të mësimdhënësve në arsimin e rregullt e mesëm**


	2014/2015	2015/2016	2016/2017
Gjithsej	7 345	7 289	7 533
Kuadër udhëheqës	250	249	245
Mësimdhënës të mësimit lëndor	6 635	6 513	6 747
Mësimdhënës për mësim praktik	460	527	541

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Nga ana tjetër, sipas të dhënave që janë marrë nga Ministria e Arsimit, në vitin shkollor 2016/2017 në shkollat e mesme publike në vend kanë punuar gjithsej 8777 të punësuar, prej të cilëve 7106 (81 për qind) janë kuadër mësimdhënës, derisa 1671 (19 për qind) persona janë të punësuar si kuadër jomësimdhënës. Proporcioni kuadër mësimdhënës: jomësimdhënës arrin 4,3 :1.


Sipas të dhënave të publikuara nga Entit Shtetëror për Statistikë, numri i nxënësve (të rregullt dhe të çrregullt) të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm në vitin shkollor 2016/2017 arrin 21 577. Prej tyre, rreth 60 për qind (12 968 nxënës) kanë mbaruar arsimin profesional, më pas 39% kanë mbaruar arsim gjimnazi, derisa vetëm 1% nxënës janë evidentuar për arsim të artit.

**Foto 4. Struktura e nxënësve që kanë mbaruar shkollën sipas planeve dhe programeve arsimore (viti shkollor 2016/2017)**



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Në kuadër të arsimit profesional, në vitin shkollor 2016/2017, numri më i madh i nxënësve të diplomuar është vërejtur në profesionin shëndetësor (3064 nxënës), e më pas vijojnë ai i elektroteknikës (1714 nxënës), ekonomiko-juridik dhe tregtar (1217 nxënës), profesioni ekonomik (1214 nxënës) dhe ai i makinerisë (1195 nxënës).

**Foto 5. Nxënës të cilët kanë mbaruar arsim profesional, sipas profesionit (viti shkollor 2016/2017)**

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

Në kuadër të arsimit të rregullt profesional, ekziston mundësia për përvetësimin e aftësimin profesional dhe arsimit specialist. Me këtë rast, mund të vërehet se në tri vitet e fundit shkollorë ekziston interes i rritur për përvetësim të këtyre kualifikimeve. Kështu që në vitin shkollor 2016/2017 gjithsej 554 persona kanë përvetësuar këto kualifikime, prej të cilave 137 persona për aftësim profesional, ndërsa 417 persona me arsim të specializuar.

**Tabela 2. Persona të cilët kanë përvetësuar arsim të specializuar dhe aftësim profesional për punë**

Viti shkollor	Gjithsej	Aftësim profesional	Arsim të specializuar
2014/2015	232	9	223
2015/2016	381	89	292
2016/2017	554	137	417

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës.

## 1.2. Të dhëna specifike për arsim dhe trajnim profesional në rajonet dhe në sektorët që janë në interes të projektit Arsim për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut (E4E@mk)

Fokus i posaçëm në këtë analizë është vendosur në arsimin dhe trajnimin profesional në 4 rajone të planifikuara të shtetit (rajoni juglindor, jugperëndimor, i Pollogut dhe Shkupit) në raport me 7 sektorë (Shëndetësi dhe përkujdesje sociale, Shërbime personale, Hotelieri, Sektori bujqësor, Sektori ushqimor-teknologjik, Sektori Makineri dhe Elektroteknikë – IT profile). Në bazë të këtyre kufizimeve, analiza u fokusua në 29 shkolla që ofrojnë profile arsimore në kuadër të sektorëve me interes, e që janë të sistemuar në katër rajone (Tabela 3)<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Në rajonin e Shkupit funksionojnë edhe 3 qendra/shkolla për nxënës me nevoja/vështirësi të veçanta që gjithashtu ofrojnë disa nga profesionet e përmendura, por adekuate me specifikat e shkollave dhe qëllimet e projektit ato nuk janë marrë parasysh në këtë analizë

**Tabela 3. Numër i shkollave që ofrojnë arsim dhe trajnim profesional, sipas rajoneve**

RAJONI	NUMRI I SHKOLLAVE
Jugperëndimor	7
Juglindor	5
i Pollogut	5
i Shkupit	12+3
<b>GJITHSEJ</b>	<b>29 +3</b>

Në vazhdim janë paraqitur të dhëna për numrin e nxënësve dhe paraleleve në shkollat e përfshira në projektin E4E@mk. Të dhënat kanë të bëjnë me numrin e përgjithshëm të nxënësve, gjegjësisht paraleleve në këto shkolla, për të gjitha profesionet/profilet që ekzistojnë në shkolla.

**Tabela 4. Nxënës dhe paralele në shkollat e përfshira në E4E@mk në vitin shkollor 2016/2017 (gjithsej dhe pjesëmarrje procentuale)**

RAJONI	NXËNËS		PARALELE	
	Gjithsej	Për qind	Gjithsej	Për qind
Jugperëndimor	3124	20%	179	22%
Juglindor	3469	22%	135	17%
i Pollogut	1472	10%	162	20%
i Shkupit	7500	48%	331	41%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>15565</b>	<b>100%</b>	<b>807</b>	<b>100%</b>

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

*Shënim:* Në paraqitjen tabelare nuk janë përfshirë të dhëna për SHMQSH „Marija Kiri Sklodovska“ dhe SHMETQSH „Mihajllo Pupin“.

Nga paraqitja tabelare mund të vërehet se numri i nxënësve dhe paraleleve është më i lartë në rajonin e Shkupit, gjë që nga ana tjetër, është në përputhje me faktin se pjesa më e madhe e shkollave që janë analizuar në aspektin gjeografik i takojnë këtij rajoni të planifikuar. Mirëpo, nëse krahasojmë se sa është numri mesatar i nxënësve në paralele në secilin prej rajoneve të caktuara mund të vërehet se në mesatare paralelemë të mëdha ka në rajonin juglindor, derisa madhësia mesatare e paraleles është më e vogël në rajonin e Pollogut. Madhësia e paraleleve mund të ketë ndikim serioz në cilësinë e mësimin në këto shkolla.

**Tabela 5. Madhësia mesatare e paraleles në shkollat e përfshira në E4E@mk në vitin shkollor 2016/2017**

RAJONI	Numër mesatar i nxënësve në paralele
Jugperëndimor	17,5
Juglindor	25,7
i Pollogut	9,1
i Shkupit	22,6

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

*Shënim:* Në paraqitjen tabelare nuk janë përfshirë të dhëna për SHMQSH „Marija Kiri Sklodovska“ dhe SHMETQSH „Mihajllo Pupin“.

Arsimi i mesëm profesional në shkollat e katër rajoneve u organizuan në formë të arsimit katërvjeçar teknik dhe arsimit trevjeçar profesional të profesioneve. Në vazhdim është paraqitur struktura gjinore e nxënësve në arsimin katërvjeçar dhe trevjeçar profesional për profilet, gjegjësisht profesionet nga fushat: Shëndetësi dhe përkujdesje sociale, Shërbime personale, Hotelieri, sektor i bujqësisë, sektori ushqimor-teknologjik, sektori i makinerisë dhe elektroteknikës – IT profile.

Në vitin e analizuar në arsimin katërvjeçar teknik në kuadër të profesioneve, gjegjësisht profilet nga fusha e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale, shërbimeve personale, hotelierisë, sektorit të bujqësisë, sektorit ushqimor - teknologjik, sektorit të makinerisë dhe elektroteknikës – IT profile, sipas të dhënave që janë marrë nga Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, janë evidentuar gjithsej 9647 nxënës. Prej tyre, 5683 nxënës (58 përqind) janë të gjinisë mashkullore, derisa pjesëmarrja e nxënësve arrin 42 përqind (3864 nxënës).

**Tabela 6. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin katërvjeçar teknik, sipas gjinisë (në vitin shkollor 2016/2017)**

RAJONI	MESHKUJ	FEMRA	GJITHSEJ
Jugperëndimor	911	867	1778
Juglindor	1628	747	2375
i Pollogut	849	98	947
i Shkupit	1895	2252	4447
<b>GJITHSEJ</b>	<b>5683</b>	<b>3964</b>	<b>9647</b>

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

*Shënim:* Në paraqitjen tabelare nuk janë përfshirë të dhëna për SHMQSH „Marija Kiri Skllodovska“ dhe SHMETQSH „Mihajlo Pupin“.

Në raport me përfaqësimin gjinor, shumë më e pavolitshme në raport me përfaqësimin e nxënësve të gjinisë femërore është situata në arsimin profesional të profesioneve, ku 76 përqinde numrit të nxënësve kanë qenë të gjinisë mashkullore, derisa vetëm 24 përqind është pjesëmarrja e nxënësve të gjinisë femërore në numrin e përgjithshëm të nxënësve.

**Tabela 7. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin profesional të profesioneve arsim (trevjeçar), sipas gjinisë (në vitin shkollor 2016/2017)**

RAJONI	MESHKUJ	FEMRA	GJITHSEJ
Jugperëndimor	143	24	167
Juglindor	252	56	308
i Pollogut	186	40	226
i Shkupit	785	308	1093
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1366</b>	<b>428</b>	<b>1794</b>

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

*Shënim:* Në paraqitjen tabelare nuk janë përfshirë të dhëna për SHMQSH „Marija Kiri Skllodovska“ dhe SHMETQSH „Mihajlo Pupin“.

Sipas të dhënave të analizuara nga Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, në arsimin dhe trajnimin profesional të profesioneve mësimin e ndjekin edhe gjithsej 58 personame pengesë. Ndonëse, pjesëmarrja e këtyre nxënësve në numrin e përgjithshëm është shumë e vogël, vërehet se në raport me numrin e përgjithshëm të nxënësve, kjo kategori e nxënësve tregon interesim relativisht më të madh për arsimin trevjeçar përballë arsimit teknik.

**Tabela 8. Numri i përgjithshëm i nxënësve me pengesa në arsimin teknik (katërvjeçar) dhe arsimin profesional të profesioneve arsim (trevjeçar) (në vitin shkollor 2016/2017)**

RAJONI	Numri i nxënësve me pengesë në arsimin teknik	Numri i nxënësve me pengesë në arsimin profesional të profesioneve	GJITHSEJ
Jugperëndimor	1	2	3
Juglindor	19	10	29
i Pollogut	4	13	17
i Shkupit	6	3	9
<b>GJITHSEJ</b>	<b>30</b>	<b>28</b>	<b>58</b>

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

*Shënim:* Në paraqitjen tabelare nuk janë përfshirë të dhëna për SHMQSH „Marija Kiri Skllodovska“ dhe SHMETQSH „Mihajllo Pupin“.

Më në fund, me qëllim që t'i sqarojmë specifikat e arsimit të mesëm profesional, e kemi përlogaritur numrin e mësimdhënësve të lëndëve profesionale në shkollat e katër rajoneve. Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të lëndëve profesionale arrin 710, prej të cilëve më së shumti (38 përqind) punojnë në shkollat e rajonit të Shkupit.

**Tabela 9. Mësimdhënës të lëndëve profesionale**

RAJONI	Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të lëndëve profesionale	Numër mesatar i nxënësve për një mësimdhënës të lëndëve profesionale
Jugperëndimor	156	12
Juglindor	99	27
i Pollogut	187	6
i Shkupit	268	21
<b>GJITHSEJ</b>	<b>710</b>	<b>16</b>

*Burimi:* Bazë e të dhënave e Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

Gjithashtu, është vërejtur se ekziston dallim i madh në raport me numrin e nxënësve të cilët mesatarisht punon një mësimdhënës. Kështu, mësimdhënësit e lëndëve profesionale nga Rajoni juglindor punojnë mesatarisht me numër më të madh të nxënësve, derisa mësimdhënësit e Rajonit të Pollogut me më së paku nxënës.

## 2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Sa i takon metodologjisë së hulumtimit, autorët niseshin nga postulati se për përcaktimin e efikasiteti të politikave ekzistuese është me rëndësi të jashtëzakonshme që të analizohen të dhënat sasiore dhe informacionet/qëndrimet dhe mendimet cilësore të kategorive të të anketuarve me të cilët kanë të bëjnë ato politika. Hulumtimi është realizuar në rajonin e planifikuar të Shkupit, Pollogut, atë juglindor dhe jugperëndimor. Duke marrë parasysh këtë, është krijuar një kornizë metodologjike në të cilën janë përfshirë burime primare dhe sekondare të informacioneve.

### 2.1. Instrumente për grumbullimin e të dhënave dhe të anketuar

Për grumbullimin e të dhënave janë përdorur në përgjithësi 4 lloje të instrumenteve: Kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik për shkolla (kërkesa është përshtatur për çdo shkollë në mënyrë përkatëse me profesionet e përfaqësuara në të), Kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik për komunat, Pyetësor për anketë elektronike të punëdhënësve të cilët bashkëpunojnë me shkollat, Intervistë gjysmë e strukturuar për institucionet kryesore në nivele të ndryshme.

Në tabelën 10 janë paraqitur më shumë informacione për secilin prej instrumenteve, që janë të ndërlidhura me ekzemplarin e hulumtimit, si dhe normën e përgjigjeve që janë marrë.

**Tabela10. Instrumente për grumbullimin e të dhënave<sup>3</sup>**

INSTRUMENT	PËRSHKRIMI INSTRUMENTIT	DORËZUAR NË:	PËRGJIGJE QË JANË MARRË PREJ:
Kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik për shkolla	-10 pyetje që kanë të bëjnë me financimin -27 pyetje që kanë të bëjnë me procesin arsimor	30 shkolla (i përshtatur për secilën)	27 shkolla (ose 90%)
Kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik për komunat	-7 pyetje që kanë të bëjnë me financimin arsimor dhe trajnimin profesional	11 komuna	9 komuna ose 81%

<sup>3</sup> Për shkak të normës së ulët të pjesëmarrjes në anketën elektronike për punëdhënësit paraqitet problem me aspektin reprezentativ. Prandaj, përgjigjet që janë marrë nga anketa nuk janë përfshirë në analizën.

Pyetësor për punëdhënësit	-7 pyetjelidhur me kompaninë -22 pyetje që kanë të bëjnë me mësimin praktik të nxënësve	240 kompani	6 kompaniose 2,5%
Intervistë gjysmë e strukturuar dhe sipas nevojës edhe intervistë e thelluar me institucionet kryesore në nivele të ndryshme (kombëtar, lokal, shkolla)	-5 deri 10 pyetje të përgjithshme - në mesatare rreth 10 pyetjespecifike për institucionin	Intervistë e realizuar me gjithsej 30 përfaqësues të: MASH-it, QAMP-së, QARR-it, BZHA-së, QSHP-së, ISHA-së, 8 shkolla, 4 komunadhe Qytetine Shkupit	
Protokolle për analizimin e dokumenteve që e rregullojnë sistemin	Janë analizuar: 17 ligje 11 strategji dhe dokumente të konceptit 24 akte nënligjore, normative dhe standarde dokumente programore raporte dhe dokumente të tjera relevante		

## 2.2. Korniza kohore

*Burimet primare të informacioneve* mbështeten në (1) intervista gjysmë të strukturuar të realizuara me palët kryesore të interesit dhe (2) kërkesa të dorëzuara për qasje deri te informacionet e karakterit publik deri te shkollat dhe komunat.


Në kuadër të realizimit të intervistës është përgatitur pyetësor për intervista gjysmë të strukturuar. Intervistat u realizuan gjatë periudhës prej 15 shtatorit – 5 nëntor të vitit 2018 në Shkup, Ohër, Strumicë dhe Tetovë me gjithsej 30 përfaqësues të shkollave të mesme profesionale, komunave dhe Qytetit të Shkupit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MAQ), Qendrës për Arsim të Mesëm Profesional (QAMP), Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), Qendrës Shtetërore të Provimeve (QSHP), Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA), Qendrës për Arsimin e të Rriturve (QARR) etj. Gjatë realizimit të intervistës u kushtojë kujdes i veçantë bashkëbiseduesve që të kenë pozicion më të lartë në institucionin dhe të jenë të autorizuar që të nxjerrin qëndrimin në të njëjtin (drejtorë, udhëheqës të sektorëve, etj). Krahas kësaj, kjo zgjedhje mundësoi përfaqësim të shkollave dhe komunave të rajoneve të ndryshme të vendit, ndërsa seleksionimi i shkollave, komunave dhe bashkëbiseduesvetë tjerë ishte përshtatur me formatin dhe kornizën kohore të hulumtimit.

Krahas kësaj, në gusht të vitit 2018, IHST-ja iu drejtua me kërkesa për qasje deri te informacionet e karakterit publik 30 shkollave të mesme profesionale dhe 11 komunave në rajonet e sipërpërmendura dhe për aspekte të caktuara të hulumtimit. Nga kërkesat e dërguara për qasje të lire deri te informacionet e karakterit publik deri te gjithsej 30 shkollat mesme janë marrë përgjigje prej 27 shkollave. Përgjigje në kërkesat e dorëzuara nuk janë marrë nga shkollat e mesme „Marija Kiri Skllodovska“ – Shkup, „Kirili dhe Metodi“ – Ohër dhe „Dimitar Vllahov“ – Strumicë. Nga kërkesat e dërguara për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik deri te komunat, prej gjithsej 11 kërkesave, përgjigje është marrë prej 9 komunave, ndërsa nuk është marrë përgjigje nga komunat Radovish dhe Kërçovë. Duke marrë parasysh se gjatë

periudhës së hulumtimit nuk ishte formuar Komisioni për qasje deri te informacionet e karakterit publik, IHST-ja nuk parashtrroi ankesë për shkak të pamundësisë së qasjes deri te informacionet – heshtje të administratës, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik. Listë të hollësishme të shkollave dhe komunave të përfshira është paraqitur në aneksin e këtij dokumenti. Analiza e informacioneve dhe treguesve të përpunuar është zhvendosur në pjesën e pestë të këtij dokumenti.

*Burimet sekondare të informacioneve* janë siguruar përmes analizës së kornizës ligjore në të cilën funksionon arsimit i mesëm profesional. Në kuadër të analizës së zhvendosur në t.3.2. në këtë dokument janë përfshirë 17 ligjedhe 24 akte nënligjore, normativadhe standarde. Krahas kësaj, janë shqyrtuar 11 strategji, dokumente programore, raporte dhe dokumente të tjera. Listë e detajuar e burimeve që kanë qenë objekt i analizës juridike janë paraqitur në aneksin e këtij dokumenti.

Siç ndodhë shpeshherë, në kuadër të hulumtimit u përballëm me disa kufizime të caktuara. Në pjesën më të madhe, kufizimet kishin të bëjnë me sfidat logjistike veçanërisht në pjesën e caktimit të intervistave dhe përzgjedhjes së bashkëbiseduesve më relevantë. Në mënyrë plotësuese, një pjesë e shkollave dhe komunave nuk dorëzuan përgjigje në kërkesën e parashtruar për qasje deri te informacionet e karakterit publik, e për shkak të arsyeve të përmendura paraprakisht nuk mund të iniciohet procedurë ankimese. Këto kufizime na bëjnë veçanërisht të kujdesshëm gjatë përcaktimit të rekomandimeve nga ky dokument.



## 3. REZULTATË

Në këtë pjesë janë paraqitur përshkrimii situatave, efektetnga funksionimii kornizës juridike dhe rekomandimetpër përmirësimin e saj. Është bërë analizë e një numri të madh të rregullativave: akte ligjore, akte nënligjore, strategji, etj; ndërsa informacionepër implementimin e tyre janë grumbulluar prej përfaqësuesve të institucioneve kompetente, si dhe nga të anketuaritprej katërrajoneve në projektin.

Më poshtë është paraqitur analiza e financimittë arsimit dhe trajnimit të mesëm profesional me konstatimedhe rekomandime. Është veçanërisht e rëndësishme të merret parasysh se numri më i madh i konstatimevedhe rekomandimevepër resursetdhe procesetnë arsimin dhe trajnimin formal profesional, kanë të bëjnë me rajonet e planifikuara në Republikën e Maqedonisë dhe në sektorët në arsimin profesional që janë primare në fazën e parë të projektit E4E@mk. Për shkak të kësaj, nuk rekomandohet përgjithësimi i tyre për të gjitha shkollat e mesme profesionale, sektorët dhe rajonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Arsimi dhe trajnimi profesional në përputhje me të gjitha strategjitë kombëtare është vendosur si një prej mekanizmave kryesor për zgjidhjen e problemeve me papunësinë dhe nevojat e tregut të punës në RM. Siç është përmendur në Konceptin për modernizimin e arsimit teknik të vitit 2016, funksioni themelor i arsimit teknik reflekton të drejtën e punës dhe të drejtën e arsimit.

Në dhjetë vitet fundit janë miratuar disa akte të ndryshme (strategji, koncepte, programe, etj.) që kanë të bëjnë me zhvillimin e arsimit dhe trajnimit profesional. Një pjesë e këtyre akteve janë rrënjosur në trendët dhe rekomandimet aktuale të institucioneve dhe iniciativave ndërkombëtare, e disa janë miratuar nga organet kompetente maqedonase si pjesë e projeksioneve për zhvillimin e këtij sektori specifik

të arsimit.

Strategjitë dhe dokumentet programore u referohen rekomandimeve dhe rregullave më të reja nga aspekti i përvojave ndërkombëtare.<sup>4</sup> Në këtë drejtim, është me rëndësi të theksohet se Koncepti për modernizimin e arsimit teknik të vitit 2016 u referohet qëllimeve dhe prioriteteve të vendosura në Strategjinë e UNESCO-s, Strategji për arsimin dhe trajnim teknik viti 2016-2021, me ç'rast janë vendosur qëllimet vijuese: (1) qasje deri te arsimit dhe trajnimi teknik, (2) sigurim të cilësisë në arsimin teknik, (3) menaxhim të arsimit teknik, (4) përfshirje të sektorit të biznesit, (5) nxitje të institucioneve për arsim teknik që të sigurojnë kushte më të mira për nxënësit dhe t'i plotësojnë nevojat e tregut të punës përmes ndryshimeve në financimin, si dhe nevojës që t'i kushtojë vëmendje më të madhe diversifikimit të financimit jashtë sektorit publik.<sup>5</sup>

Si dokumente më të rëndësishme kombëtare programore dhe strategjike për arsimin e mesëm profesional mund t'i numërojmë: Strategjinë për arsimin e të rriturve (viti 2016-2020), Programi për reforma në punësimin dhe politikën sociale (2020), Strategjia kombëtare për punësim (2016-2020),

Strategjia kombëtare për të rinjtë (viti 2016-2025), Strategjia për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përgjithshëm (2013-2020 me plan veprimi), Koncepti për modernizimin e arsimit teknik (viti 2016), Koncepti për arsim pas arsimit të mesëm të vitit 2010, Koncepti për aftësim profesional të vitit 2010, etj.

Megjithatë, gjendja faktike tregon se të gjitha strategjitë dhe dokumentet tjera programore bëjnë detektimin dhe sqarimin e sfidave në funksionimin e sistemit, por ajo që mungon është arritja e qëllimeve në praktikë, gjegjësisht implementimi i përpiktë i tyre. Nga vetë strategjitë mund të konstatohet se bëhet fjalë për sfida që janë të pranishme një periudhë më të gjatë kohore, të njëjtat depërtojnë gjatë viteve dhe më e rëndësishmja, për të njëjtat nuk është gjetur mënyrë se si të tejkalohen.

Krahas kësaj, me ardhjen e investitorëve të rinj më të mëdhenj që hapën kapacitete prodhuese në më shumë lokalitete në RM, vërehet një trend i ri i mosharmonizimit të nevojave në tregun e punës, para së gjithash me programet që janë ofruar nga sistemi për arsim dhe trajnim profesional. Në këtë drejtim, Programi për reforma në punësim dhe politikë sociale 2020, konstaton se “paraqitet edhe reagim nga bashkësia e biznesit se profilet/kualifikimet që arsimi dhe trajnimi profesional i prodhon nuk i plotësojnë nevojat e tyre, jo vetëm nga aspekti i shkathtësive të duhura por edhe në aspektin e llojeve të kualifikimeve”. Në mënyrë plotësuese, shprehet vërejtje edhe për mungesën e masave sistemore për përballje me këtë sfidë serioze.

Vlen të theksohet se përkundër sfidave të përgjithshme lidhur me këtë çështje, gjatë disa viteve të fundit janë evidente disa iniciativa parciale për vendosjen e

<sup>4</sup> Strategjinë për arsimin e të rriturve 2016-2020 u referohet rekomandimeve të BE-së të vitit 2020, Konferencës së gjashtë ndërkombëtare për arsimin e të rriturve (Confintea VI) të vitit 2009, „Kornizë për aktivitetet nga Belemi“, Strategjisë së BE-së „Evropa 2020“, Strategji për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përgjithshëm 2013-2020 me plan të veprimit, Qasje, prioritete dhe rekomandime strategjike të përfshira në: programin „Arsim për të gjithë“ (2000), Qëllime mijëvjeçare (2000) të KB-ve, Agjenda e Lisbonës (1997 dhe 2001), Deklarata e Kopenhagës (2002), Memorandumi për mësim të përgjithshëm (2000), Komunikata nga Mاستrihti (2004), Komunikata nga Bordoja (2008), Komunikata nga Brizhi (2010)33, Procesi i Torinos (2010), Arsim dhe Trajnim – 2020 të Komisioni Evropian dhe dokumentet nga Procesi i Bolonjës.

<sup>5</sup> Koncepti për modernizimin e arsimit teknik, viti 2016

bashkëpunimit të formalizuar mes kompanive dhe shkollave profesionale në pjesën e trajnimit praktik, ndarje të bursave dhe mundësive për punësim, siç ishte vendosja e bashkëpunimit mes kompanisë EVN dhe shkollës së mesme “Mihajlo Pupin”. Në kuadër të përgatitjes së kësaj analize vazhdimisht i kemi parasysh pikërisht këto praktika më të mira, në të cilat do të kthehemi më poshtë në tekstin dhe si rrjedhojë, mundësitë për shumëfishimin e tyre në gjithë vendin. Nuk duhet harruar se parakushti themelor për arsimin e mesëm cilësor profesional është ekzistimi i bashkëpunimit efektiv me kompanitë.

Në kuadër të intervistave të realizuara me bashkëbiseduesit relevantë, janë grumbulluara edhe informacione për shumë situata dhe trende në arsimin e mesëm profesional në vend. Në këtë drejtim, u potencua edhe nevoja për bashkëpunim me bashkësinë afariste e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për funksionimin e arsimit të mesëm profesional, i cili sipas definicionit duhet të jenë gjenerator i potencialit punëtor të kompanive. Kompanitë dhe bashkësia afariste paraqesin një tërësi të natyrshme me shkollat profesionale. Nga njëra anë, mundësojnë lokacione për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve, e nga ana tjetër, arsimit të mesëm profesional është kryesor për udhëheqjen e politikës kadrovike të kompanive. Gjatë intervistave, është potencuar edhe interesimi i pamjaftueshëm për shfrytëzimin e veglave për analizimin e tregut. Sa i përket ndjekjes dhe realizimit të analizës së nevojave, shembull pozitiv paraqet Strumica, ku komuna realizon hulumtime të qëndrimeve dhe interesave të nxënësve të klasës së tetë dhe të nëntë. Nga ana tjetër, nëqytetin e Shkupit nuk ekziston praktikë për analizimin e nevojave të tregut. Përveç kësaj, komunat nuk dorëzojnë informacione kthyes në MASH. Nga intervistat e realizuar u imponua konstatimi se është i domosdoshëm planifikimi afatgjatë i nevojave të tregut të punës duke marrë parasysh faktin se kjo çështje është kyçe për funksionimin e qëndrueshëm të arsimit profesional.

Në funksion të nxitjes së kompanive për pranimin e nxënësve në trajnim praktik, bashkëbiseduesit e sugjeronin *“nevojën për lirime tatimore dhe subvencione për punëdhënësit që pranojnë nxënës në trajnim praktik, bursa dhe më shumë mundësi për punësimin e nxënësve”*. Faktor plotësues negativ paraqesin edhe *“të ardhurat e ulëta të punëdhënësit si dhe karakteri sezonal i angazhimit”*. Befason e dhëna se disa shkolla të cilat punojnë në fusha specifike (për shembull, bujqësi) nuk kanë kontakt fare me bashkësinë afariste. Në disa shkolla mësimi zhvillohet vetëm në nivelin teorik. Përkundër kësaj, ka shembuj të mirë të bashkëpunimit me bashkësinë afariste (për shembull me EVN, Kostal Ohër, Vanholl, Porshe).

Duhet të merre parasysh edhe ajo se më shumë se 90% e kompanive në tregun maqedonas<sup>6</sup> janë mikro-ndërmarrje, ndërsa në një numër të madh të rasteve menaxherët nuk i kanë shkathtësitë ose kualifikimet e nevojshme për t'i dalluar përparësitë e trajnimit praktik të gjimnazistëve në kompaninë. Në këtë drejtim, te një pjesë e bisedimeve është sugjeruar se imponohet *“nevoja për grumbullimin e ndërmarrjeve të vogla në klaster dhe aktivitetin e tyre të përbashkët, mes tjerash, edhe për përpilimin më të mirë të trajnimit praktik të nxënësve”*.

<sup>6</sup> <http://www.stat.gov.mk/pdf/2018/6.1.18.58.pdf>

Gjithashtu, është theksuar edhe sfida me *“arsimin e devaluuar e lartë, qasjen e tij dhe arritjen e lehtë deri te diploma universitare me çka ulet interesi për punë pas përfundimit të arsimit të mesëm”*. Krahas kësaj, në disa komunaparaqitet mungesë e fuqisë punëtore, më konkretisht deficit në profile të caktuara (për shembull, infermiere në Strumicë).

Në favor të njohurive nga intervistat e realizuara, Strategjia për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimit të përjetshëm (2013-2020) i detekton problemet vijuese: (1)vështirësi në gjetjen e partnerëve në sektorin e biznesit, (2)vështirësi në planifikimin e dinamikës së realizimit të trajnimit praktik, (3)mungesë e mjeteve (material harxhues) për realizim efektiv të mësimit praktik në shkolla, (4)teknika e vjetruar që e përdorin nxënësit në procesin e mësimit praktik në shkolla dhe e cila dallon shumë nga ajo që përdoret në kompanitë, motivim i dobët i kompanive për bashkëpunim më të madh me shkollat, etj.

Në përputhje me Strategjinë gjithëpërfshirëse për arsim për vitin 2018-2025 dhe planin e veprimit<sup>7</sup> për arsim dhe trajnim profesional janë përcaktuar sfidat vijuese:

1. Arsimi profesional edhe më tutje nuk tërheqë numër të mjaftueshëm të nxënësve (përveç profesioneve të caktuara në fushat e shëndetësisë, ekonomisë dhe së drejtës) dhe ende nuk është vendosur sistem bashkëkohor i arsimit pas arsimit të mesëm; kapacitetet e sistemit të ATP-së për sigurimin e arsimit inkluziv janë shumë të kufizuara.
2. Vërehet mospërputhje mes ofertës së kuadrove nga sistemi për ATP dhe kërkesa në tregun e fuqisë punëtore; sistemi për vendosjen e kualifikimeve të reja në arsimin dhe trajnimin profesional është jofleksibil dhe joefikas, ndërsa bashkëpunimi me sektorin e biznesit për trajnim konkret praktik të nxënësve dhe mësim në mjedis pune është joefikas.
3. Vërehen mangësi të konsiderueshme në dituritë e arsimtarëve për teknologjitë bashkëkohore që kanë të bëjnë me lëndët mësimore, ndërsa këtë situatë në mënyrë plotësuese e ndërlikojnë edhe motivimi i dobët i arsimtarëve dhe sistemi i pazhvilluar sa duhet për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë; veçanërisht për shkak të këtyre arsyeve mbisundon qasja tradicionale drejt udhëheqjes së procesit arsimor.
4. Një pjesë e drejtorëve të shkollave për ATP nuk e arrijnë nivelin e duhur profesional për atë funksion, gjë që ndikon negativisht në efikasitetin e institucioneve për ATP, prej të cilave shumica nuk janë të ekuipuar tërësisht me shërbime profesionale dhe ndihmë (p.sh. administrator i IKT, këshilltar për karrierë, etj.)
5. Sistemi për sigurimin e cilësisë në shkollat e mesme profesionale është në fazën e hershme të zhvillimit. Mungojnë informacione të vazhdueshme të vlefshme për sistemin kombëtar arsimor në perspektiva ndërkombëtare.
6. Është vënë re një nivel i pamjaftueshëm i integritetit dhe multikulturalizmit, veçanërisht kur bëhet fjalë për nxënësit romë dhe për nxënësit me nevojë të posaçme arsimore.
7. Është i kufizuar vëllimi i profesioneve që ofrohen për nxënësit e vendosur në shtëpitë edukative-përmirësuese.

<sup>7</sup> <http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/strateshki-plan>

Sa i përket arsimit të tërriturve dhe mësimit të përpjetshëm, Strategjia kombëtare për punësim viti 2016-2020 konstaton se: 1) sistemii arsimit të tërriturve dhe mësimit të përpjetshëm ende është në fazën e zhvillimit fillestar, 2) nevojitet përparim i shpejtë në sistemin e vlerësimit dhe funksionimit të mësimit joformal dhe informal, si dhe të programeve të veçanta për të rritur dhe 3) struktura e personave të papunë sipas arsimit është mjaftë e pavolitshme gjë që i bën shumicën e të papunëve jokonkurrentë në tregun e punës, ndërsa gjasat e tyre për punësim shumë të vogla.

Procesetnë zhvillimin e arsimit profesional në RMV, prej pavarësimit e deri sot, mund t'i ndajmë në dy faza, edhe atë faza e parë para vendosjes së arsimit të detyrueshëm të mesëm dhe faza e dytë pas vendosjes së arsimit të detyrueshëm të mesëm.

Vendosja e arsimit të detyrueshëm të mesëm, në përputhje me nenin 3 të Ligjit për arsim të mesëm, me vete tërhoqi procese që do të nënkuptonin probleme të reja, financa, transport, ngarkesë me shpenzime të reja, si dhe çështje të tjera për të cilat do të bëhet fjalë më poshtë në këtë tekst. Nga ana tjetër, parashtrrohet edhe një çështje konceptuale, vallë tendenca e përfshirjes sa më të madhe të nxënësve në arsimin e mesëm që dëshirohej të arrihet me arsimin e detyrueshëm të mesëm, është mënyra më e mirë për ndërtimin e arsimit të mesëm cilësor dhe profesional.

Nëse në vitin 2000 raporti i numrit të nxënësve që janë të përfshirë në arsimin e mesëm profesional arrinte rreth 65%, përballë 35% të nxënësve të regjistruar në arsimin gjimnazit, ndërkohë interesi për arsimin egjimnazit rritet dhe ky proporcion fillon të ndryshojë (zvogëlohet) në masë të konsiderueshme.<sup>8</sup> Mund të thuhet se ekziston një trend evident i rritjes së interesit dhe presionit të nxënësve për regjistrim në gjimnaz në dekadën e fundit.<sup>9</sup> Sot ky proporcion arrin 58.78% përballë 41.22% në favor të arsimit profesional. Me fjalë të tjera, përqindja enxënësvenë arsimin profesional në raport me numrin e përgjithshëm të nxënësve është zvogëluar prej 65% në 58% në periudhën e përmendur paraprakisht.<sup>10</sup> Strategjia kombëtare e të rinjve viti 2016-2025 konstaton “proces të vazhdueshëm të reformave dhe hyrja në një reformë tjetër nuk lë shumë hapësirë për vlerësimin e efekteve nga zbatimi i modeleve të caktuara të qasjeve arsimore, e njëherësh e ngushton hapësirën për përfshirje thelbësore të të gjitha palëve të prekura, e veçanërisht të shfrytëzuesve të drejtpërdrejt të reformave të tilla – njerëzit e rinj të cilët janë në procesin arsimor.”

### 3.1. Rezultatenga hulumtimi lidhur me kornizën juridike

Korniza juridike për arsimin dhe trajnimin profesional e përfshinë arsimin formal dhe joformal në vend dhe paraqet përmbledhje të shumicës së rregullave të shprehura në: A) nivel horizontal – përmes akteve të ndryshme ligjore, B) nivel vertikal – të shprehura përmes një vargu të akteve nënligjoretë karakterit të ndryshëm përmes të cilave zbatohen aktet ligjore si dhe C) dokumente për zbatimin dhe operacionalizimin e politikave legjislativie siç janë strategjitë e ndryshme.

<sup>8</sup> Programi për reforma në punësimin dhe politikën sociale 2020, faq. 51

<sup>9</sup> Programi për reforma në punësimin dhe politikën sociale 2020, faq. 51

<sup>10</sup> Programi për reforma në punësimin dhe politikën sociale 2020, faq. 51

Që në shikim të parë vërehet rrjeta, gjegjësisht gërshetimi i akteve të ndryshme ligjore që: 1) nuk ndiqen në pikëpamje të vargut kohor, gjegjësisht rregullat më të reja ligjore nuk janë harmonizuar tërësisht me ato më të vjetrat; 2) nuk ndiqen në pikëpamje të funksionalitetit, gjegjësisht në ligjet e ndryshme janë përfshirë dispozita për rregullimin e disa koncepteve të caktuara, që krijojnë dualitet me çka nuk respektohet parimi i racionalitetit (me fjalë të tjera, ka përsëritje) si dhe 3) nuk ndiqet harmonizimi material i rregullave.

Siç konstatojnë edhe dokumentet e ndryshme programore, përparimi është arritur në pjesën e kornizës ligjore, por i njëjti nuk është i mjaftueshëm. Edhe në vetë Strategjinë për arsimin e të rriturve 2016-2020, në faqen 17 konstatohet se „ekzistojnë parregullsi të pjesshme dhe përputhje të kompetencave të trupave dhe institucioneve të ndryshme që punojnë në këtë sektor. Në të shumtën e rasteve, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve nuk janë të shoqëruara me rishikimin e kohëpaskohshëm të akteve nënligjore, veçanërisht atyre që i rregullojnë kompetencat në nivel kombëtar, në nivel lokal dhe në nivel të shkollave, me çka krijohen kundërthënie dhe parregullsi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe zbatim të ngadalshëm të intervenimeve. Shembulli më evident për këtë mangësi të harmonizimit qëndron në përcaktimin e kompetencave të Qendrës për ATO, BZHA-së, QARR-it dhe ISHA-së”.

Më tutje, në Strategjinë për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përjetshëm 2013-2020 konstatohet se ekzistojnë “tentime për forcimin e rrethimit legjislativ të ATP-së”. Gjithashtu, mungon implementim më i dukshëm praktik i disa rregullave më të reja ligjore, si për shembull Ligji për kornizë ligjore për kualifikime. Në këtë drejtim, Strategjia nacionale për punësim viti 2016-2020 konstaton se “KNK-ja mund të luajë rol të rëndësishëm në uljen e mospërputhjes së ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore, përmes përkufizimit më të saktë të standardeve të kualifikimeve (me përfshirje të punëdhënësve).”

Paraqitja fillestare tregon se në këtë sistem janë të përfshirë një numër i madh i personave të interesuar të cilët siç duket i përmbahen rreptësisht rregullës ligjore me të cilën janë rregulluar, pa i marrë parasysh edhe dispozitat tjera të përfshira në ligje të ndryshme dhe i trajtojnë si një lloji dispozitave dytësore. Të njëjtat në të shumtën e rasteve i evitojnë gjatë zbatimit. Ndonëse ekziston gërshetim i institucioneve të ndryshme, në disa strategji të caktuara, parashikohet edhe formim i bartësve të ri në të interesave në këtë fushë. Në këtë drejtim, në përputhje me Strategjinë për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përjetshëm 2013-2020, parashikohet formim i: Këshillit për kualifikime, këshillave të profesionit në ATP, qendrave komunale për planifikimin e zhvillimit të resurseve njerëzore, Këshillit për ndjekjen dhe implementimin e Strategjisë për ATP, etj. Nga ana tjetër ka vonesë në formimin e atyre subjekteve që janë të parashikuara me rregullat ekzistuese ligjore, (Këshilli i parë për arsim dhe trajnim profesional i themeluar nga Qeveria e RM-së me vendimin nr.23-5855/1 më 14.08.2013; më pas është marrë Vendim për shpërbërjen e këtij këshilli nr. 24-3496/1 më 11.07.2017 dhe me vendimin numër 24-4409/1 më 03.08. të vitit 2017 është themeluar Këshilli i tanishëm).

Supozimi fillestar i kësaj analize është se baza e tërë sistemit është Ligji për arsimin e mesëm. Kjo ka të bëjë me dy arsye: së pari, pjesa më e madhe e të ashtuquajtur ofertuesjanë shkollat e mesme publike profesionale dhe së dyti, të njëjtët përfshijnë edhe pjesën më të madhe të pjesëmarrësve, gjegjësisht nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional, si në pjesën e arsimit të mesëm profesional trevjeçar, ashtu edhe në pjesën e formave të tjera të arsimit dhe trajnimit profesional. Ajo që është e rëndësishme për analizën tonë në këtë pjesë është që të vendoset korrelacion mes këtij Ligji dhe Ligjit për arsim dhe trajnim profesional.

Paralelisht me këtë, në këtë analizë janë përfshirë 17 ligjedhe 24 aktenë ligjore, ndërsa e gjithë kjo me qëllim që të identifikohen situatat, shtrirja e ndërsjellë dhe eventualisht të përkufizohen jokonsistenca në pikëpamje të çështjeve vijuese: ofertuesit, verifikimet, pjesëmarrësit në programin, kontrata, punëdhënës, institucione, kuadër mësimdhënës në shkollat e mesme, plane dhe programe mësimore, tekste shkollore, vëzhgim, financim dhe subvencionim, siguri gjatë punës, si dhe konstatime nga kjo pjesë e analizës.

Në këtë pjesë të analizës janë prezantuar edhe konstatimet e përgjithshme të paraqitura në intervistat me bashkëbiseduesit të bartësit kryesorë të interesave në pjesën e organizimit dhe funksionimit të sistemit të arsimit të mesëm profesional.

Në pjesën e kornizës ligjore nga bashkëbiseduesit është kërkuar që të *përgatitet Ligji i pastruar zyrtar për arsim të mesëm profesional si dhe të ofrohet zgjidhje më e shkurtër dhe më e thjeshtë ligjore që do t'i integrojë dispozitat prej më shumë ligjeve në një tekst ligjor.*

Nuk duhet harruar se reforma në arsimin profesional katërvjeçar do të implementohet nga viti i ardhshëm shkollor. Në këtë drejtim, pa përjashtim arsimit të detyrueshëm të mesëm vlerësohet si politikë e gabuar që i detyron nxënësit të regjistrohesh në shkollë të mesme pa dëshirë për t'i përvetësuar dituritë dhe shkathtësitë e nevojshme.

Te një pjesë e intervistave të realizuara, është bërë e ditur se *sfidë paraqet edhe jopërshtatshmëria/pa kriteret e qarta të vlerësimit në arsimin fillor, si dhe qasja e lehtë deri te arsimi ilartë që mundëson një numër i madh i nxënësve të arsimit të mesëm profesional në vend se të orientohen drejt tregut të punës të shkojnë të studiojnë.*

### 3.1.1. Ofertues

Grup i posaçëm i interesit janë të ashtuquajtur ofertuesose bartës të organizatës për implementimin e arsimit dhe trajnimit profesional në arsimin formal dhe joformal. Në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional dhe Ligjin për arsim të mesëm, ofertuesit mund t'i ndajmë në: (1) institucion për arsim dhe trajnim pro-

fesional në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional<sup>11</sup> ku parashikohet se institucionet për arsim profesional dhe trajnim janë kompetente të realizojnë arsim të përgjithshëm dhe profesional-teorik dhe trajnim praktik dhe (2) qendra për trajnim profesional që mund të realizojnë vetëm arsim profesional-teorik dhe trajnim praktik.

Institucion për arsim dhe trajnim profesional ka të drejtë: të organizojë dhe realizojë arsim dhe trajnim profesional sipas dispozitave të LAMP-së, për të propozuar ndryshime dhe plotësime të planeve ekzistuese ose të propozojë plane dhe programe të reja mësimore dhe të mund të përfshihet në aktivitetet komerciale dhe ekonomike, ndërsa mjetet financiare të përfituara nga këto aktivitete të shfrytëzohen për përmirësimin e kushteve për punë të institucionit. Nga ana tjetër, si obligime të institucionit janë parashikuar: të sigurojë kushte të sigurta të punës në kuadër të procesit të arsimit dhe trajnimit, t'i përmbushë obligimet nga kontratat për trajnim, t'i dorëzojë kontratat për trajnim në dhomat, të bëjë shqyrtim në realizimin e kontratave për trajnim dhe t'u sigurojë punë dhe nësve informacione kohë për ndryshimet rrjedhëse në planet dhe programet mësimore.<sup>12</sup>

Në përputhje me nenin 26 të LAMP-së, arsimit dhe trajnimit pas arsimit të mesëm mund të realizohet nga institucioni publik dhe privat të verifikuara nga Ministria kompetente.

Bartës i veçantë i procesit arsimor në arsimin dhe trajnimin profesional janë shkollat e mesme publike profesionale. Në RMV në përputhje me nenin 10 të Ligjit për arsim të mesëm<sup>13</sup> themelues të shkollës së mesme mund të jenë: komunat, Qyteti i Shkupit, shteti. Mund të themelohen edhe shkolla të mesme private. Shkollë të mesme private mund të themelojë personi juridik dhe fizik nga vendi dhe jashtë tij.

Ligji për arsim të mesëm i parashikon kushtet në të cilat mund të themelohet një shkollë e mesme publike.<sup>14</sup> Shkollën e mesme e drejton Këshilli i shkollës. Këshilli i shkollës në shkollën e mesme publike përbëhet prej 12 anëtarëve, edhe atë: katër përfaqësues të arsimtarëve, tre përfaqësues të prindërve, gjegjësishtkujdestarëve të nxënësve, tre përfaqësues të themeluesit dhe nga një përfaqësues nga Ministria dhe nga bashkësia afariste.<sup>15</sup> Përfaqësuesi i bashkësisë afariste merr pjesë në punën e Këshillit të shkollës, por nuk ka të drejtën e pjesëmarrjes gjatë votimit dhe marrjes së vendimeve.

<sup>11</sup> Shikoni neni 2 dhe neni 5 i këtij ligji „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

<sup>12</sup> Neni 14

<sup>13</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018

<sup>14</sup> Në përputhje me nenin 11 të Ligjit për arsim të mesëm, shkollë të mesme mund të themelohet, nëse: ekzistojnë nevoja të komunës, qytetit të Shkupit, gjegjësisht shtetit për lloje të caktuara të kuadrove, janë siguruar hapësira dhe pajisje përkatëse për realizimin e arsimit të mesëm, me plan financiar është siguruar nivel i qëndrueshëm i financimit së paku për një gjeneratë të nxënësve në shkollën, është siguruar numër i personave që i plotësojnë kushtet e përcaktuara për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në arsimin e mesëm, të cilët kanë dhënë deklaratë se do të paraqiten në shpalljen publike dhe do të vendosin marrëdhënie të punës, nëse në shpalljen publike përgjedhen dhe – janë përmbushur edhe kushtet e tjera që janë përcaktuar me normativët dhe standardet për themelimin e shkollës së mesme për shkak të ushtrimit të arsimit të mesëm.

<sup>15</sup> Përfaqësuesit e prindërve, gjegjësisht kujdestarëve të nxënësve i emëron dhe shkarkon Këshilli i prindërve, përfaqësuesit e arsimtarëve i emëron dhe shkarkon Këshilli i arsimtarëve të shkollës, përfaqësuesit e Ministrisë i emëron dhe shkarkon ministri, ndërsa përfaqësuesit e bashkësisë afariste i propozojnë odat në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Neni 88 nga LAM-i.

Si kompetenca kryesore të Këshillit të shkollës, në përputhje me nenin 89 të LAM-it, janë parashikuar: (1) propozim i programit vjetor të punës dhe raport për punën deri te Ministria; (2) propozim i planit vjetor financiar dhe llogarisë përfundimtare deri te Ministria. Në përputhje me nenin 95 të LAM-it, si organe dhe trupa profesionale të shkollave të mesme publike janë përcaktuar: këshilli i arsimtarëve të cilin e përbëjnë arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional; këshilli i vitit, gjegjësisht këshilli i profesionit të cilin e përbëjnë mësindhënësit që mbajnë mësim dhe bashkëpunëtorët profesional: këshilli i paraleles; udhëheqës i paraleles dhe aktivet profesionale të mësindhënësve në fusha të caktuara profesionale.

Në Ligjin për arsimin e të rriturve<sup>16</sup> janë parashikuar edhe dispozita që kanë të bëjnë me këtë segment specifik të arsimit. Ky ligj si realizues, gjegjësishtsi ofertues të shërbimeve për arsimin e të rriturve në nenin 2, i përcakton: a) shkollat, institucionet e larta arsimore, si dhe entet e specializuara për arsimin e të rriturve dhe b) person juridik ose fizik që ka regjistruar veprimtari për arsimin e të rriturve. Ofertuesit nga neni 2 i këtij Ligji, janë saktësuar në nenin 5: institucionet publike dhe private për arsimin e të rriturve, institucionet për arsimin e të rriturve, qendrat për përsosje, punëdhënësit dhe partnerët social, shoqatat ose trajnuesit individual të cilët i plotësojnë kushtet e parashikuara me ligjin. Ligji për Arsimin e të Rriturve në nenin 14 i përcakton të drejtat dhe obligimet e ofertuesve.<sup>17</sup>

Kategori e posaçme e ofertuesve është parashikuar në Ligjin për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm. Në këtë drejtim, ofertues të veçantë të shërbimeve arsimore, në përputhje me këtë ligj<sup>18</sup> janë universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm që paraqesin institucione që ushtrojnë: shërbim publik si veprimtari nga fusha e arsimit formal të personave të rinj dhe të rritur (arsim fillor për të rritur, arsim të mesëm për të rritur, aftësim profesional, arsim profesional për profesion, arsim teknik dhe arsim pas arsimit të mesëm për të rritur, rikualifikim dhe kualifikim plotësues) në përputhje me LARR-in, si dhe arsimin joformal të të rinjve dhe personave të rritur për aftësim për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal në përputhje me LARR-in.

Sipas nenit 3 të LUHQ-së, parashikohet se universitet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm janë institucione publike, të përziera ose private që ushtrojnë veprimtari me interes publik. Universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm kanë rolin e personave juridik dhe statutin e tyre.

Në statutin e universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm pëlqimin e jep MASH-i, pas mendimit paraprak pozitiv nga BZHA-ja, QATP-ja dhe QARR-i. Organ drejtues është Këshilli drejtues të cilin e përbëjnë pesë anëtarë: dy anëtarët nga radhët e të punësuarve në universitetin e hapur qytetar për mësim të përjetshëm,

<sup>16</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>17</sup> Në përputhje me Ligjin për arsimin e të rriturve (neni 14), si të drejta të ofertuesve të shërbimeve për arsim janë të përcaktuara: organizojnë dhe realizojnë arsim të të rriturve sipas dispozitave të këtij ligji dhe propozojnë ndryshime dhe plotësime të programeve ekzistuese ose propozojnë programe të reja. Krahas të drejtave, janë parashikuar edhe obligimet e tyre, edhe atë: të realizojnë në mënyrë cilësore programin e arsimit të të rriturve, të sigurojnë kushte të sigurta për punë në kuadër të procesit të arsimit, t'i plotësojnë obligimet nga kontratat me pjesëmarrësit dhe – të dorëzojnë deri te Qendra raporte vjetore për planet dhe programet mësimore të cilat realizohen, numri i pjesëmarrësve, kuadri i angazhuar në mësim etj.

<sup>18</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

dy anëtarë të cilët i emëron themeluesi i universitet të hapur qytetar dhe një anëtar nga MASH-i. Në nenin 10 parashikohet se universitetin e hapur e drejton drejtori. Organ profesional është Këshilli i arsimtarëve të cilin e përbëjnë mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional.

Në kontekst të arsimit profesional, duhet të shqyrtohet edhe potenciali i arsimit e lartë. Në këtë drejtim, lloj i veçantë i ofertuesit mund të jenë edhe institucionet e arsimit e lartë, gjegjësisht universitetet dhe shkollat e pavarura dhe të larta profesionale. Në fakt edhe në përputhje me nenin 4 të Ligjit për arsim të lartë<sup>19</sup>, si një prej qëllimeve të arsimit të lartë përmendet forcimi i punësimit, kompetitivitetit dhe konkurrencës së të rinjve dhe të rriturve. Por, krahas arsimit të lartë formal, institucionet e larta arsimore kanë potencial të madh që t'u përkushtohen edhe formave të tjera të arsimit profesional, si dhe të vendosin bashkëpunim të veçantë me bashkësinë afariste, duke marrë parasysh mundësitë e parashikuara në nenin 85 të LAL-it, e veçanërisht paragrafit (4) sipas të cilit, universiteti, mund të ketë edhe njësi të tjera të brendshme organizative me të cilat ndërlihet praktika, dituria, arti dhe arsimit i lartë dhe në punën e të cilëve mund të marrin pjesë studentët (qendra kulturore studentore, byro inxhinierie, punëtori, qendra për këshilla juridike dhe afariste, qendra për punë sociale dhe ndihmë tjetër të qytetarëve, qendra provuese prodhuese, galeri, radio dhe TV stacione dhe parqe teknologjike).

Në kuadër të hulumtimeve të realizuara, që kanë të bëjnë me këtë çështje është arritur konstatimi se arsimiti profesional realizohet "sipas inercisë", pa entuziazëm, motivim, inovacion. Ndikimi i fuqishëm politik i kuotave për regjistrimin e nxënësve, hapja e profileve sipas çelësit etnik, punësim sipas linjës partiake, etj. Sa i përket menaxhimit të shkollave, është përmendur praktika e shpeshtë e emërimit të drejtorëve politikisht të volitshëm. Në këtë drejtim, është propozuar që kriteret për emërimin e drejtorëve të jenë më rigorozë dhe veçanërisht t'i kushtohet kujdes periudhës së tranzicionit, gjegjësisht largimit të drejtorit të vjetër dhe vendosje në detyrë të drejtorit të ri.

Nga shumica e të anketuarve në intervistat është bërë e ditur se nuk ekziston interes i madh për pjesëmarrje të përfaqësuesve nga bashkësia afariste në punën e këshillave të shkollës në shkollat e mesme profesionale. Përfaqësues të bashkësisë afariste marrin pjesë në punën e këshillave të shkollës në ato shkolla në të cilat marrin kompensim për punën e tyre. Një pjesë e bashkëbiseduesve konsiderojnë se përfaqësuesi i bashkësisë afariste nuk duhet të marrë pjesë në punën e këshillit të shkollës për shkak të mungesës së çfarëdo interesi për këto çështje.

Më në fund, duhet të theksohet se një pjesë e bashkëbiseduesve nuk i dinë rregullat themelore ligjore që e rregullojnë arsimin e mesëm profesional dhe si rrjedhojë e kësaj, kompetencën e tyre në procesin arsimor.

<sup>19</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 82/2018.

**TABELA 11: OFERTUES****Rekomandime**

- Rritje të pavarësisë dhe kompetencave të shkollave të mesme publike dhe themeluesve të tyre në raport me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Zhvillim i ofertuesve ekzistues të arsimit dhe trajnimit profesional dhe themelim të ofertuesve të rinj përmes nxitjes së iniciativës të bashkësia afariste dhe vetëqeverisja lokale. Të përkufizohen edhe me ligj mënyrat konkrete të mbështetjes së këtyre subjekteve (ndihma shtetërore, subvencione, lehtësime, lirim prej taksave dhe kompensimeve për verifikimin e programeve dhe investimeve, etj.).
- Përgatitjen e teksteve të pastruara zyrtare ligjore bashkë me komente të ligjeve me qëllim që të lehtësohet zbatimi i tyre (drejtorët e shkollave, ekipi i menaxhmentit të ofertuesve të tjerë si dhe organet drejtuese në pjesën më të madhe nuk janë juristë).
- Zhvillim i partneriteti publik privat në pjesën e themelimit dhe organizimit të ofertuesit.
- Nxitje të themelimit të shkollave private të mesme profesionale.
- Vendosje të konceptit të vetëvlerësimit të ofertuesvetë arsimit formal dhe joformal në një periudhë të caktuar kohore.
- Rishikim i dispozitave nga Ligji për arsim të mesëm me qëllim të forcimit të pozicionit të përfaqësuesit të bashkësisë afariste në këshillin e shkollës. Rritje të numrit të përfaqësuesve të bashkësisë afariste në këshillat e shkollës në 2 përfaqësues.
- Krijim i strategjisë për pjesëmarrje më aktive në punën e këshillit të shkollës të përfaqësuesvetë prindërve, si dhe vendosje të anëtarit të këshillit të shkollës nga radhët e nxënësve.
- Parashikim i dispozitës që në këshillin e shkollës në shkollë të mesme profesionale detyrimisht të ketë përfaqësues prej mësimdhënësve që mbajnë mësim nga lëndët profesionale.
- Rekomandohet që përfaqësuesit në këshillin e shkollës të deleguar nga themeluesi (vetëqeverisja lokale ose shteti), të jenë ata që kanë të bëjnë me procesin arsimor (më konkretisht, me arsimin e mesëm profesional).

**3.1.2. Verifikim**

Verifikimi është proces me të cilin janë parashikuar një varg procedurash për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve nga subjektet që kanë për qëllim të ushtrojnë veprimtari ose të ndërmarrin veprim në arsimin dhe trajnimin profesional.

Në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional parashikohen procedura të verifikimeve që përfshijnë: punëdhënësit që realizojnë trajnim praktik në përputhje me nenin 13 të LATP-së dhe verifikim të bartësve të arsimit pas arsimit të mesëm të institucioneve publike dhe private në përputhje me nenin 26 të LATP-së.

Sa i përket verifikimit të punëdhënësit, ata mund të ushtrojnë trajnim praktik për nxënës, nëse i përmbushin kushtet në raport me hapësirën, pajisjen dhe kuadrin përkatës. Standardet për pajisjen dhe kushtet hapësinore i përpilon QATP-ja, ndërsa i miratojnë Odatpër fushën e tyre.

Standardi për kuadër profesional dhe kuadër tjetër për zbatimin e trajnimit praktik të punëdhënësit e përgatitë QATP-ja, ndërsa e miratojnë odatpas mendimit paraprak pozitiv të MASH-it. Verifikimin e përmbushjes së kushteve e bëjnë odat.

Kompetent për verifikimin e enteve publike dhe private për arsimin pas arsimit të mesëm është MASH-i. Kushte për verifikimin e entit për arsim pas arsimit të mesëm janë rregulluar me ligj. Standardet dhe normativet i përpilon QATP-ja, ndërsa i miratojnë odatpas mendimit paraprak pozitiv të Ministrisë.

Procedura të posaçme për verifikim janë parashikuar në përputhje me LARR-in<sup>20</sup> dhe ato kanë të bëjnë me 2 raste: a) verifikimin e programeve të veçante për arsimin e të rriturve dhe b) verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve.

Procedurën e verifikimit të programeve e fillon enti ose institucioni për arsimin e të rriturve që dëshiron të ushtrojë arsimin e të rriturve për profesione, i cili dorëzon deri te Qendra kërkesë për verifikimin e programit të veçantë bashkëngjitur me dokumentacionin e nevojshëm. LARR-i rregullon çështjet që kanë të bëjnë me dokumentacionin që dorëzohet, si dhe lidhur me afatet për procedimin e procedurës.

Shpenzimet për verifikimin e programeve bien në ngarkesë të parashtruesit të kërkesës. Lartësinë e mjeteve për shpenzimet për verifikimin e programeve, e përcakton Këshilli Drejtues i Qendrës në bazë të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së programit që verifikohet. Verifikimin e programeve e bën Qendra pas mendimit të dorëzuar parapraktë Komisionit për verifikimin e programeve të veçanta për arsimin e të rriturve që e formon drejtori i Qendrës.

Nga ana tjetër, verifikimin e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve e bën MASH-i. Enti dhe institucioni për arsimin e të rriturve mund të realizojë programe të veçanta të verifikuara për arsimin e të rriturve, nëse ka hapësirë, pajisje dhe kuadër përkatës për realizimin e atyre programeve, për çka përmes Qendrës parashtron kërkesë në Ministri për verifikimin e entit ose institucionit. Standardet për pajisjen, hapësirën dhe kuadrin i përcakton ministri, me propozim të Qendrës.

Më në fund, me rëndësi të veçantë për verifikimin e punëdhënësve që realizojnë trajnim praktik është dokumenti i QAMP-së “Standarde për realizimin e trajnimit profesional të nxënësve të punëdhënësit” (2012), që i përshkruan standardet për kushtet hapësinore dhe pajisjet, si dhe standardet për kuadrin profesional dhe kuadërtjetër.

**TABELA 12: VERIFIKIM**

**Rekomandime**

- Standardet dhe normat kryesore që duhet të përmbushen në pjesën e verifikimit, të jenë të rregulluara me ligj ose me akt nënligjor të Ministrisë kompetente.
- Respektim rigoroz i kushteve që janë bazë për të përvetësuar verifikim dhe vëzhgim të vazhdueshëm të plotësimit të tyre më vonë.
- Mundësim i mbështetjes financiare të ofertuesve për shpenzimet që do t'i kishin bërë në procesin e verifikimit si për pjesën administrative, ashtu edhe për plotësimin më të lehtë të kushteve dhe standardeve. Kjo veçanërisht duhet të ndërlihet me ofertuesit të cilët ofrojnë trajnime që janë me rëndësi dhe nevojë të veçantë për punëdhënësit.

### 3.1.3. Pjesëmarrës në programin

Në këtë pjesë të analizës do të shqyrtojmë statusin juridik të nxënësve dhe pjesëmarrësve në trajnim në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional (LATP) dhe Ligjin për arsim të mesëm (LAM).

<sup>20</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

Në përputhje me nenin 32 të LAM-it, arsimit i mesëm mund të jetë i organizuar si arsim i mesëm profesional. Në arsimin profesional regjistrohen nxënës të rregullt dhe me korrespondencë që kanë mbaruar arsimin fillor.<sup>21</sup> Arsimit publik profesional mund të jetë me kohëzgjatje trevjeçare ose katërvjeçare, si dhe arsim të specializuar. Në aftësimin profesional në kohëzgjatje deri dy vite përfshihen edhe persona pa arsim të mbaruar fillor, por menjëherë pas aftësimin profesional mbarohet edhe programi i parashikuara për arsim fillor. Në vitin e parë të shkollës publike si nxënës i rregullt mund të regjistrohet personi që nuk është mbi moshën 17 vjeç, ndërsa nxënës me nevoja të posaçme arsimore të jetë personi që nuk është mbi moshën 25 vjeç.<sup>22</sup> Në përputhje me nenin 41 të LAM-it, nxënës me korrespondencë janë personat të cilët arsimin e përvetësojnë me vetë-arsimim, përmes dhënies së provimeve për plan dhe program të caktuar në arsimin e mesëm. Si nxënës me korrespondencë mund të regjistrohet personi që plotëson njërin prej kushteve vijuese: (1) të jetë më i vjetër se 17 vjet; (2) të jetë në pushim mjekësor një periudhë më të gjatë; (3) t'i jetë shqiptuar masë pedagogjike përjashtim nga shkolla, (4) të jetë në marrëdhënie të punës dhe në rastet tjera të përcaktuara me statutin e shkollës së mesme.

Të drejtat e nxënësve në arsimin e mesëm profesional janë rregulluar me Ligjin për arsim të mesëm (LAM) si ligj themelor dhe me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional (LATP). Të drejtat që u takojnë nxënësve në përputhje me LAM-in janë të drejtat themelore që u takojnë të gjithë nxënësve të përfshirë në arsimin e mesëm, derisa të drejtat që u takojnë nxënësve në përputhje me LATP janë të drejta që janë të lidhura ngushtë me procesin e trajnimit praktik. Në përputhje me LATP<sup>23</sup>, në nenin 22 janë definuar të drejtat dhe obligimet e nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional. Nxënësit kanë të drejtë të kalojnë nga një degë në degë tjetër të arsimit dhe trajnimit profesional, gjegjësisht nga njëri nivel në nivel tjetër të kualifikimeve profesionale, gjatë kohës së trajnimit të marrin kompensim për punën që e kryejnë te punëdhënësi, të përcaktuar në marrëveshje, ta shfrytëzojnë pushim veror dhe dimëror, ta prishin marrëveshjen, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje. Në mënyrë të veçantë janë rregulluar edhe obligimet e nxënësve, me të cilat rregullohet përkushtimi i tyre ndaj procesit arsimor dhe përgjegjësia ndaj mjeteve të punës dhe mjedisit të punës të punëdhënësit.

Ndikim të madh në krijimin e politikave në arsimin e mesëm profesional katrendi i përgjithshëm i uljes së numrit të nxënësve. Në këtë drejtim, në intervistat është theksuar se *ulja ka të bëjë me shumë faktorë: rritjen e ulur natyrore të popullatës, migrimit të vazhdueshëm dhe të përkohshëm, etj. Për shembull, në Komunën e Strumicë-gjatë vitit thjeshtë nga evidenca "zhduken" rreth 80 nxënës të cilët bashkë me prindërit e tyre shkojnë për të kryer ndonjë punë sezonale në vendet e rajonit dhe BE.*

Përveç kësaj, ekziston trend i përgjithshëm i uljes së interesit për arsim të mesëm profesional me disa përjashtime. Në Komunën e Tetovës viteve të fundit erdhi deri te ndryshimi i interesit të nxënësve në arsimin e mesëm. Kështu, sipas të dhënave të ko-

<sup>21</sup> Neni 34 nga LAM-i

<sup>22</sup> Neni 42 nga LAM-i

<sup>23</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

*munës, në vitin shkollor 2013/14 rreth 65% e nxënësve kanë mësuar në arsimin e gjimnazit, ndërsa në vitin shkollor 2017/18, 65% e nxënësve mësojnë në arsimin e mesëm profesional.*

Në kuadër të intervistave, janë përfshirë edhe çështje për iniciativat për motivimin e nxënësve dhe prindërve të tyre për regjistrim në arsimin e mesëm profesional. Në këtë drejtim, është theksuar se viteve të fundit bëhet përzgjedhja e nxënësit më të mirë (lider) në vitet e fundit të arsimit të mesëm profesional. Për këtë konkurs nuk ka interesim të madh. Te një pjesë e komunave, për shkak të rrjetit joracional për akomodim në konvikte të nxënësve nga qytetet e tjera, nuk regjistrohen nxënës ndonëse ka interes për mësim në arsimin e mesëm profesional. Për shembull, në rastin e Komunës së Strumicës vendet në konvikte plotësohen në bazë të suksesit nga arsimit i mesëm me çka nxënësit në arsimin profesional nuk janë konkurrues për shkak të suksesit më të dobët mesatar. Nga ana tjetër, në rajonin e planifikuar jugperëndimor nuk ekzistojnë probleme të këtij lloji. Duhet të theksohet se viteve të fundit janë duke u shpallur konkurse për bursa për nxënës të cilët mësojnë në profesionin turistik-hotelier me qëllim që të tërhiqen më shumë nxënës për këtë profesion deficitar. Nevoja përmë shumë bursa është theksuar në disa shkolla. Në mënyrë plotësuese, duhet të shqyrtohen mundësitë edhe për mbrojtje më të mirë të nxënësve gjatë trajnimit praktik.

Në kuadër të bisedave, u imponua edhe ideja se pjesëmarrja e nxënësve në punën e këshillave të shkollës do të kontribuojë në rritjen e motivimit të tyre.

Në mënyrë plotësuese, prej disa të anketuarve është theksuar se kualifikimet dhe shkathësitë që i përvetësojnë nxënësit në arsimin e mesëm nuk korrespondojnë me nevojat e kompanive; nuk ekziston interes për profilet trevjeçare në arsimin e mesëm profesional (ky lloj i arsimit duhet të përpilohet seriozisht dhe të forcohet). Përveç kësaj, në mjediset ku realizohet trajnim praktik, nxënësit përballen me numër më të madh të sfidave: trajnim joadekuat për profilin për të cilin përgatiten, sistemim në vend joadekuat në procesin e punës (për shembull, kryerjen e ri-ngarkimit të mallit) etj. Mungesa e mundësive për punë praktike në kompanie nxënësve është notuar vazhdimisht edhe në raportet për përparimin e vendit që i publikon Komisioni Evropian. Kuptohet, mbyllja e kapaciteteve të mëdha prodhuese gjatë periudhës së tranzicionit kontribuoi në uljen e numrit të vendeve të lira për profesione dhe profile të caktuara (për shembull industria e tekstilit).

Një pjesë e shkollave kanë materiale promovuese dhe mbajnë ngjarje për prezantimin e programeve në shkollat fillore. Si ide u imponua edhe nevoja e bashkëpunimit më të ngushtë dhe puna me prindërit e kandidatëve potencial për regjistrim në arsimin profesional, si dhe programe dhe qasje më të mira për orientimin profesional në arsimin fillor.

Sa u takon nxënësve me korrespondencë, në intervistat është theksuar se ekziston interes për këtë lloj të përvetësimit të kualifikimit. Profili i tyre me persona nga katego-

*ritë vijuese: persona më të rritur me arsim të pambaruar që duan të bëhen me diplomë, persona më të rinj që e kanë braktisur arsimin në vitet e fundit të arsimit profesional për të punuar<sup>24</sup> si dhe persona që duan të ri-kualifikohen, në të shumtën e rasteve me dëshirë që të punojnë jashtë vendit.*

Lidhur me inkluzionin e nxënësve me nevoja të posaçme, duhet të ceket se përvoja maqedonase, gjegjësisht korniza ligjore dhe rregullat nënligjore duhet t'i pranojë dhe integrojë më seriozisht standardet relevante ndërkombëtare.<sup>25</sup> Kornizën ndërkombëtare juridike dhe standardet në fushën e arsimit inkluziv i përcaktojnë: Konventa për të Drejtat e Personave me Pengesë (KDPP), Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe Deklarata e UNESCO-s për arsim të mbështetur në nevojat e posaçme nga Salamanka. Lidhur me këtë çështje, nevojitet rritje e kapaciteteve të mësimdhënësve, të cilët në përputhje me Ligjin për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme janë të obliguar të kenë edhe kompetenca të posaçme për inkluzion social dhe arsimor, si dhe sipas Rregullores për kompetenca themelore profesionale të arsimtarëve në shkollat fillore dhe të mesme sipas fushave. Në këtë drejtim, inkluzioni arsimor është përshkruar si fushë e cila ka të bëjë me: „...njohuritë e mësimdhënësve për koncepte dhe modele të ndryshme për arsim inkluziv, konventa për të drejtat e fëmijëve dhe për antidiskriminim, llojet e ndryshme të nxënësve të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsim: nevoja të posaçme arsimore, vështirësi në nxënie dhe mangësi për arsye socio-ekonomike, si dhe të kuptuarit e faktorëve social dhe kulturor dhe mënyrës në të cilën ata ndikojnë në arsimin dhe kohezionin social“. Në mënyrë plotësuese, në dokumentin „Udhëzim për inspektorët shtetërorë të arsimit për vlerësimin dhe përmbushjen e detyrave të punës të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në arsimin fillor dhe të mesëm“, në fushën mësimi, në pikën 1.2, është potencuar se “arsimtari vlerësohet me pesë pikë nëse realizon mësim në paralele në të cilën janë të përfshirë nxënësme nevoja të posaçme arsimore (me inkluzion)”. Nënenin 39 të LAM-it është parashikuar se në arsimin emesëm për nxënës me nevoja të posaçme të arsimit arsimohen nxënësit sipas programeve të përshtatura për profesione përkatëse, gjegjësisht profile arsimore ose për aftësim për punë. Varësisht nga përcjellja e programeve të përshtatura për profesione përkatëse, gjegjësisht profileve arsimore, nxënësit me nevoja të posaçme arsimore, mund ta japin provimin e maturës shtetërore ose provimin përfundimtar. Më tutje, parashikohet që në arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore të përfshihen nxënësit të cilët janë evidentuar dhe radhitur sipas llojit dhe nivelit të pengesave në zhvillim. Njëra prej mënyrave për realizimin e të drejtave të nxënësve me nevoja të posaçme është formimi i ekipit inkluziv, të përbërë prej pedagogut, gjegjësisht psikologut të shkollës, mësimdhënësi i nxënësit, prindi, gjegjësisht kujdestari i nxënësit, defektologu nëse ka në shkollë dhe sipas nevojës mund të përfshihet edhe mjeku i nxënësit, i cili përpilon plan individual arsimor.

Çështja e inkluzionit të personave me nevoja të posaçme është përfshirë edhe në rregullat ligjore që kanë të bëjnë me librat shkollorë. Në këtë drejtim, në nenin 2 të Ligjit për libra shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm është cekur se libri shkollor

<sup>24</sup> Në rajonin e Shkupit, kemi shembuj të braktisjes masive të shkollës profesionale pasi të arrihet moshja 17 vjeçe me qëllim që të punohet në të shumtën e rasteve në tregjet e gjelbra.

<sup>25</sup> Për standardet ndërkombëtare shiko më shumë: UNICEF – Drejt arsimit gjithëpërfshirës, faq. 10, 17,

është mjeti themelor mësimor dhe burim i diturisë për realizimin e qëllime edukativo-arsimore të përcaktuara në planin dhe programet mësimore për arsim fillor dhe të mesëm. Te asnjëri prej neneve të Ligjit nuk është përmendur se librat shkollorë duhet të përpunohen edhe në formatin që do të jetë i kapshëm për të gjithë nxënësit, duke përfshirë librat shkollorë elektronik në format të kapshëm, libra shkollorë të Alfabetit të Brajlit, libra shkollorë që lexohen lehtë dhe ngjashëm.

Krahas kësaj në asnjërin prej neneve të LATP-së nuk është cekur se edhe nxënësit me pengesë kanë të drejtën e arsimit dhe trajnimit profesional, ose nga ana tjetër, se duhet të merren parasysh përshtatjet në raport me qasjen fizike të objekteve për arsim dhe trajnim profesional, përgatitje të planeve individuale arsimore për arsim dhe trajnim profesional, qasje deri te materialet për mësim ose pajisje të përshtatur për mbrojtje gjatë punës. Për shembull, në nenin 13 të LATP-së që ka të bëjë me verifikimin e punëdhënësve për realizimin e trajnimit praktik, në paragrafin 1 nuk është përmendur se plotësimi i kushteve në raport me hapësirën, pajisjen dhe kuadrin përkatës duhet t'i ketë parasysh edhe nevojat e nxënësve me pengesë. Neni 13 i Ligjit të njëjtë nuk parashikon qasje deri te institucione për arsim profesional, si kusht për verifikim. Më tutje, neni 18 ku është dhënë një përshkrimi llojeve të arsimit profesional, kohëzgjatjes dhe niveleve të kualifikimeve profesionale nuk përmend se edhe nxënësit me pengesë mund të përvetësojnë një lloj të arsimit profesional, si dhe se duhet të kenë të drejtën e planeve individuale arsimore me qëllim që të përvetësojnë arsimin e nevojshëm.

Në kontekst të kësaj çështjeje, duhet të theksohet se Strategjia për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përjetshëm (2013-2020), në pjesën e mbështetjes së nxënësve me nevoja të posaçme arsimore i parashikon masat vijuese: (1) deri në vitin 2015 të sigurohet trajnim i mësimdhënësve në ATP për punë me këtë kategori në shkollat e rregullta; (2) deri në vitin 2020 të përshtaten planet dhe programet mësimore në shkollat e rregullta për këta nxënës, si dhe (3) deri në vitin 2016 të përmirësohen kapacitetet fizike në SHMP-të e rregullta për këta nxënës.

Në kuadër të intervistave të realizuara janë përfshirë edhe pyetje që kanë të bëjnë me nxënësit me nevoja të posaçme. Në këtë drejtim, në disa raste është theksuar se shkollat profesionale përballen edhe *me sfida nëpunën me këtë kategori të nxënësve*.

Te një pjesë e shkollave *nuk kanë nxënës me nevoja të posaçme*. Në Strumicë funksionojnë dy shkolla inkluzive. Në arsimin e gjimnazit në Tetovë *nuk ka nxënës me nevoja të posaçme për dallim nga arsimit i mesëm profesional*.

Në disa shkolla ishte sugjeruar nevoja për ndryshimin e qasjes për përfshirjen e personave me pengesë. Është bërë e ditur se *vetë mësimdhënësit nuk janë të trajnuar sa duhet për punë me këta nxënës*. Sfidë plotësuese te shkollat paraqet fakti që një pjesë e madhe e personave me nevoja të posaçme gjatë regjistrimit në shkollë të mesme *nuk kanë kategorizim të invaliditetit*. Në njërin prej shkollave të vizituara, *vetëm për*

*1 prej pesëdhjetë nxënësve me nevoja të posaçme/vështirësi kanë vërtetim me të cilin është përcaktuar niveli i invaliditetit. Përveç kësaj, në shkollat nuk ka defektologë të cilët u nevojiten për mbështetje në punën me këta nxënës. Transporti për persona me nevoja të posaçme organizohet nëse prindërit e kërkojnë atë.*

Sipas një pjese e të intervistuarve, inkluzionishkon në skajshmëri të fëmijët me nevoja të posaçme. Një pjesë e të punësuarve në shkolla, konsiderojnë se përkundër theksit të madh në këtë çështje, nuk është arritur përparim në këtë çështje. („Inspektive ka vazhdimisht, por zgjidhje praktike për sfidat me të cilat përballemi nuk ka”; „Në punën me nxënësit me nevoja të posaçme gjithçka është në letër“).

Në përputhje me nenin 27 të LAMP-së, në institucionet për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm mund të regjistrohen persona të cilët janë punësuar te punëdhënësit ose janë të papunë dhe të cilët: duan të përsosin kualifikimet e tyre dhe duan të pajisen me specializim të ri, me kusht nëse kanë mbaruar arsimin teknik ose arsim profesional për profesion, në përputhje me nenin 18 të LAMP-së. Në arsim e specializuar mund të përfshihet edhe personi që ka mbaruar arsim të gjimnazit ose të arteve dhe me përvojë pune përkatëse trevjeçare. Të drejtat dhe obligimet e personave të regjistruar në institucionet për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm përcaktohen në marrëveshjen e lidhur me personit pjesëmarrës dhe institucionit për arsim dhe trajnim pas arsimit të mesëm.

Sa u përket pjesëmarrësve në trajnim në përputhje me Ligjin për arsimin e të rriturve<sup>26</sup>, në nenin 2 si pjesëmarrës përkufizohet “personi i cili përfshihet në programet arsimore për të rritur dhe i cili paraprakisht i ka plotësuar kushtet në aspekt të arsimit të detyrueshëm paraprak dhe persona të tjerë të cilët arsimohen, kurse nuk e kanë statusin e nxënësit“. Pjesëmarrës në programet e arsimit për të rritur mund të jetë personi i cili i ka mbushur 15 vjet dhe i cili i përmbush kushtet e tjera të përcaktuara me programin. Statusi i pjesëmarrësit merret me lidhjen e marrëveshjes për t’u inkuadruar në programin e arsimit për të rritur. Të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në programet arsimore për të moshuar janë rregulluar në nenin 28 të LAMP-it.

Në raport me nxënësit dhe pjesëmarrësit në trajnim në përputhje me Ligjin për universitete të hapura qytetare për mësim të përjetshëm<sup>27</sup>, ky ligj njih dy kategori: nxënës dhe pjesëmarrës. Në nenin 2, si "nxënës" është përkufizuar personi që i shfrytëzon shërbimet e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përjetshëm nga fusha e arsimit formal të të rinjve dhe personave të rritur, në përputhje me LAMP-in, derisa "pjesëmarrës" është personi që i shfrytëzon shërbimet e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përjetshëm nga fusha e arsimit joformal të të rinjve dhe personave të rritur, në përputhje me LAMP-in.

<sup>26</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>27</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

Më në fund, në fund të kësaj pjese do të ndalemi në statusin juridik të çirakëve dhe mundësitë për trajnim praktik në përputhje me Ligjin për zejtari (LZ-së). Në këtë ligj veçanërisht përpunohet mundësia për punë të çirakut. Në përputhje me nenin 43 të LZ-së, puna e çirakut është periudha të cilën personi i papunë e kalon në vendin e punës të ushtruesi i veprimtarisë zejtare me qëllim që të marrë shkathtësi, kompetenca dhe njohuri për mësimin e zebes së caktuar. Në nenin 44 parashikohen kushtet kur mund të paraqitet ndonjë person si çirak dhe me këtë rast përcaktohet se Çirak në pajtim me këtë ligj, mund të jetë personi i cili ka së paku 15 vjet dhe i cili është i papunë. Në nenin 46 të LZ-së, parashikohet se, puna e çirakut mund të zgjasë jo më shumë se 12 muaj, me ç'rast punëdhënësi gjatë vitit mund të angazhojë jo më shumë se dy çirakë. Nëse i analizojmë të drejtat që i takojnë çirakut në përputhje me LZ-në, do të vërejmë se në përputhje me nenin 47, çirakut mes tjerash i takon:(1) e drejta të shfrytëzojë mjete për mbrojtje gjatë punës në përputhje me rregullat për mbrojtje gjatë punës, si dhe 2) për kompensim mujor në lartësi jo më të vogël se 15% nga bruto rroga mesatare e paguar në Republikë në vitin paraprak. Në këtë drejtim, përkundër të drejtave standarde, për çirakët janë përkufizuar qartë edhe këto të drejta, të cilat mungojnë për personat që janë të përfshirë në trajnimin praktik në përputhje me LATP-në dhe LARR-in. Në nenin 54, paragrafi (2) parashikohet se pas përfundimit të punës së çirakut, çiraku ka të drejtë të japë provim dhe të marrë diplomë për zejen e mësuar.

Në kuadër të intervistave të realizuara janë përfshirë edhe çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar të pjesëmarrësve në programet. Menjëherë duhet të theksohet se në këtë pjesë *shkollat kanë përvojë jashtëzakonisht pozitive*. Ky konstatim veçanërisht ka të bëjë me *mundësitë për mobilitet që i ofron programi „Erasmus+“ i Bashkimit Evropian*. Pjesa më e madhe e shkollave kanë marrë pjesë në këtë lloj të programeve dhe kjo ka paraqitur përvojë jashtëzakonisht pozitive si për nxënësit ashtu edhe për arsimtarët.

Në këtë drejtim, imponohet nevoja për *përmirësimin e kapaciteteve të shkollave dhe komunave për aplikim për projekte ndërkombëtare duke përfshirë programin Erasmus+ madje edhe në nivel komunal*. Komunitat nuk perceptojnë mundësinë që të ndërmeretësojnë mes shkollave të mesme profesionale dhe kompanive për organizimin e trajnimit praktik ose të mbajnë bazë të të dhënave me mundësi për trajnim profesional në kuadër të vetë komunës.

**TABELA 13: PJESËMARRËS NË PROGRAM**

**Rekomandime**

- Rregullim më i hollësishëm dhe më i saktë i të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrësve në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional për rregulla të domosdoshme juridike të përfshira në ligj.
- Të shqyrtohen mundësitë për subvencionimin e së drejtës së kompensimit të nxënësve dhe pjesëmarrësve në trajnimet në frymën e Ligjit aktual për veprimtari zejtare (pagesë të kompensimit mujor nga ushtruesi i veprimtarisë zejtare ose Buxheti i RM-së përmes planit veprues për programe dhe masa aktive për punësim në APRM, ose projekte dhe burime të tjera).
- Vëmendje e posaçme gjatë dizajnit të kornizës ligjore për të drejtën e kompensimit duhet të kushtohet gjatë përcaktimit të kësaj të drejte dhe proporcionit të saj me të drejtat e papunësisë.

- Duhet të rregullohet në mënyrë më të hollësishe e drejta e mungesës për shkak të pjesëmarrjes në programin arsimor për të rritur. Gjithashtu, mund të bëhet dallim se kur nxënësi është udhëzuar në trajnim nga punëdhënësi, e kur e bën këtë me iniciativë personale.
- Në pjesën e punës së çirakut të përkufizohet një strategji e veçantë për zhvillimin e zëjarisë në kontekst të arsimit të mesëm dhe zyrtarizimit të kësaj forme të përvetësimit të kompetencave. Në mënyrë plotësuese, duhet të vendoset nëse puna e çirakut do t'u afrohet formave të LAMP-sëose do të mbetet në këtë nivel.
- Vendosja e kornizës së saktë dhe konkrete për mbrojtje nga diskriminimi të nxënësve me nevoja të posaçme. Në këtë drejtim, implementim i konceptit të inkluzionit në mënyrë përkatëse edhe në Ligjin për arsim dhe trajnim profesional.
- Vendosje të dispozitave për mundësimin e qasjes së nxënësve me nevoja të posaçme në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional, si në objektet e ofertuesve ashtu edhe te punëdhënësit e verifikuar (përmbushja e këtyre kushteve do të ishte bazë për marrjen e verifikimit),
- Plotësim i rregullave ligjore në pjesën e obligimit të detyrueshëm për përpilimin e teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera mësimore dhe konkretizuese në përputhje me nevojat e nxënësve me nevoja të posaçme.
- Mbajtje të llogarisë për kategorizimin e domosdoshëm të invaliditetit të nxënësve me nevoja të posaçme.
- Angazhim i detyrueshëm i defektologëve në shkolla.
- Forcimi i sistemit për mbështetje financiare për nxënësit me nevoja të posaçme (për shembull, përmes Ligjit për standard të nxënësve ose përmes ndonjë ligji tjetër).

### 3.1.4. Marrëveshje

Marrëdhëniet juridike mes nxënësve dhe pjesëmarrësve në trajnimet përkatëse dhe punëdhënësvegjësishtofertuesve janë rregulluar me marrëveshje të posaçme që mund të jenë dypalëshe, por edhe trepalësheatje ku përfshihet edhe shkolla, ose nga ana tjetër, atje ku përfshihet edhe prindi. Marrëveshjen si dokument juridik për rregullimin e marrëdhënieve e takojmë në nenin 16 të LAMP-së<sup>28</sup> si dhe në nenin 15 të LARR-it<sup>29</sup>.

Në përputhje me nenin 16 të LAMP-së, për periudhën e kaluar në trajnim, lidhet marrëveshje për trajnim ndërmjet institucionit për arsim dhe trajnim profesional, punëdhënësit dhe nxënësit, kurse për nxënësin e mitur marrëveshjen e nënshkruan prindi, gjegjësisht kujdestari i nxënësit. Në marrëveshjen rregullohen kushtet për trajnim, punë dhe përkompensimin e punës. Para fillimit të trajnimit praktik, marrëveshja duhet të jetë e nënshkruar dhe e regjistruar në Regjistrin e nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin. Përmbajtja, forma dhe procedura e nënshkrimit të marrëveshjes për trajnim, përcaktohet nga odat.

Në përputhje me nenin 15 të LARR-it, për kohën e ndjekjes së programit për arsimin e të rriturve lidhet marrëveshje mes entit dhe institucionit për arsimin e të rriturve dhe pjesëmarrësit. Në marrëveshjen rregullohen kushtet e ndjekjes të arsimit

<sup>28</sup> Në marrëveshjen rregullohen kushtet e punës. Para fillimit të trajnimit praktik duhet të nënshkruhet dhe shënohet në regjistrin e nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me entin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin. Odat mbajnë regjistër të nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin. Odat çdo tre muaj dorëzojnë raport në Ministri dhe Qendër, lidhur me marrëveshjet e lidhura për trajnim praktik të nxënësve me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të nxënësve që kanë lidhur marrëveshje për trajnim praktik me institucionin për arsim dhe trajnim profesional dhe punëdhënësin, i përcakton ministri. Përmbajtjen, formën dhe procedurën e nënshkrimit të marrëveshjes për trajnim, e përcaktojnë odat.

<sup>29</sup> Për kohën e ndjekjes së programit për arsimin e të rriturve lidhet marrëveshje ndërmjet entit dhe institucionit për arsimin e të rriturve dhe pjesëmarrësit. Në marrëveshjen, rregullohen kushtet e ndjekjes së arsimit për të rritur (vendi i arsimit, kohëzgjatja e arsimit, kompensimi dhe ngjashëm). Marrëveshja duhet të nënshkruhet para fillimit të realizimit të programit për arsimin e të rriturve.

përtë rritur (vendi i arsimimit, kohëzgjatja e arsimimit, kompensimi dhe ngjashëm). Para se të fillojë realizimi i programit për arsimin e të rriturve, marrëveshja duhet të nënshkruhet. Përmbajtjen, formën dhe procedurën e nënshkrimit të marrëveshjes e përcakton Qendra.

Siç është cekur tashmë, dokument kryesore për këtë çështje janë „Standardet për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve të punëdhënësit”, të vitit 2012, i përpiluar nga QAPT-jatë cilat në pikën 6, e rregullojnë marrëveshjen për trajnim praktik. Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për arsim dhe trajnim profesional – Përmbajtja, forma dhe procedura e nënshkrimit të marrëveshjes për trajnim, përcaktohet nga odat. Megjithatë, nga pjesa 6 e Standardeve për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve të punëdhënësit, si dhe Formulari nr.1 me titull “Model i Marrëveshjes për realizimin e trajnimit praktik” mund të konstatohet se ka nevojë për rregullim plotësues të kësaj pjese, veçanërisht për saktësimin plotësues të model - marrëveshjes. Kuptohet se bëhet fjalë për model marrëveshje, që është objekt i harmonizimit, por megjithatë disa gjëra duhet të jenë të saktësuara veçanërisht në pjesë e të drejtave të nxënësit. Veçanërisht duhet të rregullohet qartë dhe në mënyrë koncize çështja e kompensimit, si dhe çështjet për të drejtat në vendin e punës, gjegjësisht vendin ku ushtrohet trajnimi. Gjithashtu duhet të merret parasysh pjesa XXIII me titull „Punë e fëmijëve nën moshën 15 vjeçe, nxënës dhe studentë” të Ligjit për marrëdhënie të punës. Më në fund, në modelin e marrëveshjes, rekomandohet të rregullohen në mënyrë më koncize dispozitat relevante të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

**TABELA 14: MARRËVESHJE**

**Rekomandime**

- Rregullat e detyrueshme duhet të përfshihen në marrëveshjen për rregullimin e marrëdhënieve mes pjesëmarrësve në procesin e arsimit. Në këtë drejtim, të vihet theksi në zgjerimin e përmbajtjeve të detyrueshme.
- Marrëveshja detyrimisht ta përfshijë edhe të drejtën e kompensimit si dhe të drejtat e sigurisë gjatë punës (harmonizim dhe parashikimin e zbatimit të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës), por edhe të drejtat e parashikuara në Ligjin për marrëdhënie pune më konkretisht pjesën XXIII.
- Rekomandohet të përgatiten formularë të standardizuar, që do të përfshijnë përmbajtjen e detyrueshme të marrëveshjeve.
- Përmbajtja e marrëveshjeve dhe përmbushja e marrëveshjeve të gjitha pikëpamjet duhet të jetë objekt i mbikëqyrjes më gjithëpërfshirëse inspektuese.
- Duhet gjetur zgjidhje më adekuate për mbajtjen e regjistrave të marrëveshjeve, për shkak se zgjidhja e tanishme tregon se nuk është efikase dhe e plotë.

### 3.1.5. Punëdhënës

Subjekt i posaçëm – pjesëmarrës në arsimin dhe trajnimin profesional janë punëdhënësit. Të njëjtët kanë rol të rëndësishëm, meqë qëllimi i sistemit është që pjesa kryesore e trajnimit praktik të realizohet në vendin e punës të punëdhënësit, në vend se në kabinetet dhe klasat e shkollës, gjegjësisht arsimit. Në përputhje me nenin 2 të LATP-së, punëdhënës janë shoqëria tregtare, institucioni ose zëjtari, te të cilët realizohet trajnimi praktik sipas kushteve rrjedhëse të aktivitetit të tyre, me ç'rast ky trajnim nuk paraqet veprimtarinë e tyre kryesore.

Në përputhje me LARR-in<sup>30</sup>, punëdhënës janë shoqëria tregtare, enti apo zëjtari të cilin bëhet aftësimi praktik i arsimit të rriturve sipas kushteve vijuese të aktiviteteve të tyre, me ç'rast ky aftësim nuk paraqet veprimtari të tyre kryesore. Në përgjithësi, punëdhënësit janë të obliguar gjatë trajnimit praktik t'i realizojnë qëllimet, gjegjësisht programet mësimore. Kjo do të thotë se trajnimi duhet të jetë kompletar me programin mësimor.

**TABELA 15: PUNËDHËNËS**

**Rekomandime**

- Harmonizim i normativave dhe standardeve për përmbushjen e kushteve për verifikim, ndërsa e gjithë kjo me qëllim që si punëdhënës të autorizuar për organizimin e trajnimit praktik të mundësohet të marrin pjesë edhe një grup i punëdhënësve.
- Zhvillim i formave formale të bashkëpunimit të punëdhënësve edhe me komunat që kanë themelues të shkollave të mesme publike.
- Parashikim i mënyrave dhe modaliteteve konkrete dhe precize të mbështetjes shtetërore.

### 3.1.6. Institucione

Në sistemin për arsim dhe trajnim profesional janë përfshirë një numër i madh i institucioneve kompetente me autorizime të veçanta në këtë proces. Në vazhdim janë paraqitur edhe konstatimet kryesore për secilin prej këtyre institucioneve.

Të njëjtat janë të ndara në institucione kompetente për formulimin e politikave (institucione që i marrin vendimet dhe janë kompetente për realizimin e politikave) dhe institucione profesionale (që i krijojnë politikat dhe janë të përbëra prej ekspertëve dhe profesionistëve të fushës së caktuar).

Menjëherë në fillim të kësaj pjese, duhet të potencohet se në kuadër të intervistave janë përfshirë çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin institucional mes palëve kryesore të interesuara dhe bartësve të vendimeve për realizim të suksesshëm të arsimit profesional. Duke marrë parasysh se ekzistojnë një numër i madh i akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë arsimin e mesëm profesional, është me rëndësi të jashtëzakonshme që të shqyrtohen marrëdhëniet e këtyre institucioneve në praktikë dhe mundësitë për përmirësimin e tyre.

Vërejtje e përgjithshme është dhënë nga thujsetë gjithë bashkëbiseduesit për dinamikën e reformave, ndryshimet që ndodhin shumë shpejtë dhe shpesh pa përgatitje përkatëse të kuadrit mësimdhënës dhe teksteve përkatëse shkollore. Krahas kësaj, është cekur se për profilet e reja mungojnë programet dhe librat shkollorëgjë që e vështirëson dukshëm punën në shkolla si përnxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit.

<sup>30</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

## Institucione kompetente për formulimin e politikave

A) Ministria e Arsimit dhe Shkencës është institucion kryesor dhe bartës, në realizimin e arsimit dhe trajnimit profesional në të gjitha format e tij, gjegjësisht në kuadër të arsimit formal, arsimit joformal dhe arsimit të të rriturve. Baza e kompetencës së saj rezulton edhe nga ligji kryesor sistemor, gjegjësisht Ligji për arsimin e mesëm. Kompetencat e veçanta të MASH-it janë rregulluar edhe në Ligjin për arsimin profesional<sup>31</sup> në nenin 7<sup>32</sup> si dhe në Ligjin për arsimin e të rriturve<sup>33</sup>, më konkretisht në nenin 7<sup>34</sup>.

Në pjesën e bashkëpunimit me organet në nivel shtetëror, në intervistat e realizuara janë përmendur disa sugjerime konkrete. Vërejtjet më të mëdha gjatë bisedave të realizuara janë dhënë për praktikën e Komisionit për regjistrime gjatë përcaktimit të kuotave të regjistrimit për shkollat. Fitohet përshtypje se kuotat për regjistrime nuk përcaktohen përmes kritereve dhe nevojave objektive, e se në gjithë këtë proces ka ndikim të fuqishëm partiak. Si rrjedhojë, është i pranishëm perceptimi se programet e reja shpeshherë hapen vetëm formalisht. Në mënyrë plotësuese, nevojitet transparencë dhe përfshirje më e madhe e të gjithë faktorëve në procesin ligjdhënës si dhe ulje të ndikimit partiak gjatë marrjes së vendimeve duke përfshirë këtu punësimin dhe emërimin e drejtorëve sipas çelësit partiak.

Është propozuar edhe formim i ndonjë lloji të trupit formal ose joformal për komunikim më efikas të të gjithë faktorëve në arsimin e mesëm profesional.

B) Si institucion kompetent për politikën në fushën e tregut të punës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, zë një vend të rëndësishëm në proceset e planifikimit të arsimit dhe trajnimit profesional. Kompetencat e MPPS-sënë përputhje me Ligjin për

<sup>31</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

<sup>32</sup> Si kompetenca të kësaj Ministrie janë parashikuar: t'i propozojë Qeverisë rrjetin e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, të japë mendim për pushimin me punë të institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, në mënyrën e përcaktuar me ligj, të bëjë verifikimin e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, në mënyrën e përcaktuar me ligj, të kryejë akreditimin e institucioneve që do të organizojnë trajnimin e arsimtarëve, të miratojë plan-programe arsimore nacionale në kornizë, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Lidhjen e Odave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Odën e Zëjtarëve të Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: odat) të kryejë kontrollin e punëdhënësve për plotësimin e kushteve për realizimin e trajnimit praktik dhe për marrëveshjet e lidhura ndërmjet institucionit për arsim dhe trajnim profesional, punëdhënësit dhe nxënësit, për realizimin e trajnimit praktik, me propozimin e Qendrës për arsim dhe trajnim profesional (në tekstin e mëtejme: Qendra), miraton plan programin arsimor për trajnimin profesional didaktik të trajnuesve nga punëdhënësit të cilët realizohet trajnimi praktik, me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, miraton koncepte për të gjitha llojet e arsimit dhe trajnimit profesional, me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, miraton programe të provimeve për provim përfundimtar dhe maturë shtetërore, të përgatitura në pajtim me standardet për realizimin e provimeve në fund të çdo lloji të arsimit dhe trajnimit profesional, me propozim të Qendrës, miraton standarde për arritjet e nxënësve në arsimin dhe trajnimin profesional, me propozim të Qendrës, e me mendim pozitiv të marrë paraprakisht nga Këshilli për Arsim dhe Trajnimin Profesional, miraton standarde për profile arsimore dhe standarde për degë profesioni dhe të kryejë punë të tjera në përputhje me ligjin.

<sup>33</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>34</sup> MASH-i është kompetent: të miratojë strategji për arsimin e të rriturve dhe plane vjetor veprimi për realizimin e tij, në bazë të propozimeve nga Këshilli për arsimin e të rriturve, t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë rrjetin e enteve për arsimin e të rriturve, t'i japë mendim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndërprerjen e punës së enteve për arsimin e të rriturve, në mënyrë të përcaktuar me ligj, të bëjë verifikimin e enteve dhe të institucioneve për arsimin e të rriturve, në mënyrë të përcaktuar me ligj, të mbajë regjistër të enteve dhe institucioneve të verifikuara për arsimin e të rriturve, të miratojë plane dhe programe kornizë nacionale arsimore për arsimin e të rriturve; të miratojë plan dhe program mësimor për arsimin fillor, për arsimin e gjimnazit dhe atë profesional të të rriturve, sipas propozimit të Qendrës për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtejme: Qendra), të sigurojë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për financimin e arsimit të të rriturve në bazë të nevojave të përcaktuara të shtetit, të sigurojë mjete për kërkime dhe zhvillim për nevojat e arsimit për të rritur, në përputhje me nevojat e shtetit dhe të Bashkimit Evropian; dhe të ushtrojë punë të tjera në përputhje me ligjin.

arsim dhe trajnim profesional<sup>35</sup> janë rregulluar në nenin 8 të këtij Ligji<sup>36</sup>. Gjithashtu, kompetenca të posaçme janë parashikuar për MPPS-në edhe në përputhje me nenin 8 të Ligjit për arsimin e të rriturve<sup>37</sup>.

C) Në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional, nënenin 10 janë parashikuar edhe kompetenca të rëndësishme të Këshillit të Komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit: kryen analizën e nevojave të tregut të punës në nivel lokal dhe i paraqet shqyrtimet për nevojat, në Qendër dhe në institucionet për arsim dhe trajnim profesional, paraqet propozime në Ministri dhe në Qendër, për nevojat e zhvillimit të plan-programeve mësimore dhe dorëzon propozime në Ministri, për politikën regjistruese në arsimin dhe trajnimin profesional.

Në pjesën e bashkëpunimit të shkollave komunitat, nga intervistat e realizuara imponohet përshtypja se ekziston *hapësirë e madhe për përmirësim*. Ndonëse ekziston bashkëpunimi, fitohet përshtypje se *lëshohen mundësitë që i kanë në dispozicion veçanërisht në ruajtjen e kontaktit me kompanitë, planet e tyre dhe krijimin e parakushteve logjistike për bashkëpunim më të mirë të kompanive shkollat*. Moment pozitiv është fakti që në disa raste komuna mbulon shpenzimet për sigurimin e nxënësve në trajnimin praktik. Gjithashtu, është apotrofuar se imponohet nevoja që *më mirë të përpilohet koncepti i miratimit të programeve vjetore të shkollave nga ana e komunave*.

### Institucione profesionale në sistemin për arsim dhe trajnim profesional

A) Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional është institucion qendror profesional dhe operativ në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional. Në përputhje me nenin 30 të LATP-së, Qendra funksionon si ent publik, i themeluar nga Qeveria e RMV-së, në rolin e personit juridik dhe me seli në Shkup. Në përputhje me nenin 31, Qendra i ka rolet vijuese: në këtë organ harmonizohen dhe integrohen interesat publike dhe interesat e partnerëve socialë në arsimin dhe trajnimin profesional në vend, ndërsa Qendra e koordinon bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional. Në nenin 32 të LATP-së, janë rregulluar kompetencat e QATP-së.

<sup>35</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

<sup>36</sup> MPPS-ja është kompetente për: të marrë pjesë në realizimin e politikës shtetërore në sferën e arsimit dhe trajnimit profesional, në përputhje me këtë ligj, t'i shqyrtojë nevojat për kuadrin e arsimit dhe trajnimit profesional, përmes analizave të tregut të punës dhe të paraqesë mendimin për politikën regjistruese, në Këshill, të marrë pjesë në përgatitjen dhe harmonizimin e kualifikimeve profesionale sipas standardeve, në bashkëpunim me Qendrën, të iniciojë nevojat për përgatitjen e kualifikimeve të reja profesionale sipas standardeve, me propozim të Ministrisë, e me mendim pozitiv paraparak të Këshillit, miraton standarde të profesioneve të përgatitura nga Qendra, të marrë pjesë në organizimin e orientimit profesional të nxënësve, të kryejë mbi këqyrjen e dispozitave për kushtet e mbrojtjes gjatë realizimit të trajnimit praktik, e përcakton Listën e standardeve të profesioneve për arsim dhe trajnim profesional dhe e shpall në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

<sup>37</sup> MPPS-ja merr pjesë në zbatimin e politikës shtetërore në fushën e arsimit për të rritur, nëpërputhje me këtë ligj, shqyrton nevojat për rikualifikim dhe kualifikim plotësues të kuadrin përmes analizës së tregut të punës dhe paraqet mendim deri te Këshilli, merr pjesë në përgatitjen dhe harmonizimin e kualifikimeve profesionale sipas standardeve, në bashkëpunimin me Qendrën inicion nevojë për hartimin e kualifikimeve të reja profesionale sipas standardeve, merr pjesë në hartimin e Listës së standardeve të profesioneve dhe merr pjesë në organizimin e orientimit profesional të pjesëmarrësve. („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018)

Siç mund të shihet, krahas kompetencave që do të thonë koordinim, organizim, mbështetje dhe harmonizim të konceptit të arsimit dhe trajnimit profesional, me rëndësi të veçantë për këtë analizë janë kompetencat e QATP-së që kanë të bëjnë me (1) përgatitjen e koncepteve për të gjitha llojet e arsimit dhe trajnimit profesional, (2) përpilimin e standarde të profesioneve, si bazë për përpunimin e programeve dhe planeve mësimore, (3) propozimin dhe zhvillimin e planeve mësimore për të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional dhe të njëjtat i dorëzon për mendim në Byronë për Zhvillimin e Arsimit, (4) përpilimin e modelit të programeve mësimore për lëndët profesionale për arsim dhe trajnim profesional, (5) zhvillimin e programit për përmirësimin e cilësisë së mësimit për lëndët profesionale në shkollë, në bazë të raportit nga vlerësimi i realizuar integral, nga ana e ISHA-së, (6) dhënien e mendimit për plotësimin e kushteve të institucioneve të cilat kërkojnë verifikim për realizimin e arsimit dhe trajnimit profesional, përpunimin e standardeve për hapësirë dhe pajisje të shkollave, etj. Qendrën e administron Këshilli drejtues. Në përputhje me nenin 34 të LATP-së, Këshilli drejtues është i përbërë nga nëntë anëtarë edhe atë nga një anëtar nga MASH-i, ministria kompetente e punës, Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale, nga një anëtar nga odat dhe katër anëtarë nga radhët e punëtorëve profesional të punësuar në Qendër.

B) Në përputhje me Ligjin për Byronë për Zhvillimin e Arsimit<sup>38</sup>, Byroja kryen punë profesionale me rëndësi për zhvillimin dhe avancimin e edukimit dhe arsimit në RM. Byroja në esencë në përputhje me nenin 5 është kompetente për sistemin e përgjithshëm arsimor të arsimit parashkollor, fillor, të gjimnazit, arsimit të arteve. Në pjesën që është në interesin tonë, duhet të ceket se ky institucion është kompetent për lëndët e arsimit të përgjithshëm në arsimin e mesëm profesional, në arsimin e specializuar dhe në arsimin e të rriturve. E njëjta do të thotë duhet të ketë koordinim të veçantë me tri institucioneve më të rëndësishme kompetente profesionale edhe atë Byronë, Qendrën për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Qendrën për Arsimin e të Rriturve.

Veçanërisht duhet të merret parasysh dispozita e nenit 6 të këtij Ligji, sipas të cilit Byroja, i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës plane edhe për arsimin e mesëm dhe të specializuar, propozon plane mësimore për lëndë të përgjithshme arsimore në arsimin e mesëm profesional, në arsimin e specializuar, si dhe në arsimin e të rriturve, etj. Në përputhje me nenin 7, Byroja, me tjerash planifikon, në bazë afatgjate rishqyrtimin e plan-programeve ekzistuese mësimore, bën rishqyrtimin periodik të harmonizimit të programeve mësimore dhe qëllimeve të arsimit, në përputhje me dokumentet strategjike dhe ligjet, gjegjësisht përgatit plane vjetore për nevojat e ndryshimit dhe plotësimit të programeve ekzistuese mësimore, përkatësisht për përpilimin e programeve të reja mësimore.

<sup>38</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 37/2006; 142/2008; 148/2009; 69/2013; 120/2013; 148/2013; 41/2014; 30/2016 dhe 64/2018

C) Qendra për Arsimin e të Rriturve është institucion qendror operativ dhe koordinues në procesin e arsimit të të rriturve. Në përputhje me LARR-in<sup>39</sup>, siç është përcaktuar në nenin 34, Qendra për arsimimin e të rriturve është ent publik për arsimin e të rriturve në RMV, si person i veçantë juridik, i themeluar nga Qeveria. Në Qendrën harmonizohen dhe integrohen interesat publik dhe interesat e partnerëvesocialë në arsimin për të rritur në vend. Qendra e koordinon bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare nëfushën e arsimit për të rritur dhe në mësimin e përgjeshëm. Kompetencat e posaçme të Qendrës për Arsimin e të Rriturve janë rregulluar në nenin 36 të Ligjit për arsimin e të rriturve<sup>40</sup>. Qendrën e menaxhon Këshilli drejtues. Në përputhje me nenin 38, Këshilli drejtues përbëhet prej 11 anëtarëve edhe atë dy anëtarë nga Ministria, nga një anëtar nga ministria kompetente e Punës dhe nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, Oda Ekonomike e Maqedonisë dhe Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë dhe Oda e Zejtareve të Maqedonisë dhe katër anëtarë nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional të punësuar në Qendrën.

Ç) Në përputhje me LAMP<sup>41</sup> në nenin 9 parashikohet se Qeveria e RM-së me vendim themelon Këshillin për arsim dhe trajnim profesional si trup këshillëdhënës që propozon çështje strategjike që kanë të bëjnë me politikën e zhvillimit të arsimit dhe trajnimit profesional. Këshilli përbëhet prej 11 anëtarëve, prej të cilëve tre anëtarë nga Ministria, prej të cilëve një anëtar është nga BZHA-ja, nga një anëtar nga odat, nga një anëtar nga Ministria kompetente e Punës, Ministria kompetente e Ekonomisë, Ministria kompetente e Financave, sindikata shumicë, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, (APRM). Në punën e Këshillit merr pjesë edhe drejtori i Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional, pa të drejtë vote gjatë vendimmarrjes. Kompetencat e Qendrës janë: jep mendim për strategjinë e zhvillimit të arsimit dhe trajnimit profesional, i propozon Ministrisë ndryshime e plotësime të Listës së standardeve të profesioneve për arsimin dhe trajnimin profesional, i propozon Ministrisë kualifikime dhe standarde kombëtare të profesioneve, në bashkëpunim me komunat, dorëzon në Ministri propozim për zhvillimin e rrjetit të institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, jep mendim për standardet e profesionit në Ministri, jep mendim për standardet për profilet arsimore dhe standardet për profesionet në Ministri. Në intervistat është theksuar se në raport me *Këshillin për arsim dhe trajnim profesional dominues është*

<sup>39</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>40</sup> Në përputhje me nenin 36 të Ligjit për arsimin e të rriturve, Qendra i kryen punët si vijojnë: zhvillon arsimin e të rriturve me qëllim të harmonizimit të nevojave të zhvillimit bashkëkohor teknologjik dhe shoqëror, i jep përkrahje partneritetit social në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe realizimit të arsimit për të rritur, ndërlikohet arsimin e të rriturve dhe punën në kontekstin e mësimin të përgjeshëm, zhvillon orientim evropian të arsimit për të rritur, përgatit koncept për arsimin e të rriturve, harton standarde të profesioneve për programet e arsimit për të rritur, harton modele për programe publikisht të pranuar dhe të posaçme për arsimin e të rriturve, kryen verifikim të programeve të posaçme për arsimin e të rriturve, boton katalog për programet publikisht të pranuar dhe të verifikuara të posaçme për arsimin e të rriturve dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit të Qendrës, siguron përkrahje të arsimit për të rritur përmes këshillimeve, instruktiveve dhe mentorimit të kuadrit i cili i realizon programet e arsimit për të rritur, jep mendim për përbushjen e kushteve të enteve dhe institucioneve të cilat kërkojnë verifikim për realizimin e programeve publikisht të njohura për arsimin e të rriturve, harton standarde për hapësirën dhe pajisjen e enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve, boton katalog të enteve dhe institucioneve të verifikuara për arsimin e të rriturve dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit të Qendrës dhe Ministrisë, ndërmjetëson në zhvillimin e karrierës dhe në orientimin profesional të pjesëmarrësve në arsimin për të rritur, propozon zgjidhje për përmirësimin e lidhjeve ndërmjet arsimit formal dhe joformal, pranë Ministrisë dhe Këshillit paraqet raport vjetor për realizimin e planeve vjetore të veprimit të strategjisë për zhvillimin e arsimit për të rritur dhe në Ministri paraqet raport vjetor për konkurset e shpallura publikisht për akordimin e mjeteve për realizimin e programeve për arsimin e të rriturve.

<sup>41</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

*rol i përfaqësuesve të organeve shtetërore, për dallim nga bashkësia afariste e cila ka vetëm 1 përfaqësues prej gjithsej 11 anëtarëve. Në kuadër të intervistave të realizuara, është bërë e ditur edhe për ndikimin partiak gjatë përcaktimit të anëtarëve, po edhe të vetë funksionimit të këshillit.*

D) Ligji për arsimin e të rriturve<sup>42</sup> në nenin 9, parashikon formim të Këshillit për arsimin e të rriturve. Qeveria e RMV-së me vendim themelon Këshill për arsimin e të rriturve, si trup këshillëdhënës i cili propozon çështje strategjike që kanë të bëjnë me politikën zhvillimore të arsimit për të rritur. Këshilli përbëhet prej kryetarit dhe 12 anëtarëve, edhe atë: dy anëtarë nga radhët e ekspertëve të arsimit për të rritur, nga një anëtar nga Ministria, nga BZHA-ja, nga QATP-ja, nga Ministria kompetente e Financave, nga sindikata shumicë, nga BNJVL-ja, APRM-ja dhe nga Agjencia e Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, si dhe nga një anëtar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë, nga Lidhja e Odave të Maqedonisë dhe Dhoma e Zejtarëve të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: odat).

Në përputhje me nenin 10, si kompetenca të Këshillit parashikohen: të propozojë strategji për zhvillimin e arsimit të të rriturve në kontekst të mësimin të përgjithshëm, propozon plane vjetore veprimi për implementimin e Strategjisë për arsimin e të rriturve, ndjekje të realizimit të planeve vjetore të veprimit për realizimin e strategjisë së zhvillimit të arsimit të të rriturve, i dorëzon Ministrisë propozime për kualifikime dhe standarde kombëtare për profesione, propozon financim të programeve për arsimin e të rriturve për të cilat janë siguruar mjete në Buxhetin e RMV-së dhe në bashkëpunim me komunat dorëzon në Ministri propozim për zhvillimin e rrjetit të enteve për zhvillimin e arsimit të të rriturve.

DH) Institucion i veçantë i rregulluar në përputhje me Ligjin për shërbim pedagogjik<sup>43</sup> është shërbimi me po të njëjtin emër. Në këtë drejtim Shërbimi pedagogjik vepron në një spektër të gjerë të aktiviteteve të definuara në Ligjin, gjegjësisht konkretisht në nenin 4, i cili parashikon veprime lidhur me mendime të ekspertëve, aktivitete këshillëdhënëse dhe ngjashëm, të cilat janë të orientuara drejt procesit edukativo-arsimor, e veçanërisht aspektet pedagogjike të procesit arsimor.

E) Ligji për inspektim arsimor (LIA)<sup>44</sup>, parashikon rol të veçantë të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit si dhe të inspektorëve të autorizuar të komunave dhe Qytetit të Shkupit, të cilët përmes autorizimeve të tyre mbikëqyrëse e ndjekin dhe kontrollojnë implementimin e rregullave në pjesën e arsimit dhe trajnimit profesional. Në përputhje me nenin 4 të LIA-së, Inspektorati Shtetëror i Arsimit bashkëpunon në mënyrë të drejtpërdrejtë me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, me organet e komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit, këshillave të shkollës, këshillat e prindërve, si dhe me organe dhe institucione tjera kompetente. Në përputhje me nenin 6 të LIA-së, Mbikëqyrjen inspektuese, në kuadër të kompetencës së Inspektoratit Shtetëror të

<sup>42</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>43</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 18/2011, 41/2014, 55/2016 dhe 64/2018

<sup>44</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 64/2018

Arsimit e bëjnë Inspektorët shtetërorë të arsimit. Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka cilësi të personit juridik, ndërsa drejtorin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ë) Qendra Shtetërore e Provimeve, në përputhje me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve<sup>45</sup> është kompetente për një varg aktivitete prej të cilave kyçe janë ato që janë të orientuara drejt organizimit, zbatimit dhe mbështetjes së vlerësimit dhe kontrollit të jashtëm të arritjeve të nxënësve. Roli i veçantë është parashikuar edhe në pjesën e aftësimittë kandidatëve për drejtorë, si dhe dhënien e provimit për drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme. Kjo është me rëndësi, me qëllim të forcimit të kapaciteteve të trupave për menaxhimin e shkollave të mesme profesionale dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të shkathtësive organizative të drejtorëve. Në pjesën e realizimit të vlerësimit, në përputhje me nenin 3, Qendra Shtetërore e Provimeve, përgatit teste për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm, me propozim të BZHA-së dhe QATP-së, përgatit orar të përgjithshëm për kontroll të arritjeve të nxënësve për lëndët në arsimin fillor dhe të mesëm, me propozim të BZHA-së dhe QATP-së, më së voni deri më 15 dhjetor në vitin rrjedhës shkollor, merr pjesë në përgatitjen e konceptit për maturë dhe provim përfundimtar në arsimin e mesëm, përgatit teste për provime eksterne në maturën shtetërore, etj.

Te një pjesë e intervistave të realizuara në kuadër të hulumtimit, në pjesën e vlerësimit, është theksuar se *një pjesë e provimeve për programe të ndryshme në arsimin e gjimnazit dhe atë profesional është e njëjtë, me çka vihen në pozitë të pabarabartë këto dy kategori të nxënësve. Pësha e detyrave nuk përputhet me programet. Nevojitet koncept më ndryshe i provimit përfundimtar në arsimin e mesëm profesional me fokus më të madh në trajnimin praktik dhe përfshirjen e punëdhënësve në provimin përfundimtar. Në këtë drejtim, imponohet nevoja për vlerësimin e nevojës dhe konceptit të Maturës profesionale, si dhe të zbatohet përvoja nga matura e vjetër.*

F) Në proceset e arsimit dhe trajnimit profesional, si në kuadër të arsimit formal ashtu edhe në kuadër të atij joformal, janë përfshirë edhe përfaqësues të bashkësisë afariste përmes formave të tyre të organizimit gjegjësisht përmes odave (odat ekonomike dhe odat e zejtarisë). Çështjet që kanë të bëjnë me rolin e tyre në këtë proces janë përfshirë në Ligjin për arsim dhe trajnim profesional, Ligjin për arsimin e të rriturve, Ligjin për zeytari dhe Ligjin për odat. Në përputhje me LATP-në<sup>46</sup> në nenin 11 parashikohet se odat kryejnë punët vijuese: dorëzojnë propozime në Qendrën për miratimin e planeve dhe programeve të reja mësimore dhe për përtëritjen e planeve dhe programeve ekzistuese mësimore; dorëzojnë propozime në Qendrën për përpilimin e standardeve të reja të profesioneve, marrin pjesë në komisionet e provimeve përfundimtare të arsimit dhe trajnimit profesional, mbajnë Regjistër të marrëveshjeve të lidhura mes institucioneve të arsimit dhe trajnimit profesional me punëdhënësit, për trajnim praktik të nxënësve dhe në Ministrinë dorëzojnë raport vjetor për punëdhënësit e verifikuar për realizimin e trajnimit praktik. Më tutje, në

<sup>45</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.142/2008; 148/2009; 41/2014; 55/2016; 142/2016 dhe 64/2018

<sup>46</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018.

përputhje me LARR-in<sup>47</sup> në nenin 12 parashikohet seodat i ushtrojnë punët vijuese: dorëzojnë propozime në Qendrën për miratimin e programeve të reja dhe për rinovimin e programeve ekzistuese, dorëzojnë propozime në Qendrën për hartimin e standardeve të reja të profesioneve, mund të themelojnë institucione për arsimin e të rriturve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe miratojnë programe të cilat financohen me mjetet e odave dhe i dorëzojnë për verifikim te Qendra.

Odat, si persona të veçantë juridik janë të rregulluara me Ligjin për oda ekonomike.<sup>48</sup> Në përputhje me nenin 3 të këtij ligji, Oda është organizatë e pavarur dhe e mëvetëshme në rolin e personit juridik. Në përputhje me nenin 4, parashikohet që në odën të jenë anëtarë persona fizik – tregtarë individual (TI) dhe persona juridik, të regjistruar në regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave të tjerë juridik me seli në RMV të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare. Nuk duhet harruar se në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pranuar koncepti i vullnetarisë, gjegjësishtvetë subjekti vendosë nëse do t'i bashkëngjitet ndonjë ode ose nuk do t'i bashkëngjitet. Në përputhje me nenin 28 të Ligjit për oda ekonomike, odës mund t'i delegohet kryerja e autorizimeve publike. Me fjalë të tjera, oda mund të ushtrojë autorizime publike të përcaktuara me Ligjin dhe në mënyrën e përcaktuar me statutin. Mbikëqyrjen e kryerjes së autorizimeve publike e bën ministria kompetente për fushën përkatëse. Për ushtrimin e autorizimeve publike, oda dorëzon raport vjetor në ministrinë kompetente për fushën përkatëse. Roli i Odës së zejtarëve në këtë proces është theksuar edhe në Ligjin për zejtarin<sup>49</sup>. Ligji për zejtarin është miratuar në vitin 2015, që do të thotë se ky ligj zbatohet thajse tre vite. Në këtë fazë të zbatimit, konstatohet se një numër i caktuar i akteve nënligjore që duhet të miratohen në bazë të këtij ligji, ende nuk janë miratuar.

G) Në përputhje me LAMP-në, sindikatat janë të përfshira në këtë proces me dispozitën e nenit 12, sipas të cilës, Sindikata shumicë dorëzon propozime për përmirësimin e kushteve të trajnimit praktik të nxënësve të punëdhënësit. Gjithashtu, sindikatat kanë rol të caktuar edhe në procesin e arsimit të të rriturve, ku sipas LA<sup>50</sup>, në nenin 13, janë parashikuar rolet vijuese të Sindikatës shumicë: dorëzon propozime për përmirësimin e kushteve për trajnimin praktik të pjesëmarrësve të punëdhënësit, mund të themelojë institucione për arsimin e të rriturve në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe miraton programe që financohen nga mjetet e Sindikatës dhe i dorëzon për verifikim te Qendra.

Një numër i madh i dispozitave të parashikuara në ligjet që kanë të bëjnë me arsimin e mesëm profesional nuk zbatohen në praktikë. Për shembull, nuk zbatohet dispozita që odat të mbajnë Regjistër për verifikimin e punëdhënësve për trajnim praktik (në përputhje me nenin 13 të Ligjit për arsim dhe trajnim profesional). Paralelisht me këtë, nuk zbatohet obligimi i parashikuar në nenin 12 të Ligjit për arsim të mesëm profesional, Sindikata shumicë të dorëzojë propozime për përmirësimin e kushteve

<sup>47</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

<sup>48</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 92/2011”

<sup>49</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 215/2015”

<sup>50</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

të trajnimit praktik të nxënësve të punëdhënësit. Sa i përket të drejtave të parashikuara për punëdhënësit (neni 15 i Ligjit për arsim dhe trajnim profesional) në raport me financat, lehtësimet doganore dhe tatimore, të njëjtat nuk zbatohen.

Nga intervistat e zbatuara në këtë pjesë, u imponua konstatimi se komunat kanë potencial të madh në përmirësimin e bashkëpunimit të shkollave profesionale me kompanitë. Lidhur me këtë, parimisht ekziston gatishmëri për iniciativë të re nga shkollat, ka kontakte me prindër, por mungon forma e organizuar.

Në përgjithësi komunat nuk mbajnë baza të të dhënave për kompaniqë realizojnë mësim praktik me arsimin e mesëm profesional. Në Strumicë mbahen baza të të dhënave që kanë të bëjnë me arsimin e të rriturve. Përfundimisht, në Qendrën për arsim të mesëm profesional është punësuar një person që është përgjegjës për bashkëpunimin me bashkësinë afariste dhe mbajtjen e evidencës.

**TABELA 16: INSTITUCIONE**

Rekomandime
<b>A) Institucione kompetente për formulimin e politikave</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtim i mundësive për rishpërndarjen e kompetencave të një pjese të institucioneve shtetërore në favor të komunave, veçanërisht në pjesën e operacionalizimit të politikave.</li> <li>• Pjesëmarrje më të madhe të komunave dhe shkollave në vendimmarrjen për politikën e regjistrimit dhe konkurset për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme profesionale. <ul style="list-style-type: none"> <li>Në vend të modelit ekzistues ku kompetencat për krijimin dhe zbatimin e politikave në nivel shtetëror mes institucioneve qendrore shtetërore janë të disperzuara, nevojitet përqendrimi i tyre edhe atë në dy nivele: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Së pari, kompetencat nga rregullat e ndryshme ligjore të jenë të harmonizuara dhe sinkronizuara.</li> <li>2. Së dyti, kompetencat në nivel qendror të jenë të përqendruara në pjesën më të madhe në një ministri.</li> </ol> </li> </ul> </li> </ul>
<b>B) Institucione profesionale në sistemin e arsimit dhe trajnimit profesional</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përqendrim i kompetencave në pjesën e arsimit dhe trajnimit profesional në një institucion, gjegjësisht Qendrën për arsim dhe trajnim profesional.</li> <li>• Përkufizim më i saktë i kompetencave mes Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.</li> <li>• Përforsim i rolit të Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional në Ligjin për arsim të mesëm dhe Ligjin për libra shkollorë.</li> <li>• Shqyrtim i mundësive për koordinim dhe integrim më të madh të aktiviteteve të Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Qendrës për Arsimin e të Rriturve.</li> <li>• Në pjesën e trupave të ndryshëm këshillëdhënës (Këshilli për Arsim dhe Trajnim Profesional, Këshilli për Arsimin e të Rriturve dhe ngjashëm), nevojitet racionalizimi dhe përqendrimi i tyre në një trup të vetëm në nivel kombëtar. Ky trup mund të ketë edhe autorizime mbikëqyrëse mbi proceset e implementimit të politikave.</li> <li>• Rritje të koordinimit mes organeve të ndryshme kompetente inspektuese (para së gjithash inspektim të arsimit, inspektim komunal të arsimit dhe inspektim të punës).</li> <li>• Përfshirje të Agjencisë për Punësim në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional (fillimisht, mundet edhe përmes delegimit të detyrueshëm të përfaqësuesve të tyre në organet e ndryshme të menaxhimit të këtyre institucioneve dhe këshillave).</li> <li>• Rritje të lidhjeve mes komunave dhe bashkësinë lokale afariste.</li> </ul>

### 3.1.7. Kuadër mësimdhënës në arsimin e mesëm profesional

Në pjesën e zhvillimit profesional të kuadrit në shkollat e mesme profesionale duhet të merren parasysh dispozitat e Ligjit për arsim të mesëm, si dhe dispozitat e Ligjit për Byronë për Zhvillimin e Arsimit.

Në përputhje me nenin 68 të Ligjit për arsim të mesëm, drejtori, arsimtari dhe bashkëpunëtori profesional në shkollën e mesme gjatë punës së tyre janë të obliguar të përsosen.

Përsosja profesionale realizohet përmes programeve të akredituara për trajnim për përsosje profesionale që i realizojnë entet publike dhe private, shoqatat e qytetarëve dhe shoqëritë tregtare programet e të cilave janë të akredituara. Ministri në bashkëpunim me BZHA-në, QATP-në dhe QSHP-në miraton program vjetor për përsosje dhe avancim profesional të mësimit dhe bashkëpunëtorëve profesional. Në përputhje me LAM-in, nënenin 69 parashikohet se mësimit dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin e mesëm përsosen, aftësohen dhe avancohen në tituj. Për këtë dedikim parashikohet procedurë e veçantë. Mënyra dhe kushtet e akreditimit të përsosjes profesionale janë rregulluar me LAM-in, ndërsa kjo kompetencë është deleguar në Byronë për Zhvillimin e Arsimit.

Në Ligjin për arsim të mesëm, në nenin 59, janë parashikuar dispozita të veçanta për personin që ka përvetësuar arsim të lartë të grupit jomësimdhënës të studimeve të mësimit dhe bashkëpunëtorëve, gjegjësisht të studimeve që nuk kanë drejtim mësimit dhe bashkëpunëtorëve, mund të punësohet në shkollë të mesme, vetëm nëse përvetëson përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike të enteve të akredituara të arsimit të lartë. Kjo dispozitë është e rëndësishme, meqë e njëjta është e pranishme mjaftueshëm në arsimin e mesëm profesional, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për një varg lëndësh mësimit dhe bashkëpunëtorëve e të cilave kanë mbaruar arsim të lartë arsimor të grupit jomësimdhënës të lëndëve. Kjo përgatitje bëhet nga entet e akredituara të arsimit të lartë, të cilat për këtë qëllim janë akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në nenin 59, paragrafi (15), të Ligjit për arsim të mesëm bëhet e ditur se, me përjashtim, në arsimin e mesëm profesional, për mësim praktik mësimit dhe bashkëpunëtorëve mund të jenë edhe personat të cilët kanë përfunduar arsim të mesëm të specializuar ose të lartë janë pajisur me përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike në fakultete përkatëse dhe kanë dhënë provim profesional.

Në kuadër të intervistave të realizuara, janë identifikuar edhe një varg sfidash që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të kuadrit mësimit dhe bashkëpunëtorëve.

Në këtë drejtim, programet për përsosje profesionale dhe avancim të mësimit dhe bashkëpunëtorëve profesional nuk realizohen ashtu siç është parashikuar. Ndonëse ka dëgjues të interesuar, të njëjtit i financojnë me mjete personale, ndërsa certifikatën e përdorin për realizimin e të drejtave të marrëdhënies së punës.

Sa i përket planeve dhe programeve mësimore për trajnim profesional – didaktik të trajnuesve nga mësimit dhe bashkëpunëtorët të cilët realizohet trajnimi praktik, duhet të theksohet se është organizuar një trajnim para 3-4 viteve të cilin janë përfshirë rreth 500 persona.

Është propozuar ideja për nevojën e *realizimit të trajnimit për drejtorë për zhvillimin e shkathtësive për përpilimin dhe sigurimin e mësimit praktik, si dhe zhvillim të programeve për përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive të këshilltarëve për mësimit praktik në shkolla.*

Sipas intervistave, moment plotësues në zhvillimin e kuadrit mësimdhënës është ajo që *angazhimi i ekspertëve të praktikës në mësimit hasë në vërejtje nga organi kompetent inspektues.*

**TABELA 17: KUADËR MËSIMOR NË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE**

Rekomandime
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përmirësohen politikat shtetërore për sigurim dhe arsim të kuadrit mësimdhënës për lëndë profesionale.</li> <li>• Të mundësohen bursa për arsim, qëndrim studentor ose zhvillim profesional të kuadrit të angazhuar të lëndëve profesionale.</li> <li>• Të ndërmerren masa të veçanta për përmirësimin e kapaciteteve të mësimdhënësve përgjegjës për lëndët profesionale përmes pjesëmarrjes së tyre në trajnime që kanë qenë në vëllim të rritur.</li> <li>• T'u mundësohet ekspertëve nga praktika të marrin pjesë në mësimit sipas lëndëve profesionale (si viziting profesorë ose ngjashëm).</li> </ul>

### 3.1.8. Plane dhe programe mësimore

Në përputhje me Ligjin për arsim të mesëm, në nenin 2 parashikohet se në arsimin e mesëm realizohen plane dhe programe për arsim të gjimnazit dhe për arsim profesional. Në nenin 21 të LAM-it parashikohet që me planet mësimore dhe programet mësimore rregullohen qëllimet, fushat mësimore, temat dhe përmbajtjet, standardet arsimore dhe profili imësimdhënës që e realizon mësimit. Në përputhje me nenin 21, paragrafi (2), programet përpilohen sipas modelit të programit që e miraton ministri me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional. Në përputhje me nenin 22, paragrafi (1) i Ligjit të njëjtë, planet dhe programet për shkollat publike i propozon Byroja për Zhvillimin e Arsimit, ndërsa i miraton ministri. Gjithashtu, plane dhe programe mund të propozojnë komunitat, gjegjësisht Qyteti i Shkupit, shkollat, ndërmarrjet, entet dhe persona të tjerë juridik për plotësimin e nevojave të tyre të veçanta (rikualifikime, kualifikime plotësuese dhe ngjashëm). Gjithsesi, këtu parashtrohet pyetja se në çfarë mënyre duhet të inkorporohet Qendra për arsim dhe trajnim profesional në nenin 22, paragrafi (1) i Ligjit për arsim të mesëm.

Në kuadër të intervistave të realizuara në pjesën e procedurave për dhënien e pëlqimit për test të programeve mësimore, një pjesë e bashkëbiseduesve bënë të ditur se *zvarriten procedurat për dhënie të pëlqimit për test të programeve mësimore nga institucionet, ndërsa gjithashtu është potencuar se Byroja jep pëlqim për test për më shumë se 2000 programe mësimore në arsimin profesional edhe atë në të shumtën e rasteve pa vërejtje më të mëdha dhe/ose konstruktive. Procedura për dhënien e pëlqimit për test ka numër më të madh të hapave administrative që janë të panevojshme (për shembull,*

vërtetim të të gjitha dokumenteve me vulë etj). Më shumë bashkëbisedues bënë të ditur se është e pranishme përputhja e kompetencave të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrës për Arsim të Mesëm Profesional, gjë që shkakton edhe tension të pjesshëm në raportet e tyre.

Objekt i interesit të veçantë ishte edhe procedura për propozimin e vendosjes së profileve të reja në shkollat, si dhe për atë se cilët faktorë kanë ndikim më të madh në këtë proces. Në Qytetin e Shkupit iniciativë për profile të reja në të shumtën e rasteve japin vetë shkollat dhe janë përmendur shembujt vijues të shkollës së mesme „8 Shtatori“ (argjendari) dhe PTT (makinist). Në funksion të rritjes së atraktivitetit, profile të caktuara ndryshohen me qëllim që të jenë më atraktive në tregun e punës (për shembull, agrobiznes dhe menaxhment). Në disa mjedise të caktuara, një pjesë e profileve janë të orientuara drejt migrimit jashtë vendit (fizioterapeut ose infermier). Iniciativat e prindërve janë të barazuara me minimumin me përjashtim të Komunës së Strumicës.

Është sugjeruar se nevojitet të lehtësohet kalimi i nxënësve nga njëri profil arsimor në tjetrinnë kuadër të shkollës kur janë në vitet e para të mësimit – transferin të mund ta bëjnë në mënyrë më të thjeshtë.

Një pjesë e shkollave mendojnë për zhvillimin e profileve të reja për të cilat ka nevojë reale në treg (për shembull, instalues për instalime të gazsjellësit, teknik hotelier-turistik për turizëm rural, animatore etj). Sipas të dhënave të Qendrës për Arsim të Mesëm Profesional, prej vitit shkollor 2015/16 deri në momentin e përpilimit të këtij raporti (tetor të vitit 2018) nuk është propozuar hapja e profileve të reja të profesioneve.

Në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional, në nenin 18, parashikohet se arsimi dhe trajnimi profesional realizohet përmes planeve dhe programeve mësimore për:

- Aftësim profesional i dedikuar për punën me kërkesat më të ulëta që ofron njohuri dhe shkathtësi praktike për fusha të ndryshme të punës, me ç'rast nxënësit që kanë mbaruar aftësim profesional japin provimin për aftësim profesional (neni 19).
- Arsimi profesional për profesion është i dedikuar për plotësimin e nevojave të ekonomisë, me ç'rast nxënësit të cilët kanë mbaruar arsimin profesional për profesion japin provimin përfundimtar (neni 19) dhe marrin vërtetim për aftësim profesional (neni 21).
- Arsimi teknik është arsim që kryesisht përgatitë kuadro për punësim në të gjitha fushat e punës, por edhe për vazhdimin e arsimit, me ç'rast nxënësit të cilët kanë mbaruar arsim teknik japin provimin e maturës shtetërore, gjegjësisht provim përfundimtar (neni 19) dhe marrin diplomë për maturë shtetërore gjegjësisht diplomë për provim të mbaruar (neni 21).
- Arsimi pas arsimit të mesëm dhe trajnimi është arsim që përgatit në mënyrë përfundimtare kuadro për detyra të caktuara profesionale për segmente të caktuara nga procesi i punës, me ç'rast nxënësit të cilët kanë mbaruar arsim pas arsimit të mesëm japin provim të specializuar gjegjësisht provim të mjeshtrit (neni 19) dhe marrin diplomë për provimine mjeshtrit (neni 21) ose diploma për arsim të specializuar (neni 21).

- Arsimit të rriturve që realizohet në institucionet për arsim dhe trajnim profesional si pjesë integruese e mësimit të përjetshëm, që i ndërlidhë segmentet e caktuara dhe format e arsimit në një sistem unik.

Në përputhje me nenin 35 të LAMP-së, pas përfundimit të vitit të fundit të arsimit profesional jepet provimi i maturës shtetërore ose provimi përfundimtar. Pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional me kohëzgjatje katërvjeçare nxënësit japin provimin e maturës shtetërore ose provimin përfundimtar. Pas përfundimit të arsimit profesional publik me kohëzgjatje trevjeçare nxënësit japin provimin përfundimtar. Sipas nenit 38 të LAP-it, programet për dhënien e provimit të maturës shtetërore, maturës së shkollës, provimit përfundimtar dhe maturës ndërkombëtare i aprovon ministri, me propozim të BZHA-së.

Në përputhje me nenin 20 të LAMP-së, programet për provim të specializimit i përpiçon Qendra në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Maqedonisë së Veriut, ndërsa i aprovon ministri, derisa programet e provimit të mjeshtrit dhe programet e provimit për aftësim profesional për veprimtari zejtare i miraton Oda e Zejtareve të Maqedonisë së Veriut, pas pëlqimit paraprak nga ministri. Në përputhje me nenin 42 të LZ-së parashikohet mundësi për përvetësimin e titullit mjeshtrë. Më tutje në nenin e njëjtë parashikohet që titulli mjeshtrë të përvetësohet në përputhje me LAMP-në.

Në përputhje me nenin 2 të Ligjit për arsimin e të rriturve<sup>51</sup>, arsimit të rriturve mund të realizohet përmes: programeve të njohura publikisht për arsimin e të rriturve që paraqesin programe për arsim formal që i miraton ose aprovon organi kompetent shtetëror dhe programe të veçanta që paraqesin programe për arsim joformal për përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave. Në përputhje me nenin 3 të LARR-it, arsimit të rriturve përfshin mësim formal, joformal dhe informal. Me arsim formal të të rriturve nënkuptohet veprimtaria që realizohet në përputhje me ligjet që e rregullojnë veprimtarinë arsim fillor, të mesëm dhe të lartë, nëse me këtë Ligj nuk është rregulluar ndryshe. Arsimit formal të të rriturve është arsimit i institucionizuar që realizohet në ente dhe institucione shtetërore dhe private si arsim i rregullt dhe me korrespondencë, sipas planeve dhe programeve përkatëse mësimore.

Arsimit formal të të rriturve përfshin: arsim fillor të të rriturve, arsim të mesëm të të rriturve, aftësim profesional, arsim profesional për profesion, arsim teknik dhe arsim pas arsimit të mesëm për të moshuar, rikualifikim, kualifikim plotësues, si dhe arsim të lartë të të rriturve. Arsimit joformal të të rriturve nënkupton procese të organizuara të mësimit të orientuara drejt aftësimit të të rriturve për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal. Mësimi informal të të rriturve nënkupton aktivitete në të cilat të rriturit i pranojnë qëndrimet dhe vlerat pozitive, shkathtësitë dhe dituritë nga përvojat e përditshme dhe ndikimet tjera nga mjedisi i tij.

Në kuadër të intervistave të realizuara janë përfshirë çështje që kanë të bëjnë me arsimin e të rriturve.

<sup>51</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

Në këtë drejtim, në Qendrën për Arsimin e të Rriturve është theksuar se *përkundër interesit të rritur në fillim për realizimin e programeve për arsimin e të rriturve, momentalisht ka vetëm 17 ofertues aktiv të cilët ofertojnë arsim për të rritur në rajonet qëllimore të planifikimit*. Në periudhën e disa viteve të fundit janë akredituar rreth 75 programe që i nënshtrohen verifikimit të rregullt. *Verifikimi i sërishëm arrin 10 000,00 denarë sipas programit që, siç duket, është shpenzim që është i lartë për ofertuesit*.

Është bërë e ditur se *ekziston përputhje të kompetencës në pjesën e standardeve të profesionit, si dhe në pjesën e moshës në të cilën mund të fillohet me këtë lloj të arsimit*. Sipas nenit 27 të Ligjit për arsimin e të rriturve, pjesëmarrës në programet e arsimit për të rritur mund të jetë personi i cili i ka mbushur 15 vjet, gjë që nga ana tjetër nuk është në korrelacion me Ligjin për arsim të mesëm në të cilin premisa themelore është detyrimi i arsimit të mesëm. Në këtë drejtim, është sugjeruar se përfshirja e moshës në arsimin e mesëm duhet të dallojë nga përfshirja e moshës në arsimin për të rritur.

Është parashikuar që sistemi i verifikimit të arsimit joformal të vihet në funksion prej vitit 2020.

Në përgjithësi ekziston *interesim i dobët te komunat për bashkëpunim me Qendrën për Arsimin e të Rriturve*. *Nuk respektohet dispozita për mbajtjen e regjistrit komunal për ente dhe institucione që realizojnë programe të njohura publikisht*.

Ekzistojnë *edhe më shumë shembuj të praktikave më të mira* (si për shembull, trajnimi i infermierëve në Shkollën e Mesme “Pançe Karagjov”).

Ligj për universitete të hapura qytetare për mësim të përjetshëm<sup>52</sup> parashikon nënenin 3 se në universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm realizohet arsimi formal dhe joformal i të rinjve dhe personave të rritur. Arsimi formal i të rinjve dhe personave të rritur përfshin: arsimin fillor për të rritur, arsimin e mesëm për të rritur, aftësimin profesional, arsimin profesional për profesion, arsimin teknik dhe arsimin pas arsimit të mesëm për të rritur, si dhe rikualifikimin dhe kualifikimin plotësues. Arsimi fillor për të rritur realizohet në universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm, edhe atë si arsim i rregullt dhe me korrespondencë. Arsimi i mesëm për të rritur, aftësimi profesional, arsimi profesional për profesion, arsimi teknik dhe arsimi pas arsimit të mesëm për të rritur, si dhe rikualifikimi dhe kualifikimi plotësues realizohen në universitetet e hapura qytetare për mësim të përhershëm, edhe atë si arsim i rregullt dhe me korrespondencë. Arsimi formal për të rritur realizohet në përputhje me ligjet që e rregullojnë këtë veprimtari, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe. Arsimi joformal i të rinjve dhe personave të rritur nënkupton procese të organizuara të mësimi, të dedikuara për aftësim të të rinjve dhe personave të rritur për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal në përputhje me Ligjin për arsimin e të rriturve. Në përputhje me nenin 132 të LAL-it, arsimi i lartë realizohet përmes realizimit të studimeve akademike

<sup>52</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018

dhe profesionale që i aftësojnë studentët për ndërtimin e karrierës profesionale përmes përvetësimit të kualifikimeve profesionale të arsimit të lartë në përputhje me regullat e punës. Nga këtu, është në interes zhvillimi i studimeve profesionale. Në përputhje me nenin 137, (3) të LAL-it, studimet profesionale të ciklit të parë zgjasin tre vite dhe me përfundimin e tyre përvetësohen 180 ECTS kredi, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Në kuadër të ciklit të parë të studimeve profesionale mund të realizohen edhe programe të shkurtra studimore me 60 deri 120 ECTS kredi. Në përputhje me nenin 137, paragrafi (8), kualifikimet që përvetësohen me përfundimin e programit studimor të ciklit të parë të studimeve profesionale i takojnë nivelit VI B për studime profesionale trevjeçare të ciklit të parë, gjegjësisht nivelit V A për programe të shkurtra profesionale studimore të ciklit të parë me 60 deri 120 ECTS kredi nga Korniza kombëtare e kualifikimeve të arsimit të lartë e përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve dhe korrespondojnë me nivelin VI, gjegjësisht nivelin V të Kornizës evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Në përputhje me nenin 141 të LAL-it, universitetet dhe shkollat e larta profesionale mund të organizojnë programe të ndryshme të përsosjes eksperte, gjegjësisht përsosje profesionale duke marrë parasysh konceptin për mësim të përjetshëm. Këto programe organizohen për shkak të përsosjes, plotësimit, thellimit dhe modernizimit të diturisë dhe nuk konsiderohen si studime në kuptimin e këtij ligji. Pas përfundimit të programeve për përsosje eksperte, gjegjësisht profesionale përvetësohet vërtetimi, gjegjësisht certifikatë që e lëshon universiteti, gjegjësisht shkolla e pavarur e lartë profesionale. Pjesëmarrësit në format për përsosje eksperte, gjegjësisht profesionale nuk kanë status të studentëve. Gjithashtu, në përputhje me nenin 141, paragrafi (5) të LAL-it, mund të organizohen edhe forma të ndryshme të nxënies joformale, si kurset, universitetet verore dhe dimërore, shkollat, punëtoritë dhe ngjashëm. Pas përfundimit të formës përkatëse të mësimi joformal merret vërtetimi, gjegjësisht certifikatë që e lëshon universiteti ose njësi e universitetit, gjegjësisht shkollë e pavarur profesionale.

Forma e veçantë e aftësimi parashikohet në nenin 142 të LAL-it, ku parashikohet se me përvetësimin e diturive profesionale dhe trajnimin entet e arsimit të lartë mund të organizojnë arsim profesional me kohëzgjatje edhe më të shkurtër se tre vjet.

*Konstatim i përgjithshëm për planet mësimore është se në disa prej tyre ende mungon përfundim më i madh i mësimi dhe trajnim praktik. Gjendja aktuale në realizimin tregon se ajo nuk është e organizuar sa duhet, nuk është efikase dhe nuk i jep rezultatet e dëshiruara. Gjithashtu, duhet të theksohet se ajo që vërehet është se lëndët e përgjithshme arsimore janë të përfunduar në përmasa më të mëdha, sesa ajo që është pritur për këtë lloj të arsimit, duke i anashkuar në këtë mënyrë lëndët profesionale dhe trajnimin praktik. Në këtë drejtim, Konceptimi për modernizimin e arsimit teknik të vitit 2016, përfshin në vete drejtime për reformimin e arsimit teknik*

4-vjeçar<sup>53</sup>, ku përqindja e trajnimit praktik dhe lëndëve profesionale është më e madhe sesa e atyre të përgjithshme shoqërore në të gjitha profilet dhe profesionet. Këto plane mësimore do të zbatohen prej shtatorit të vitit 2019.

Ligji për kornizën kombëtare të kualifikimeve<sup>54</sup> është ligj relativisht i ri, i miratuar në vitin 2013. Mungon zbatimi i tij më gjithëpërfshirës në praktikë. Bëhet fjalë për ligj i cili në mënyrë sistemore i rregullon nivelet dhe strukturën e kualifikimeve. Në përputhje me nenin 11 janë parashikuar llojet vijuese të kualifikimeve: kualifikime në nivel të arsimit (nivel arsimor) dhe kualifikime profesionale. Në përputhje me këtë Ligj, si kompetente për zhvillimin e kualifikimeve në përputhje me nenin 13 janë parashikuar: për zhvillimin e kualifikimeve nga niveli I deri V-B i kualifikimeve janë: Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, Qendra për Arsimin e të Rriturve dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit, derisa nga ana tjetër për zhvillimin e kualifikimeve nga niveli V-A deri VIII janë entet e arsimit të lartë. Subjekt të veçantë në këtë sistem paraqet Këshilli nacional për Kornizën maqedonase të kualifikimeve.

**TABELA 18: PLANE DHE PROGRAME MËSIMORE**

**Rekomandime**

- Rritje të përfshirjes së Qendrës për Arsim dhe Trajnimin Profesional në këtë pjesë përmes përfshirjes së saj në Ligjin për arsimin e mesëm (neni 22 i Ligjit).
- Ridizajnimi i të gjitha programeve mësimore përmes përfshirjes më të madhe procentuale të lëndëve profesionale dhe trajnimit praktik (veçanërisht në vitet përfundimtare të arsimit të mesëm profesional).
- Dimensionim i lëndëve të përgjithshme arsimore në nivelin që nevojitet për nxënësit e këtyre sektorëve të arsimit.

### 3.1.9. Libra shkollorë

Në interes për këtë analizë është Ligji për libra shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm<sup>55</sup>, duke marrë parasysh faktin se me këtë Ligj rregullohet procedura për botimin e librave shkollorë edhe për arsimin e mesëm profesional. Në përputhje me nenin 1 të këtij Ligji, me botim librash nënkuptohet përgatitja, përpunimi dhe aprovimi i librave shkollorë si mjet mësimor bazë. Në përputhje me nenin 2, të këtij Ligji me nocionin “libër shkollor” nënkuptohet mjete mësimor bazë dhe burim i dijes për realizimin e qëllimeve edukativo-arsimorë të përcaktuara me planet dhe programet mësimore të arsimit fillor dhe të mesëm.

Konsiderojmë se nevojitet në nenin 4, të këtij Ligji, të forcohet roli i Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional, sipas shembullit të pranishëm në këtë nen të Byrosë

<sup>53</sup> Karakteristika kryesore të strukturës së planit të reviduar mësimor në kuadër të këtij dokumenti janë si vijon: 1) zvogëlimi i fushave të përmendura ekzistuese programore nga gjashtë në katër, gjegjësisht Arsimi i përgjithshëm, Arsimi i mesëm, Arsimi dhe trajnimi praktik (Mësimi praktik dhe mësimi përmes punës) dhe Përmbajtje të programuara nga shkolla; 2) zëvendësimi i lëndëve me module që janë ose obligative ose zgjedhore; 3) proporcioni i kohës së kushtuar për Arsimin e përgjithshëm dhe Arsimin profesional (duke përfshirë edhe Arsimin dhe trajnimin praktik) duhet të jetë 45/55 në të katër vitet e programit për arsim teknik, me këtë rast proporcioni i propozuar vjetor mes arsimit të përgjithshëm dhe profesional: viti 1 - (70/30); viti 2 - 60/40; viti 3 - 40/60; viti 4 - (30/70).

<sup>54</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 137/2013 dhe 30/2016

<sup>55</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018

për Zhvillimin e Arsimit. Është e pakontestueshme se në këtë Ligj është e pranishme QATP-ja, me rol të veçantë, por është e pëlqyeshme që të jetë edhe në nenin 4. Me fjalë të tjera, QATP-ja, është e përfshirë në nenin 6-a të këtij Ligji, sipas të cilit, në shkollën e mesme mund të shfrytëzohet edhe literaturë profesionale, për të cilën Ministria, me propozim të komisionit të formuar nga ministri, jep pëlqim për përdorimin e literaturës profesionale, gjegjësisht revistave për fëmijë në shkollën fillore dhe të mesme, pas mendimit paraprak të Byrosë, gjegjësisht Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional. Argument plotësues për këtë është edhe neni 12 i këtij ligji sipas të cilit Programin për botimin e librave shkollorë e përpilon Byroja në bashkëpunim me Qendrën e Arsimit dhe Trajnimit Profesional dhe me Qendrën e Arsimit të të Rriturve, ndërsa e aprovon ministri. Duhet të merret parasysh edhe dispozita e nenit 32 të LATP-së.

*Moment pozitiv* në këtë Ligj paraqet mundësia e parashikuar në nenin 5-a, sipas të cilit, në arsimin fillor dhe të mesëm për lëndët mësimore mund të përdoren edhe libra shkollorë përkatës të adaptuar nga shtete të huaja, të harmonizuar me programet mësimore të miratuara nga ministri në përputhje me nenin 22 paragrafi 1 i Ligjit për arsim të mesëm dhe të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në RM.

Në nenin 7 i cili ka të bëjë me përbërjen e Komisionit kombëtar për libra shkollorë, rekomandohet që të përmendet saktësisht numri i përfaqësuesve të shkollave të mesme profesionale, meqë ekziston rreziku, të mungojnë përfaqësues të këtyre shkollave të mesme dhe numri i përfaqësuesve nga shkollat e mesme të plotësohet nga përfaqësuesit e gjimnazeve. Gjithashtu, përkundër faktit se bëhet fjalë për organ profesional, duke marrë parasysh kompetencat e tij, rekomandohet që në këtë organ të jenë anëtarë përfaqësues (ekspertë) nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe nga Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional.

Në nenin 10 të këtij Ligji parashikohet se kush mund të jetë autor i një libri shkollor. Kjo dispozitë e përjashton mundësinë që si autor i librit shkollor të paraqitet një person nga praktika. Me fjalë të tjera, në përputhje me dispozitën e nenit 10, nga autori kërkohet “të ketë së paku dhjetë vjet përvojë pune si mësimdhënës ose bashkëpunëtor në arsimin e lartë, gjegjësisht si mësimdhënës në arsimin fillor ose të mesëm sipas lëndës përkatëse mësimore për të cilën është dedikuar libri shkollor“. Nga këtu duhet të shqyrtohet opsioni, si bashkautor i një pjese ose librit të tërë të mund të paraqitet edhe personi i cili është punëdhënës i obliguar për trajnim praktik. Bëhet fjalë për person që ka njohuri dhe përvoja praktike dhe në këtë mënyrë i njëjtë është i kufizuar që këto njohuri t’i transmetojë përmes pjesëmarrjes në përpunimin e librit shkollor.

Disa herë gjatë intervistave të realizuara është theksuar se *element i rëndësishëm në procesin arsimor paraqet shfrytëzimi i librave shkollor përkatës si dhe doracakëve dhe literaturës plotësuese për përgatitjen e kuadrit mësimdhënës dhe nxënësve*. Në disa raste është bërë e ditur se *librat shkollorë dhe doracakët paraqesin sfidë serioze*.

**TABELA 19: LIBRA SHKOLLORË****Rekomandime**

- Shfrytëzim i mundësisë së parashikuar në Ligjin për libra shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm gjë që mundëson përdorimin e librave të huaja të adaptuara (neni 5-a i këtij Ligji).
- Parashikim i anëtarëve të domosdoshëm përfaqësues të shkollave të mesme profesionale në Komisionin kombëtar për libra shkollorë si dhe përfshirje të përfaqësuesve të Qendrës për Arsimit dhe Trajnim Profesional dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.
- Mundësim që si bashkautorë të librave shkollorë të paraqiten persona që kanë njohuri profesionale në kuadër të punëdhënësve bashkësisë afariste (harmonizim të nenit 10 të këtij Ligji).

**3.1.10. Mbikëqyrje**

Krahas konceptit të verifikimit dhe metodave të tjera kontrolluese, me rëndësi të posaçme për kontrollin dhe mbikëqyrjen e implementimit të rregullave në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional janë dispozitat e rregullave të ndryshme me të cilat rregullohet mbikëqyrja inspektuese.

Lidhur me ushtrimin e mbikëqyrjes në përputhje me Ligjin për arsim të mesëm, në nenin 105, parashikohet se mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së shkollave të mesme kryen Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Mbikëqyrje profesionale në shkollën e mesme kryen Byroja për Zhvillim të Arsimit në mënyrë të përcaktuar me ligj (neni 107). Shkolla e mesme është e obliguar të mundësojë kryerje të pandërprerë të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit në dokumentacionin pedagogjik që mbahet në shkollën e mesme. Për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera nga fusha e arsimit të mesëm në shkollat e mesme kryhet mbikëqyrje inspektuese. Mbikëqyrje inspektuese bën Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunave, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit në mënyrë të përcaktuar me ligj (neni 108). Inspektorati Shtetëror i Arsimit, bën edhe mbikëqyrje të cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat e mesme.

Në pjesën e mbikëqyrjes së arsimit të mesëm profesional, në përputhje me Ligjin për arsim dhe trajnim profesional në nenin 39 parashikohet se institucioni kompetent për zbatimin e Ligjit është MASH-i. Më tutje, parashikohet se mbikëqyrjen inspektuese të punës së enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve e bën Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Lidhur me mbikëqyrjen e arsimit të të rriturve, në përputhje me nenin 43 të LARR-it parashikohet se mbikëqyrje inspektuese dhe mbikëqyrje të cilësisë së punës së enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve bën Inspektorati Shtetëror i Arsimit. Krahas kësaj, parashikohet se mbikëqyrje profesionale të punës së entit gjegjësisht institucionit për arsimin e të rriturve bën Qendra për Arsimin e të Rriturve.

Në përputhje me Ligjin për universitete të hapura qytetare për mësim të përjetshëm, në nenin 17 si institucion kompetent për zbatimin e këtij ligji parashikohet

MASH-i. Më tutje, në nenin e njëjtë, si shërbim kompetent inspektues parashikohet Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në përputhje me Ligjin. Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në përputhje me Ligjin, kryen vlerësim integral të universiteteve të hapura qytetare për mësim të përjetshëm.

Rol qendror në mbikëqyrjen e këtij segmenti ka Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Inspektorati Komunal i Arsimit, të rregulluar në përputhje me Ligjin për Inspektimin e Arsimit (LIA)<sup>56</sup> me të cilin rregullohen në mënyrë më të hollësishme, kompetencat dhe autorizimet e inspektimit të arsimit, që e bën Enti Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunës dhe Qytetit të Shkupit. Kjo do të thotë se janë vendosur dy nivele të inspektimeve, edhe atë: inspektim shtetëror dhe inspektim i vetëqeverisjes lokale.

Lidhur me mbikëqyrjen e realizimit të proceseve në arsimin dhe trajnimin profesional, duhet të theksohet neni 2 i LIA-së, sipas të cilit, kryerja e mbikëqyrjes inspektuese arsimore përfshin mbikëqyrjen e cilësisë së procesit arsimor dhe efektivitetit përmes vlerësimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore në arsimin fillor dhe të mesëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme nga fusha e edukimit dhe arsimit. Në përputhje me LIA-n, mbikëqyrje inspektuese arsimore bëhet në: shkollat fillore, shkollat e mesme, në kopshtet e fëmijëve, në entet për arsimin e të rriturve, në entet për arsimimin dhe aftësimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore. Në nenin 4, paragrafi (4) të Ligjit për inspektim arsimor duhet të përfshihen edhe subjektet kompetente në fushën e arsimit (të mesëm) profesional, e para së gjithash Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional. Në përputhje me nenin 19 të Ligjit të inspektimit arsimor, inspektori shtetëror i arsimit mbikëqyrjen e kryen përmes: vlerësimit integral të institucioneve edukativo-arsimore, inspektimit të rregullt, mbikëqyrjes së jashtëzakonshme dhe mbikëqyrjes kontrolluese.

Është me rëndësi të theksohet se në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional, e në segmentin e sigurisë në vendin e punës dhe në segment të marrëdhënieve të punës janë parashikuar rregulla të veçanta të mbikëqyrjes.

Në përputhje me Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës, në nenin 48 parashikohet se mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit e bën Ministria kompetente për çështjet nga fusha e punës, ndërsa mbikëqyrjen inspektuese në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës e bën Inspektorati Shtetëror i Punës sipas këtij ligji dhe Ligjit për inspektim të punës. Në përputhje me nenin 256 të Ligjit për marrëdhënie të punës, mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e kryen organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e inspektimit të punës.

<sup>56</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 64/2018

**TABELA 20: MBIKËQYRJA****Rekomandime**

- Nevojitet koordinim më i madh i inspektorateve kompetente për kontrollin dhe mbikëqyrjen e çështjeve të ndryshme të arsimit të mesëm profesional.
- Përveç asaj se “siguron mbështetje të arsimit profesional përmes këshillimit, udhëzimit dhe mentorimit të arsimtarëve dhe trajnuesve të lëndëve profesionale në arsimin dhe trajnimin profesional” të parashikuar me LAMP (neni 32), duhet të parashikohet edhe në LAMP-in për mundësinë e QATP-së për ushtrimin e mbikëqyrjes profesionale në institucionet për arsim dhe trajnim profesional.
- Realizim të mbikëqyrjes efikase të cilësisë së procesit arsimor gjatë realizimit të trajnimit praktik në kuadër të punëdhënësit.
- Realizim i mbikëqyrjes efikase të kushteve për siguri dhe shëndet gjatë punës te punëdhënësit nga inspektoratet kompetente të punës.
- Koordinim mes Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe inspektorëve të autorizuar të komunave, gjegjësisht Qytetit të Shkupit.

**3.1.11. Financim dhe subvencionim**

Sfida kryesore në arsimin dhe trajnimin profesional është ndërtimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit, si dhe masa përkatëse e mbështetjes nga shteti ose nga vetëqeverisja lokale. Arsimit dhe trajnimi profesional mund të jetë organizuar nga 1) entet publike dhe ofertuesit dhe 2) entet private dhe ofertuesit. Kjo analizë ka të bëjë me rregullat juridike për financimin e enteve publike që janë të përfshira në procesin e arsimit dhe trajnimit profesional (formal dhe joformal).

Në përputhje me Ligjin për arsim të mesëm<sup>57</sup>, financimi i shkollave të mesme profesionale mund të bëhet përmes mjeteve buxhetore (përmes fondeve publike), përmes mjeteve plotësuese të ndara nga vetëqeverisja lokale themeluese e shkollës dhe përmes mjeteve personale që i realizojnë shkollat gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre. Në përputhje me nenin 101 të LAMP-it, mjetet për financimin e arsimit të mesëm publik sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për përmbushjen e Buxhetit të Maqedonisë së Veriut dhe Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Këto mjete u shpërndahen komunave me anë të bllok dotacioneve dhe dotacioneve të destinuara në pajtim me Urdhëresën për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacioneve dhe Urdhëresën për metodologjinë për përcaktimin e dotacioneve kapitale dhe të destinuara të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Me dispozitat e përmendura, rregullohet shpërndarja e mjeteve nga bllok dotacionet dhe dotacionet e destinuara, e cila kryhet në bazë të formulës dhe në pajtim me fazat për decentralizimin fiskal të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Formula për shpërndarjen e mjeteve nxirret në bazë të numrit të nxënësve në shkollat e mesme të rajonit të tij. Ndaj nxjerrjes së formulës mund të kenë ndikim edhe

<sup>57</sup> Ligji për Arsim të Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018).

faktorët objektiv vijues: mosha e nxënësve, plani dhe programet të cilat realizohen në shkollë, tipi i objektit shkollor, lokacioni i shkollës, etj.

Krahas kësaj, në përputhje me nenin 101-a, komuna mund ta plotësojë bllok dotacionin e marrë, gjegjësisht dotacionin e destinuar për arsim me mjete nga burimet personale, përveçse për rrogat e të punësuarve në shkollë. Në përputhje me nenin 103 të LAM-it, shkollat publike, gjegjësisht institucionet për arsimin e rritur mund të marrin mjete nga dhënia e shërbimeve arsimore qytetarëve të cilët nuk janë caktuar si nevojë dhe interes i shtetit dhe për të cilët ai nuk siguron mjete.

Në përputhje me nenin 104, shkollat publike mund të përvetësojnë mjete edhe nga: participimi i shfrytëzuesve të shërbimeve; shitja e prodhimeve dhe shërbimeve që janë rezultat i ushtrimit të veprimtarisë bazë; shoqëritë tregtare, ndërmarrjet publike, entet dhe organet e administratës shtetërore në të cilat realizohet trajnim praktik për nxënësit, projektet e aprovuara nga ministri; interesat dhe dividendët e mjeteve të plasuara; lagatet, dhuratat, testamentet dhe burime të tjera. Ato do të dedikohen për avancimin, modernizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë në shkollat publike për çka dorëzohet raport në Ministrinë, gjegjësisht organin e nivelit të vetëqeverisjes lokale. Mënyra e përvetësimit dhe shpërndarjes së mjeteve i rregullon ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional. Në përputhje me këtë, duhet të përmendet Rregullorja për mënyrën e përvetësimit dhe shpërndarjes së mjeteve në shkollat publike Nr. 20-17268/1 të datës 30.12. të vitit 2016, gjegjësisht nenin 6 të kësaj Rregulloreje e cila përmban metodologji për shpërndarjen e mjeteve.

Ligji për arsimin e të rriturve<sup>58</sup> në kapitull të veçantë e rregullon çështjen e financimit të arsimit të të rriturve. Në përputhje me nenin 29 të këtij Ligji, mjetet për financimin dhe nxitjen e arsimit të të rriturve dhe prej burimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Në nenin 30, janë përcaktuar shpenzimet që financohen nga buxheti dhe si të tilla janë përmendur: shpenzimet e realizimit të programeve të arsimit të detyrueshëm për të rritur, shpenzimet për realizimin e programeve të arsimit të mesëm për të rritur të cilët kanë mbaruar vetëm arsim fillor gjegjësisht programe të tjera arsimore, mirëmbajtje të vazhdueshme të enteve për arsimin e të rriturve të cilat i ka themeluar shteti dhe shpenzimet e përcjelljes, avancimit dhe zhvillimit të arsimit për të rritur.

Nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale sigurohen mjete për: shpenzime që kanë të bëjnë me realizimin e programeve në entet për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është vetëqeverisja lokale, mirëmbajtje rrjedhëse të enteve për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është vetëqeverisja lokale dhe investime në entet për arsimin e të rriturve themelues i të cilave është vetëqeverisja lokale. Nga Buxheti i RMV-së dhe nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale mund të aprovohen mjetet financiare për: pajisje me mjete mësimore dhe të tjera dhe zhvillim dhe realizim të programeve inovative për arsimin e të rriturve.

<sup>58</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018

Mjetet e Buxhetit, të përcaktuara në nenin 30 paragrafi 1 alineja 1 dhe 2 të Ligjit, u ndahen enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve në bazë të konkursit publik që e shpallë Qendra. Mjetet nga buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, që janë përcaktuar në nenin 31 paragrafi 1, alineja 1 të këtij ligji u ndahen enteve, gjegjësisht institucioneve për arsimin e të rriturve në bazë të konkursit publik që e shpallë njësia e vetëqeverisjes lokale.

Ligji për universitetet e hapura qytetare për mësim të përjetshëm<sup>59</sup> në nenin 16 parashikon se mjetet për financimin e universiteteve të hapura qytetare për mësim të përjetshëm mund të sigurohen nga të ardhurat e tyre nga shërbimet e kryera, nga themeluesi, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nga lagatet, dhuratat, donacionet dhe nga burimet tjera.

Fitohet përshtypje se në këtë segment, në rregulla të ndryshme janë përfshirë dispozita për mbështetje shtetërore, por të njëjtat nuk janë të saktësuara në mënyrë të hollësishme, e as që përmbajnë detyrim për veprim të institucioneve shtetërore. Në përputhje me nenin 15 të LATP-së, punëdhënësi ka të drejtë të përvetësojë lehtësime financiare, doganore dhe tatimore të përcaktuara me ligj. Në përputhje me nenin 47 të LZ-së, parashikohet se mjetet për pagesën e kompensimit mujor të parashikuar për çirakun sigurohen nga ushtruesi i veprimtarisë zeytare ose Buxheti i RMV-së përmes planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim të APRMV-së, ose projekte dhe burime të tjera.

Në kuadër të intervistave të realizuara që kanë të bëjnë me financimin e arsimit të mesëm profesional, u identifikuan disa trende dhe qëndrime të rëndësishme.

Siç edhe pritej, vërejtja themelore në pjesën e financimit ishte se *nuk ndahen mjete të mjaftueshme*. Si problem më i madh është identifikuar pajisja e pamjaftueshme dhe pajisja e vjetruar në shkolla, si dhe investimet e kufizuara në arsimin e mesëm profesional. Në pjesën e funksionimit të arsimit të mesëm profesional, është me rëndësi të theksohet se shkollat e mesme profesionale përballen me probleme lidhur me sigurimin e pajisjes për nevojat e procesit arsimor (*pajisja e vjetruar tërheqë shpenzime më të mëdha*). Janë dhënë disa propozime konkrete – për shembull, të parashikohen zëra në buxhetin shtetëror për pajisjen e laboratorëve.

Në bisedimet ishte i pranishëm qëndrimi i përgjithshëm se *shkollat përballen me sfida gjatë sigurimit edhe të kuadrit përkatës* mësimdhënës. Për shembull, në shkollat plan-et mësimore të cilave përfshijnë lëndë që kanë të bëjnë me teknologji informatike, *thuaje është e pamundshme të tërhiqen quadro përkatëse (për shembull, mësimi për programin AutoCAD), duke marrë parasysh faktin se këto profile në sektorët tjerë kanë të ardhura mujore që janë edhe nga disa herë më të larta se paga në arsimin e mesëm*.

<sup>59</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018.

Krahas kësaj, *sigurimi i nxënësve në trajnimin praktik në disa komuna nuk është rregulluar me çka paraqitet sfidë edhe me inspektoratin e punës gjatë realizimit të mësimin praktik.*

Trend interesant të shkollat e mesme profesionale është evident edhe në raport me dispozicionin e të ardhurave personale. Një pjesë e shkollave kanë të ardhura personale, një pjesë nuk kanë. Shkollat që kanë të ardhura personale *në të shumtën e rasteve kanë të punësuar në sektorët plotësues në të cilat shkolla i realizon aktivitetet e saj, e me këtë rast përballen me sfida në pjesën e shpërndarjes së mjeteve nga të ardhurat personale, si dhe gjatë punësimit dhe angazhimit të punëtorëve të rinj.* I tillë është rasti me disa shkollat shumicën e rajoneve të planifikuara. Nga njëra anë, duhet theksuar se në disa shkolla ekzistojnë shembuj të praktikave të mira – për shembull, një shkollë ka auto-shkollë, garazh për riparimin e automobilave, Shoqëri brikete (QSHAK “Boro Petrushevski”) etj. Nga ana tjetër, ekzistojnë shembuj të *shkollave që kanë humbur resurse kryesore për punën e tyre si rezultat i rrethanave të jashtme (për shembull, Shkolla e Bujqësisë në Strumicë e kanë humbur truallin bujqësor me një akt të shtetit).*

Për gjendjen aktuale me financimin, në mënyrë më të ilustruar flet e dhëna se një pjesë e shkollave që ishin objekt i hulumtimit kanë llogari të bllokuara. Sfidë të veçantë paraqet edhe problemi i *numrit të vogël të nxënësve paralelen që i rrit në mënyrë plotësuese shpenzimet.*

Në kuadër të intervistave të realizuara në pjesën e financimit është theksuar edhe ajo se *dispozitat për financim dhe dotacione përcaktohen në mënyrë tepër të përgjithshme dhe pa kritere, gjegjësishtse arsimit i mesëm profesional duhet të ketë koeficiente më të larta duke marrë parasysh shpenzimet.* Krahas kësaj, mungon sistemi i ndjekjes së shpërndarjes/shpenzimit të mjeteve nga bllok dotacionet për shkollat veçanërisht në kontekst të mjeteve që janë të destinuara për personat me nevoja të posaçme.

**TABELA 21: FINANCIM DHE SUBVENCIONIM**

**Rekomandime**

- Nxitje të organizimit të veprimtarive që do të sigurojnë burime personale të mjeteve për shkollat përmes vlerësimit të arsyeshëm financiar të punës së arsimtarëve (shqyrtim të metodologjisë nga Rregullorja për mënyrën e përvetësimit dhe shpërndarjes së mjeteve nga shkollat publike).
- Konkretizim i masave për punëdhënësit të parashikuara në nenin 15 të Ligjit për arsim dhe trajnim profesional, përmes planeve dhe programeve të përcaktuara saktësisht, si dhe vendosje të tjerave si për shembull “masat aktive” për sendërtim/pagesë të nxënësve për punën praktike të punëdhënësi.
- Nxitje të punëdhënësve për mbështetje dhe donacione për shkollat.
- Rritje të mjeteve që në mënyrë burimore i ndajnë njësitë e vetëqeverisjes lokale jashtë bllok dotacioneve dhe dotacioneve të destinuara.
- Ndarje të masave të posaçme të destinuara për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore

### 3.1.12. Siguri gjatë punës

Njëra prej çështjeve kryesore për realizimin e trajnimit praktik te punëdhënësi është sigurimi i rregullave që do të garantojnë siguri gjatë punës së nxënësit, gjegjësisht-pjesëmarrësit në trajnimin. Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për procese që do të thonë ekspozim ndaj rrezikut të nxënësve ose pjesëmarrësve në trajnimin, që mund të rezultojë edhe me lëndime të padëshiruara të madhësisë së ndryshme.

Në Republikën e Maqedonisë, përveç ligjit me të cilin rregullohet çështja e sigurisë gjatë punës është edhe Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës<sup>60</sup>. Bëhet fjalë për ligj i cili në mënyrë të saktë dhe të hollësishme e rregullon sigurinë dhe shëndetin gjatë punës. *Nxënësit në trajnim praktik, për nevojat e këtij Ligji janë anashkaluar. Vetëm në nenet 42-a dhe 42-b është siguruar mbrojtje e nxënësve gjatë punës praktike në miniera në kuadër të programit arsimor.* Nevojitet sigurim i mekanizmave ligjor përmes këtij Ligji për të gjithë nxënësit, gjegjësisht pjesëmarrësit në trajnim pavarësisht nga programi mësimor. Kjo mund të bëhet me plotësimin e këtij Ligji. Për nevojat e analizës sonë, e në drejtim të asaj që është parashtruar paraprakisht, është me rëndësi që në kuadër të këtij Ligji, gjegjësishtnenit 2, paragrafi (1) të bëhet saktësim dhe përputhje e qartë e nxënësvesi pjesë e trajnimit praktik. Gjithashtu, nevojitet të bëhet edhe saktësimi plotësues i nocionit punëdhënësi, vend pune dhe mjedis pune nga neni 3 i këtij Ligji. Më tutje nevojitet përfshirje në nenin 5 të këtij Ligji për nxënësit e trajnimit praktik. Dispozita nga neni 16 e cila ka të bëjë me të punësuarit, duhet të ndërlihet edhe me nxënësit të cilët ndjekin trajnim praktik te punëdhënësi. E njëjta gjë ka të bëjë edhe me nenin 25 të këtij Ligji.

Në Ligjin për marrëdhënie pune<sup>61</sup> në pjesën XXIII me titull „Punë me fëmijë më të rinj se 15 vjet, nxënës dhe studentë” janë përfshirë rregulla të veçanta për mbrojtjen e kësaj kategorie tëpersonave. Në këtë kuptim parashikohet se te punëdhënësi mund të ushtrojnë punë praktike në kuadër të programit arsimor nxënësit që kanë mbushur 14 vjet dhe studentët. Në nenin 250, paragrafi (2) parashikohet sekëto kategori të personave i kanë të drejtat e njëjta lidhur me orarin e punës, pushimet dhe pauzat, për mbrojtje të veçantë të punëtorëve si dhe punëtorët të cilët ende nuk kanë mbushur 18 vjet, si dhe përgjegjësinë për kompensimin e dëmit, gjegjësishtedhe për këta persona zbatohen dispozitat nga pjesa XIII me titull “Mbrojtje të punëtorëve të cilët ende nuk kanë mbushur 18 vjet” në kuadër të neneve nga 172 deri 176.

Në përputhje menenin 173 punëtorëve që ende nuk kanë mbushur 18 vjet punëdhënësi nuk guxon t’u urdhërojë që të kryejnë punë të vështira fizike, punë që kryhen nën

<sup>60</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 92/2007, 136/2011, 23/2013, 25/2013, 137/2013, 164/2013, 158/2014, 15/2015, 129/2015, 192/2015 dhe 30/2016

<sup>61</sup> „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018

tokë ose nën ujë, punë me burime të rrezatimeve jonizuese dhe punë të tjera që mund të ndikojnë dëmshëm dhe me rrezik të madh mbi shëndetin, gjegjësisht zhvillimin shëndetësor duke marrë parasysh specifikat e tyre psikofizike. Në përputhje me nenin 174, orari i punës i punëtorit që ende nuk ka mbushur 18 vjet nuk guxon të jetë më i gjatë se tetë orë në ditë dhe 40 orë në javë. Punëtori i cili ende nuk ka mbushur 18 vjet dhe punon së paku katër orë e gjysmë në ditë, ka të drejtën e pauzës gjatë orarit të punës në kohëzgjatje prej së paku 30 minuta. Punëtori i moshës nën 18 vjet ka të drejtën e pushimit prej 16 orëve vijuese gjatë periudhës prej 24 orëve.

Në përputhje me nenin 175, punëtori i cili ende nuk ka mbushur 18 vjet nuk guxon të punojë natën mes orës 22,00 dhe orës 6,00 të ditës së ardhshme. Me përjashtim mund të përcaktohet që punëtori i cili ende nuk ka mbushur 18 vjet të punojë natën në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, kur puna e tillë zgjatë një kohë të caktuar dhe duhet doemos të kryhet menjëherë, ndërsa punëtorët e rritur nuk janë në dispozicion. Në rast të tillë duhet patjetër punëtorëve të cilët ende nuk kanë mbushur 18 vjet, t'u sigurohet pushim në tre ditët e ardhshme. Sipas nenit 176, punëtori i cili ende nuk ka mbushur 18 vjet ka të drejtën e pushimit vjetor të rritur për shtatë ditë punë.

Në Ligjin për marrëdhënie të punës janë përfshirë edhe dispozita të posaçme të cilat kanë të bëjnë me çirakët. Sipas nenit 251 të Ligjit për marrëdhënie të punës, për çirakun gjatë aftësimin profesional të punëdhënës zbatohen dispozitat e këtij Ligji dhe të ligjit tjetër me të cilat rregullohet mbrojtja e veçantë e punëtorëve të cilët ende nuk kanë mbushur 18 vjet, sistemimi në vendin e punës, pushimi gjatë orarit të punës, pushimi javor, pushimi i paguar, mungesë nga puna për shkak të festimit, mungesë nga puna për shkak të paaftësisë për punë për shkak të sëmundjes, mungesë nga puna për shkak të ushtrimit të postit ose obligimeve sipas ligjeve të veçanta dhe përgjegjësi për kompensimin e dëmit. Në përputhje me nenin 18 të Ligjit për marrëdhënie pune, numri maksimal i orëve në orarin e punës të personit të ri të moshës 16 vjeçe është 30 orë në javë edhe në raste kur personi i ri punon te më shumë punëdhënës të njëjtën kohë. Numri maksimal i orëve të orarit të punës të personit të ri të moshës mbi 16 vjeç është 37 orë e 45 minuta në javë edhe në raste kur personi i ri punon te më shumë punëdhënës.

Ligji për marrëdhënie pune rregullon edhe çështjen e kryerjes së stazhit të praktikantit, stazhit vullnetar dhe punës provuese. Me fjalë të tjera, sipas nenit 56 të Ligjit për marrëdhënie pune, me ligj, rregull tjetër ose marrëveshje kolektive në nivel të veprimtarisë mund të përcaktohet, të lidhet marrëveshje për punësim si praktikant, i cili për herë të parë fillon të ushtrojë punë përkatëse me llojin dhe nivelin e arsimit të tij profesional, për shkak të aftësimin për ushtrim të pavarur të punës në marrëdhënien e punës. Në përputhje me nenin 57 të këtij ligji, stazhi i praktikantit mund të zgjasë më së shumti një vit, nëse me ligj nuk është përcaktuar më ndryshe. Stazhi i praktikantit mund të vazhdohet proporcionalisht, nëse praktikanti punon me orar më të shkurtër të punës nga orari i plotë i punës, por më së shumti për gjashtë muaj.

Sipas nenit 58, për kohëzgjatjen e stazhit të praktikantit, punëdhënësi është i obliguar që praktikantit, sipas programit, t'i sigurojë aftësim për ushtrimin e pavarur të punës. Në fund të stazhit të praktikantit, praktikanti duhet doemos të japë provim, që është pjesë përbërëse e stazhit të praktikantit dhe jepet para skadimit të stazhit të praktikantit.

**TABELA 22: SIGURI GJATË PUNËS**

**Rekomandime**

- Përfshirje të saktë dhe precize të nxënësve dhe pjesëmarrësve në trajnimet në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës.
- Implementimi i plotë i dispozitave dhe standardeve për siguri dhe shëndet gjatë punës në kuadër të punëdhënësit që e organizon trajnimin praktik.
- Zbatim i plotë i dispozitave të Ligjit për marrëdhënie të punës nga pjesa XXIII me titull „Punë me fëmijë më të rinj se 15 vjet, nxënës dhe studentë”, si dhe në pjesën XIII me titull „Mbrojtje të punëtorëve të cilët ende nuk kanë mbushur 18 vjet”.
- Angazhim aktiv të trupave kompetente inspektuese, me qëllim të përcaktimit të zbatimit konsekuent të standardeve për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe dispozitat nga Ligji për marrëdhënie pune gjatë realizimit të trajnimit praktik te punëdhënësi.

### 3.2. Rezultate lidhur me financimin dhe alokimin e resurseve në arsimin dhe trajnimin formal profesional

Në këtë pjesë janë dhënë rezultate nga analiza e financimit të arsimit dhe trajnimit formal profesional, në 7 sektorë dhe 4 rajone në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Konstatimet mbështeten në informacionet nga disa burime: Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e Llogarisë vjetore të shkollave, përgjigjet në pyetjet e pyetësorit lidhur me situatat në shkollat për resurset dhe alokimin e resurseve, informacioneve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit, si dhe informacione nga intervistat e realizuara.

#### 3.2.1. Të ardhura dhe shpenzime të shkollave

##### *Të ardhura*

Analiza e të ardhurave të shkollave të mesme shënon një analizë të të dhënave për punën financiare të shkollave të kapshme në Bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve, që paraqet pjesë përbërëse të Llogarisë vjetore. Analiza e të ardhurave sipas rajoneve tregon se të ardhurat e përgjithshme të shkollave në vitin 2017 arritën më shumë se 1,1 miliardë denarë. Me këtë rast, shkollat në pjesën më të madhe financohen përmes transferet nga nivelet tjera të pushtetit (pushtetit qendror dhe lokal). Pjesëmarrja e kësaj të ardhure në të ardhurat e përgjithshme të shkollave në katër rajone për të cilat morëm përgjigje të plotë të kërkesave për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik arrin thuajse 97 përqind. Shkollat thuajse nuk realizojnë të ardhura jotatimore dhe nuk kanë pasur të ardhura kapitale në vitin 2017.

**Tabela 23. Struktura e të ardhurave të shkollave të mesme profesionale në denarë**

<b>TË ARDHURA</b>	<b>Rajoni jug-perëndimor</b>	<b>Rajoni juglindor</b>	<b>Rajoni i Pollogut</b>	<b>Rajoni i Shkupit</b>	<b>GJITHSEJ</b>
Taksa dhe kompensime	1.015.800	2.322.565	13.006.779	16.659.292	<b>33.004.436</b>
Të ardhura të tjera jotatimore	124.487		407.221	174.920	<b>706.628</b>
Transfere nga nivelet tjera të pushtetit	69.524.675	77.360.684	248.540.365	723.529.189	<b>1.118.954.913</b>
Donacione nga shtete të huaja	578.384		1.726.525	2.927.546	<b>5.232.455</b>
Donacione rrjedhëse				20.000	<b>20.000</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>71.243.346</b>	<b>79.683.249</b>	<b>263.680.890</b>	<b>743.310.947</b>	<b>1.157.918.432</b>

Burimi: Llogari përfundimtare të shkollave të mesme për vitin 2017.

### Shpenzime

Analiza e shpenzimeve nisët nga destinimi për të cilin janë shpenzuar mjetet e shkollave të mesme profesionale në katër rajonet. Të dhënat edhe në këtë rast janë mbledhur nga Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve të llogarisë përfundimtare. Në esencë, shpenzimet janë organizuar në pesë kategori, gjegjësisht klasë, të grupuara në mënyrë identike si në Bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kështu, kategoria “Paga dhe kompensime” i përfshin pagat, kompensimet dhe të gjitha kontributet e shpenzuara për të punësuarit në shkollë. Në “Mallra dhe shërbime” janë evidencuar shpenzimet që janë bërë për shpenzime rrugore dhe ditore, shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, materiale dhe inventar të imtë, riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse, shërbime kontraktuese, punësime të përkohshme dhe shpenzime të tjera rrjedhëse. „Pagesa të interesave“ i përfshijnë pagesat e interesave ndaj kreditorëve jorezident, ndaj kreditorëve vendorë dhe ndaj niveleve të tjera të pushtetit. Subvencionet për ndërmarrje publike dhe private dhe transferet deri te organizata joqeveritare janë përfshirë në kategorinë “Subvencione dhe transfere”. Kategoria e fundit “Shpenzime kapitale” i përfshin shpenzimet për blerjen e pajisjes dhe makinave, objekteve ndërtimore, blerje të mobileve, automjeteve, etj. Në tabelën e radhës janë paraqitur shpenzimet e përgjithshme të shkollave për secilën prej kategorive ndaras, të grupuara sipas rajonit. Të dhënat kanë të bëjnë me vitin 2017.

**Tabela 24. Struktura e shpenzimeve në denarë**

SHPENZIME	Rajoni jug-perëndimor	Rajoni juglindor	Rajoni i Pollogut	Rajoni i Shkupit	GJITHSEJ
Paga dhe kompensime	86.023.050	44.393.665	198.449.310	261.537.255	<b>590.403.280</b>
Mallra dhe shërbime	18.959.009	33.243.437	131.915.736	120.231.544	<b>304.349.726</b>
Pagesa të interesave	0	0	250.791	14.050	<b>264.841</b>
Subvencione dhe transfere	2.306.742	0	677.095	810.660	<b>3.794.497</b>
Shpenzime kapitale	137.373	0	353.368	8.412.970	<b>8.903.711</b>

Burim: Llogari përfundimtare të shkollave të mesme për vitin 2017.

Nëse shikohet në mënyrë më të hollësishme struktura e shpenzimeve, mund të vërehet se në të katër rajonet e analizuar shkollat më së shumti mjete kanë shpenzuar për paga dhe kompensime të të punësuarve (65 përqind). Është e lartë pjesëmarrja edhe në shpenzimet për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve (33,5 përqind). Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale marrin pjesë me më pak se 1 përqind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve. Në vazhdim janë paraqitur shumtë e shpenzimeve dhe vlerësimeve të përgjithshme për nxënës për katër rajonet.

**Tabela 25. Të ardhura dhe shpenzime të përgjithshme për nxënës, sipas rajonit, në denarë**

RAJONI	Numër i nxënësve	Shpenzimet të përgjithshme	Të ardhura të përgjithshme	Shpenzime të përgjithshme për nxënës	Të ardhura të përgjithshme për nxënës
Jugperëndimor	3124	214.714.975	72.383.633	68.731	23.170
Juglindor	3469	155.274.204	82.005.814	44.761	23.640
i Pollogut	1472	662.939.232	277.094.890	450.366	188.244
i Shkupit	7500	773.599.988	760.145.159	103.147	101.353
<b>GJITHSEJ</b>	<b>15565</b>	<b>1.806.528.399</b>	<b>1.191.629.496</b>	<b>116.064</b>	<b>76.558</b>

### Donacione

Ligji për arsim të mesëm parashikon mundësinë për shkollat e mesme publike që të përvetësojnë mjete edhe në mënyra të tjera përveç përmes dotacioneve nga Ministria kompetente. Njëri prej mekanizmave më të rëndësishëm proaktiv me qëllim që të nxitet përgjegjësi shoqërore është edhe donacioni. Hulumtimi tregoi se një e treta ideale e numrit të përgjithshëm të shkollave të përfshira në hulumtimin kanë pasur donacione në vitin 2017. Me përmasa të njëjta është edhe pjesëmarrja e atyre shkollave që nuk kanë pasur donacione (33,3 përqind). Lidhur me këtë çështje një numër relativisht i madh i shkollave nuk kanë dorëzuar përgjigje (33,3 përqind). Shuma e përgjithshme e mjeteve të donuara në shkollat në vitin 2017 arrin 23.043.838 denarë, renditja e tyre sipas rajoneve është paraqitur në tabelën e radhës:

**Tabela 26. Donacione në vitin 2017 sipas rajoneve**

RAJONI	Shuma e përgjithshme e donacioneve në shkollat në denarë
Jugperëndimor	0
Juglindor	0
i Pollogut	4.870.117
i Shkupit	18.173.721
<b>GJITHSEJ</b>	<b>23.043.838</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesat për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Në të shumtën e rasteve në rolin e donatorit paraqitet edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qyteti i Shkupit, ndërsa më rrallë edhe shoqata të qytetarëve dhe kompani private. Një pjesë e shkollave të mesme në rajonet e zgjedhura kanë pranuar donacion në vitin 2017 edhe nga Qeveria kineze, në të shumtën e rasteve në formë të pajisjes informatike dhe kompjuterike

#### *Pajisje e kabineteve të lëndëve profesionale dhe për mësim praktik*

Çështja e radhës me interes lidhur me alokimin e resurseve financiare të shkollave të mesme profesionale paraqet furnizimi i mjeteve mësimore dhe konkretizuese në kabinetet e lëndëve profesionale dhe për nevojat e mësimin praktik. Në këtë drejtim, u kërkuan dy informacione: (1) sa mjete ka shpenzuar shkolla për furnizimin e makinave/pajisjes/materialeve, gjegjësisht çfarëdo mjetesh mësimore dhe konkretizuese për kabinetet për mësim praktik që shkolla i posedon deri në vitin 2017<sup>62</sup>.

Në pyetjen e parë që u parashtrua u mor përgjigje nga 18 shkolla, gjegjësisht 60 për qinde numrit të përgjithshëm të shkollave të përfshira në hulumtimin. Prej tyre, 11 shkollakanë ndarë mjete për këtë dedikim në vitin 2017, derisa të tjerat për arsye të ndryshme nuk kanë ndarë mjete për furnizimin e mjeteve të reja mësimore dhe konkretizuese. Shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për këtë dedikim arrin 8.321.372 den.

Përgjigjet që janë marrë nga shkollatu organizuan sipas profesioneve dhe sipas rajoneve. Rezultatet janë paraqitur në vazhdim.

<sup>62</sup> Nga shkollat u kërkua edhe informacion që të dorëzojnë listë të makinave/pajisjes/materialeve, gjegjësisht çfarëdo mjetesh mësimore dhe konkretizuese për kabinetet për mësim praktik që shkolla i posedon deri në vitin 2017, si dhe listë të veçantë për mjetet e furnizuara vetëm në vitin 2017. Listat u kërkuan për gjithë shkollën dhe sipas drejtimin. Në këtë pyetje morëm përgjigje nga 15 shkolla, mirëpo të dhënat ishin të paplota, të pastandardizuara ose të pasakta dhe për shkak të kësaj nuk ekzistonte mundësia që të krahasohen dhe nxirren konstatime për profesionet dhe rajonet

**Tabela 27. Mjete të shpenzuara për furnizim të makinave/pajisjes/materialeve, gjegjësisht-çfarëdo mjeteve mësimore dhe konkretizuese për kabinetet nga lëndët profesionale dhe për mësimin praktik në vitin 2017, sipas profesionit.**

PROFESIONI	SHUMA E PËRGJITHSHME NË DENARË
Profesioni i bujqësisë	0
Profesioni i elektroteknikës	2.792.795
Profesioni i makinerisë	107.985
Shërbime personale	211.359
Kimik –teknologjik	415.907
Shëndetësi	587.188
Hotelier	0

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Nga analiza e profesioneve mund të vërehet se shuma më e lartë e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara për furnizimin e makinave/pajisjes/materialeve, gjegjësisht çfarëdo mjeteve mësimore dhe konkretizuese për kabinetet e lëndëve profesionale dhe për mësim praktik në vitin 2017 është në shkollat e profesionit elektroteknik (duke përfshirë edhe IT profilet), derisa shkollat e profesionit (drejtimit) të bujqësisë, nuk kanë ndarë fare mjete në vitin 2017 për këtë dedikim.

Disproporcioni i theksuar përveçse në profesionet mund të vërehet edhe në strukturën rajonale. Kështu, për nevojën e sipërpërmendur më së shumti ndajnë shkollat që i takojnë rajonit të Shkupit, derisa asnjëra nga shkollat e rajonit të planifikuar jugperëndimor që janë përgjigjur në këtë pyetje nuk kanë ndarë mjete.

**Tabela 28. Mjete të shpenzuara për furnizimin e makinave/pajisjes/materialeve, gjegjësisht çfarëdo mjeteve mësimore dhe konkretizuese për kabinetet e lëndëve profesionale dhe për mësim praktik në vitin 2017, sipas rajoneve**

RAJONI	SHUMA E PËRGJITHSHME NË DENARË
i Shkupit	8.213.919
Jugperëndimor	0
Juglindor	51.931
i Pollogut	55.522

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Nga ana tjetër, në tabelën e radhës është paraqitur vlera e makinave, pajisjes, materialeve dhe mjeteve të tjera mësimore dhe konkretizuese për kabinetet për mësim praktik që shkolla i posedon deri në vitin 2017, sipas profesionit. Edhe nga kjo paraqitje mund të vërehet disbalancat e situatave në profesionet e ndryshme.

**Tabela 29. Vlera e makinave, pajisjes, materialeve dhe mjeteve të tjera mësimor dhe konkretizuese për kabinetet për mësim praktik që shkolla i posedon deri në vitin 2017.**

PROFESIONI	VLERA
Profesioni i bujqësisë	0
Shëndetësi	855.264
Shërbime personale	286.694
Hotelieri	165.580
Profesioni i elektroteknikës	987.760
Profesioni i makinerisë	10.231.826
Kimik –teknologjik	387.585
<b>GJITHSEJ</b>	<b>12.914.709</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

### Financim i trajnimeve

Njëri prej parakushteve themelore për mësim të mesëm cilësor profesional është investimi i vazhdueshëm në edukimin dhe sendërtimin e diturive të kuadrit ekzistues mësimdhënës. Trajnimet e kuadrit mësimdhënës paraqesin formë të rëndësishme të investimit në kapital njerëzor në këtë fushë dhe sigurojnë inovacionin dhe modernizimin e vazhdueshëm të procesit arsimor.

Hulumtimi tregoi se vetëm 11 shkolla në 4 rajonet e përzgjedhura kanë ndarë mjete për organizimin ose pjesëmarrje në trajnim të kuadrit mësimdhënës në vitin 2017, 10 shkollainformojnë se nuk kanë ndarë mjete për këtë dedikim, 9 shkolla nuk u përgjigjën në pyetjen.

Në bazë të të dhënave që janë marrë nga shkollat, është përlogaritur se shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për këtë dedikim në vitin 2017 arrin 1.515.266 denarë. Është interesant të shikohet edhe shpërndarja e mjeteve të ndara sipas rajoneve. Lider në këtë kategori, sërish është rajoni i Shkupit, ku shkollat kanë ndarë gjithsej 1.429.035 den. për organizimin ose pjesëmarrjen në trajnim për kuadër mësimor në vitin 2017.

**Tabela 30. Mjete të shpenzuara për organizim ose pjesëmarrje në trajnim të kuadrit mësimdhënës në vitin 2017**

RAJONI	GJITHSEJMJETE NË DENARË
i Shkupit	1.429.035
Jugperëndimor	0
Juglindor	47.280
i Pollogut	38.951

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Nga ana tjetër, segment i rëndësishëm në sigurimin e procesit cilësor arsimor paraqet edhe organizimi i trajnimit praktik. Me fjalë të tjera, shkollatpërmes investimit në resurse në organizimin e trajnimit praktik te punëdhënësi në masë të madhe mund t'i përmirësojnë mundësitë e nxënësve që më mirë dhe më lehtë t'i përvetësojnë specifikat e profesionit, gjegjësishtprofilin dhe në këtë mënyrë të përgatiten në mënyrë më efikase për nevojat e tregut të punës.

Megjithatë, përgjigjet që janë marrë në kërkesat për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik treguan se një pjesë shumë e vogël e shkollave të mesme profesionale ndajnë mjete për këtë dedikim.

**Tabela 31. Sa është shuma e mjeteve që ka shpenzuar shkolla për organizimin e trajnimit praktik te punëdhënësi në vitin 2017 në shumë të përgjithshme?**

MJETE TË NDARA	NUMRI I SHKOLLAVE
Shkolla ka ndarë mjete	3
Shkolla nuk ka ndarë mjete	17
Nuk ka përgjigje	10

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Me këtë rast shuma e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara në vitin 2017 arrin 34.958 den. Prej tyre, 23.344 ka shpenzuar SHMQSH „8 Shtatori“ nga Shkupi, derisa në SHMQSH „Vllado Tasevski“ janë shpenzuar gjithsej 11.614 den. Nga ana e SOSU „Ilinden“ është marrë përgjigje se janë ndarë mjete për transport lidhur me organizimin e trajnimit praktik te punëdhënësi, mirëpo, nuk është marrë informacion i saktë për lartësinë e këtij zëri.

Në këtë drejtim, u është parashtruar pyetje shkollave nëse dhe çfarë shume ka shpenzuar shkolla për të punësuarit në shkollë (kuadër mësimdhënës dhe jomësimdhënës) që janë të përfshirë në trajnimin praktik te punëdhënësi në vitin 2017. Shpërndarja e përgjigjeve në këtë pyetje është e ngjashme si te pyetja paraprake. Me fjalë të tjera, vetëm 2 prej gjithsej 30 shkollave u përgjigjën pozitivisht në këtë pyetje. Me këtë rast, SHMPK “Vëllezërit Milladinov” nga Shkupi ka ndarë 163.700 den. për këtë dedikim, derisa SHMPK Ilinden na informon se kanë ndarë për transport deri te vendi i punëdhënësit, por nuk morëm informacion konkret për shpenzimin e përgjithshëm.

**Tabela 32. Mjete të shpenzuara për të punësuar në shkollë (kuadër mësimdhënës dhe jomësimdhënës) që janë të përfshirë në trajnimin praktik te punëdhënësi në vitin 2017.**

MJETE TË NDARA	NUMËR I SHKOLLAVE
Shkolla ka ndarë mjete	2
Shkolla nuk ka ndarë mjete	18
Nuk ka përgjigje	10

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

### *Shpenzime në barrë të nxënësve, gjegjësishtprindërve*

Lidhur me pyetjen e fundit nga kjo pjesë, sa janë shpenzimet në shumën e përgjithshme, e në barrë të nxënësve, gjegjësishtprindërve në vitin shkollor 2017/2018 për sigurim (për disa profile lloji veçantë i sigurimit), kontrolle mjekësore, pajisje, uniforma, shpenzime për rrugë të nxënësit deri te kompania ku e ndjekin trajnimin, pjesa më e madhe e shkollave u përgjigjën se nuk e posedojnë këtë informacion.

**TABELA 33: TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË SHKOLLAVE**

**Rekomandime**

- Të ardhurat e përgjithshme të shkollave në katër rajonet arrijnë thuhetse 1,2 miliardë denarë. Me këtë rast, ekzistojnë dallime evidente në të ardhurat e përgjithshme të shkollave sipas rajoneve. Thuhetse të gjitha të ardhurat nga shkollat (më shumë se 96 përqind) paraqesin transfere nga nivelet tjera të pushtetit. Pjesëmarrja e të ardhurave jotatimore është e pakonsiderueshme.
- Duhet të tejkalohen disproporcionet rajonale në sigurimin e mjeteve për arsimin dhe trajnimin formal profesional, me qëllim që të sigurohet arsim cilësor.
- Të nxiten shkollat që të kërkojnë dhe krijojnë burime alternative të financimit dhe rritjes së të ardhurave personale.
- Të ulet pjesëmarrja e shpenzimeve joproductive.
- Detyrimisht të nxitet rritje e shpenzimeve kapitale, para së gjithash furnizimi me pajisje dhe makina për kabinetet për mësim praktik.
- Duhet të nxitet aktiviteti donator, nevojitet qasje (dhe trajnim) më proaktive nga shkollat për gjetjen e burimeve alternative të financimit.
- Duhet të nxitet vetëdija për nevojën e përgjegjësisë shoqërore të korporatave dhe donacioneve nga kompanitë.
- Shkollatduhet të ndajnë më shumë mjete për financimin e trajnimit praktik te punëdhënësi.
- Shkollatduhet të ndajnë më shumë mjete për organizimin ose pjesëmarrjen e kuadrit mësimdhënës në trajnim.

### **3.2.2. Resurse për realizimin e procesit arsimor**

Në kuadër të procesit arsimor në shkollat e mesme janë përfshirë disa çështje humltuese. Organizimi i procesit arsimor në masë të madhe varet nga vëllimi dhe cilësia e resurseve të cilat i ka në dispozicion shkolla. Në këtë kuptim, kjo pjesë e analizës përfshin analizën e materialeve dhe resurseve njerëzore të shkollave dhe mobilitetin e tyre.

#### *Kuadri mësimdhënës dhe jomësimdhënës*

Të dhënat për kuadrin mësimdhënës dhe jomësimdhënës në shkollate mesme profesionale në rajonin juglindor, jugperëndimor, e Pollogutdhe rajonin e Shkupit, treguan se numri i përgjithshëm i të punësuarve në shkollatarrin 2 789 persona. Prej tyre, 81 përqind janë kuadër mësimdhënës, derisa 19 përqind janë kuadër jomësimdhënës. Në përgjithësi numër më të lartë të të punësuarve në shkollat profesionale ka në rajonin e Shkupit.

**Tabela 34. Kuadër mësimdhënës dhe jomësimdhënës në shkollate mesme profesionale, gjithsej (vitishkollor 2016/2017)**

RAJONI	KUADËR MËSIMDHËNËS	KUADËR JOMËSIMDHËNËS	GJITHSEJ
Jugperëndimor	465	99	564
Juglindor	321	75	396
i Pollogut	590	106	696
i Shkupit	873	260	1133
<b>GJITHSEJ</b>	<b>2249</b>	<b>540</b>	<b>2789</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së.

Mirëpo, me qëllim që të bëjmë krahasim më të saktë mes rajoneve, numri i kuadrit mësimdhënës dhe jomësimdhënës ishte mesatar me numrin e shkollave në rajon, si dhe me numrin e nxënësve në shkollat. Rezultatet e fituara janë paraqitur në tabelën 33.

**Tabela 35. Kuadër mësimdhënës dhe jomësimdhënës në shkollate mesme profesionale, sipas shkollës dhe sipas nxënësit (viti shkollor 2016/2017)**

RAJONI	Kuadër mësimdhënës sipas shkollës	Kuadër jomësimdhënës sipas shkollës	Kuadër mësimdhënës sipas nxënësve	Kuadër jomësimdhënës sipas nxënësve
Jugperëndimor	66,4	14,1	0,11	0,02
Juglindor	64,2	15	0,09	0,02
i Pollogut	118	21,5	0,11	0,02
i Shkupit	62,4	18,6	0,1	0,03
<b>GJITHSEJ</b>	<b>72,5</b>	<b>17,4</b>	<b>0,1</b>	<b>0,02</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së.

Mund të vërejmë se rajoni i vetëm që ka numër drastik më të lartë të kuadrit mësimdhënës dhe jomësimdhënës është rajoni i Pollogut, ku mesatarisht punojnë 118 arsimtarë në një shkollë dhe 21,5 persona të cilët janë kuadër jomësimdhënës. Nëse, nga ana tjetër e krahasojmë numrin e kuadrit mësimdhënës dhe jomësimdhënës në raport me numrin e nxënësve në rajonin përkatës, mund të vërejmë se në rajonin jugperëndimor dhe atë të Pollogut punojnë 0,11 arsimtarë në një nxënës, në rajonin e Shkupit 0,1, ndërsa numri më i madh i arsimtarëve në një nxënës ka në rajonin juglindor ku punojnë 0,09 arsimtarë në një nxënës. Numri më i madh i kuadrit jomësimdhënës në një nxënës është në rajonin e Shkupit, derisa më i ulët në rajonin e Pollogut.

Është interesante nëse këto të dhëna i paraqesim si numër të nxënësve me të cilët në mesatare punon një arsimtar në secilin prej rajoneve. Të përlogaritura kështu, të dhënat tregojnë se arsimtarët në rajonin e Pollogut dhe atë jugperëndimor, në mesatare punojnë me 9 nxënës, arsimtarët nga rajoni i Shkupit me 10 nxënës, derisa numër më të lartë të nxënësve për një arsimtar ka në rajonin juglindor, ku ky proporcion arrin 11 nxënës në një arsimtar. Mesatarisht, një arsimtar në rajonet dhe profesionet e përmendura punon me 10 nxënës.

### Trajnimi i kuadrit mësimdhënës

Procesi arsimor është i lidhur ngushtë edhe me përpjekjen e vazhdueshme në zhvillimin e diturive dhe aftësive të kuadrit mësimdhënës që mban mësim në shkollat e mesme. Për shkak të kësaj, është kërkuar informacion nga secila shkollë ndaras për numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve dhe për numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve të lëndëve profesionale dhe të trajnimit praktik që kanë ndjekur trajnimin në vitin 2017/2018. Në bazë të përgjigjeve që janë marrë janë përllogaritur rezultatet vijuese:

**Tabela 36. Numri i mësimdhënësve që kanë ndjekur trajnim në vitin shkollor 2017/2018**

RAJONI	Mësimdhënës të cilët kanë ndjekur trajnim	Mësimdhënës të lëndëve profesionale dhe të mësimi praktik të cilët kanë ndjekur trajnim
Jugperëndimor	216	150
Juglindor	91	Nuk ka të dhënë
i Pollogut	Nuk ka të dhënë	33
i Shkupit	357	218
<b>GJITHSEJ</b>	<b>664</b>	<b>401</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik.

Lidhur me numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve të cilët punojnë në shkolla në katër rajonet e planifikimit, konstatojmë se 29,5 përqinde numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve kanë ndjekur trajnim në vitin 2017/2018. Thuajsedfish më e madhe (58,5 përqind në raport me numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve sipas profesioneve profesionale) është pjesëmarrja në trajnime nga mësimdhënësit e lëndëve profesionale dhe mësimi praktik.

### Realizimi i trajnimit praktik

Më tutje, segment i rëndësishëm i procesit arsimor është edhe organizimi dhe realizimi i trajnimit praktik. Hulumtimi përfshin analizë të realizimit të trajnimit praktik në dy forma të arsimit profesional: në arsimin teknik (katërvjeçar) dhe në arsimin profesional të profesioneve (arsim trevjeçar). Në tabelat në vazhdim janë paraqitur informacionet për numrin e nxënësve të cilët kanë realizuar trajnim praktik në vitin 2017/2018.

**Tabela 37. Realizim i trajnimit praktik në arsimin teknik (katëvjeçar) në shkollat e mesme profesionale (viti shkollor 2017/2018)**

RAJONI	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë mësim praktik në kushte reale te punëdhënësi	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë mësim praktik në kuadër të shkollës	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë praktikë feriale	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë praktikë profesionale
Jugperëndimor	2352	100	992	138
Juglindor	1576	124	718	211
i Pollogut	3294	38	2277	104
i Shkupit	5482	291	2671	274
<b>GJITHSEJ</b>	<b>12704</b>	<b>553</b>	<b>6658</b>	<b>727</b>

Burimi: Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional.

**Tabela 38. Realizimi i trajnimit praktik në arsimin profesional të profesioneve (arsim trevjeçar) në shkollat e mesme profesionale (viti shkollor 2017/2018)**

RAJONI	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë mësim praktik në kushte reale te punëdhënësi	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë mësim praktik në kuadër të shkollës	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë praktikë feriale	Numër i përgjithshëm i nxënësve të cilët realizojnë praktikë profesionale
Jugperëndimor	105	141	105	52
Juglindor	132	144	128	
i Pollogut	233	105	216	30
i Shkupit	888	1061	931	69
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1358</b>	<b>1451</b>	<b>1380</b>	<b>151</b>

Burimi: Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional.

### *Suksesi në përfundim të vitit shkollor*

Ndonëse nga shkollat u kërkua e dhënë për numrin e nxënësve të cilët nuk kanë arritur ta përfundojnë vitin paraprak shkollor në afatin e përcaktuar, në përputhje me ligjin, për secilin profesion ndaras dhe sipas viteve mësimore (i parë, i dytë, i tretë, i katërt), megjithatë përgjigjet që janë marrë kishin të bëjnë me shkollat në përgjithësi. Kështu, në bazë të të dhënave që janë marrë, është përllogaritur se gjithsej 152 nxënës nuk kanë arritur ta përfundojnë vitin shkollor në afatin e përcaktuar, prej të cilëve pjesa më e madhe – 140 nxënës, janë nga rajoni i Shkupit. Megjithatë, nëse i krahasojmë këto të dhëna me numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkollat profesionale sipas rajonit, vijmë deri te konstatimi se thuajsetë gjithë nxënësitarrijnë ta përfundojnë vitin në kuadër të afatit të përcaktuar kohor ligjor.

**Tabela 39. Numri i nxënësve të cilët nuk kanë arritur ta përfundojnë vitin shkollor**

RAJONI	NUMRI I NXËNËSVE
Jugperëndimor	6
Juglindor	4
i Pollogut	2
i Shkupit	140
<b>GJITHSEJ</b>	<b>152</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

### *Mobilitet ndërkombëtar*

Në raport me lidhshmërinë ndërkombëtare të shkollave të mesme profesionale, janë hulumtuar dy aspekte: nëse nxënësit në shkollat kanë ndjekur trajnim praktik te punëdhënësi/punëdhënësit në një kompani/disa kompanime kapital dominues të huaj në vitin shkollor 2017/18, si dhe nëse shkolla ka aplikuar dhe realizuar programe për mobilitet ndërkombëtar të nxënësve dhe arsimtarëve në vitin 2017/2018.

Lidhur me pyetjen e parë të hulumtimit nga kjo pjesë janë marrë përgjigje vetëm prej 16 shkollave. Me këtë rast, përgjigja e 11 prej shkollave të cilat u përgjigjën ishte se nxënësit e tyre kanë ndjekur trajnim te një punëdhënësi në kompani me kapital dominues të huaj.

**Tabela 40. Numri i nxënësve që kanë ndjekur trajnim praktik në kompani me kapital dominues të huaj në vitin shkollor 2017/18, sipas rajonit**

RAJONI	NUMRI I NXËNËSVE
Jugperëndimor	17
Juglindor	0
i Pollogut	196
i Shkupit	52
<b>GJITHSEJ</b>	<b>265</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Në raport me pyetjen e dytë lidhur me mobilitetin ndërkombëtar, janë marrë gjithsej 19 përgjigje nga shkollat. Shkollat në të shumtën e rasteve aplikojnë për programin për mobilitet Erasmus+. Përgjigjet të organizuara sipas rajoneve janë dhënë në tabelën në vazhdim:

**Tabela 41. Numri i shkollave të cilat kanë aplikuar në programe për mobilitet ndërkombëtar të nxënësve dhe mësimeve sipas rajonit**

RAJONI	NUMRI I SHKOLLAVE
Jugperëndimor	6
Juglindor	2
i Pollogut	1
i Shkupit	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>19</b>

*Burimi:* Përgjigje që janë marrë në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik

Prej tyre, vetëm 8 shkollakanë realizuar programe për mobilitet ndërkombëtar të nxënësve dhe arsimtarëve në vitin 2017/2018.

**TABELA 42: RESURSE PËR REALIZIMIN E PROCESIT ARSIMOR****Rekomandime**

- Duhet të zvogëlohen disparitetet rajonale në kuadrit mësimeve dhe jomësimeve sipas shkollës dhe sipas nxënësit, me qëllim që të sigurohet qasje e barabartë deri te arsimi i nxënësve të rajoneve dhe profesioneve të ndryshme.
- Më shumë se 40 përqinde mësimeve të lëndëve profesionale dhe mësimit praktik nuk kanë ndjekur trajnim në vitin 2017. Duhet të rritet pjesëmarrja e kuadrit mësimeve, veçanërisht të mësimeve të lëndëve profesionale dhe mësimit praktik, në trajnime për përsosje të mëtejshme edhe të diturive edhe të aftësive të mësimeve.
- Duhet të nxitet mobiliteti ndërkombëtar në arsimin e mesëm, gjegjësisht të stimulohen shkollat që të aplikojnë dhe realizojnë programe për mobilitet ndërkombëtar të nxënësve dhe mësimeve dhe të rritet numri i nxënësve që ndjekin trajnim praktik te punëdhënësit në kompanime kapital dominues të huaj.

**3.2.3. Financim i arsimit profesional nga njësitë e vetëqeverisjes lokale**

Në këtë pjesë të hulumtimit u fokusua në financimin e arsimit të mesëm publik nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Vegla kryesore hulumtuese që u shfrytëzua në këtë pjesë ishin kërkesat për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik që u ishin dërguar nëntë komunave dhe Qytetit të Shkupit të cilat i përkasin rajonit të Shkupit, Pollogut, atij juglindor dhe jugperëndimor. Kërkesat ishin identike për secilin njësi të vetëqeverisjes lokale dhe përmbanin pyetje që kishin të bëjnë me financimin e arsimit të mesëm. Në pyetjet e parashtruara u përgjigjën Qyteti i Shkupit dhe komunat Ilinden, Tetovë, Strumicë, Gjevgjeli, Vallandovë, Makedonski Brod, Ohër dhe Strugë, derisa përgjigje kthyese mungon nga komunat Radovish dhe Kërçovë. Në vazhdim janë paraqitur rezultatet nga hulumtimi i realizuar.

Burim kryesor i financimit të arsimit të mesëm, duke përfshirë edhe arsimin profesional, paraqesin dotacionet. Dotacionet paraqesin mjete që ua ndan shteti organizatave ose ndërmarrjeve për mbulimin e shpenzimeve të rregullta ose për qëllime të tjera. Lartësia e dotacioneve është përcaktuar me udhëzimet në Dekretin për metodologji në për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacioneve

për arsimin e mesëm sipas komunave dhe Qytetit të Shkupit për vitin 2017<sup>63</sup>. Në esencë, lartësia e dotacioneve të përgjithshme nga komunat deri te shkollat e mesme varet para së gjithash nga numri i nxënësve të shkollave të mesme në rajonin e tyre, por edhe nga faktorët tjerë objektiv: mosha e nxënësve, plani dhe programet që realizohen në shkollë, lloji i objektit shkollor, lokaliteti i shkollës, etj. Shumë më të lartë të dotacioneve ka ndarë Qyteti i Shkupit në të cilin gjenden gjithsej 30 shkolla të mesme publike, derisa shumë më të ulët të dotacioneve ka Komuna e Ilindenit me një shkollë.

**Tabela 43. Shuma e përgjithshme e dotacioneve për shkollat e mesme në vitin 2017**

KOMUNA	RAJONI	SHUMA E PËRGJITHSHME E DOTACIONEVE (DEN.)
Qyteti i Shkupit	Shkup	1.071.988.575
Ilinden	Shkup	16.645.000
Tetovë	Pollog	420.571.000
Strumicë	Juglindje	188.068.825
Radovish	Juglindje	43.747.000
Gjevgjeli	Juglindje	51.897.000
Vallandovë	Juglindje	19.630.000
MakedonskiBrod	Jugperëndim	17.058.000
Ohër	Jugperëndim	119.100.000
Strugë	Jugperëndim	129.000.000
Kërçovë	Jugperëndim	99.503.000
<b>GJITHSEJ</b>		<b>2.177.208.400</b>

*Burimi:* Kërkesa për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik të dërguara deri te komunat dhe të dhëna që janë marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së.

Përveçse përmes dotacioneve, Ligji për arsim të mesëm parashikon mundësinë që shkollat e mesme të sigurojnë mjete financiare edhe në mënyra të tjera, si për shembull participimi i shfrytëzuesve të shërbimeve, shitje të produkteve dhe shërbimeve që janë rezultat i ushtrimit të veprimtarisë themelore, mjete nga shoqëritë tregtare, ndërmarrjet publike, entet dhe organet e administrimit shtetëror në të cilat realizohet trajnimi praktik i nxënësve, projekte të aprovuara nga ministri, interesa dhe dividenda, lagate, dhurata, testamente, etj. (neni 104). Ligji nuk përjashton mundësinë që shkollat e mesme të marrin donacione dhe me këtë rast në rolin e donatorëve të paraqiten edhe komunat. Praktika në këtë pjesë tregon se prej gjithsejdhjetë komunave të përfshira në hulumtimin kanë dhuruar mjete për shkollat publike në komunën e caktuar. Në vazhdim është dhënë informacioni për komunat donatore dhe shumën e përgjithshme të mjeteve të dhuruara në vitin 2017.

<sup>63</sup> Kapshme në: <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/3b8be53e03d949a3b67dfce77ae975b8.pdf>

**Tabela 44. Shuma e përgjithshme e donacioneve nga komunat për shkollat e mesme publike në komunë në vitin 2017**

KOMUNA	RAJONI	SHUMA E PËRGJITHSHME E DONACIONEVE NGA KOMUNA (DEN.)
Shkup	i Shkupit	11.202.553
Ilinden	i Shkupit	814.836
Strumicë	Juglindor	99.600
Ohër	Jugperëndimor	89.350
Strugë	Jugperëndimor	135.900
<b>GJITHSEJ</b>		<b>12.342.239</b>

*Burimi:* Kërkesa për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik të dërguara deri te komunat.

Lidhur me pyetjen që ka të bëjë me proceset inkluzive në arsimin e mesëm, nuk janë marrë përgjigje inkurajuese. Me fjalë të tjera, vetëm Komuna e Strumicës nga 10 komunat e hulumtuara është përgjigjur se në vitin 2017 ka ndarë gjithsej 62.000 denarë për arsimin e mesëm për fëmijë me pengesë. Nga ana tjetër, komuna e vetme që ka ndarë dhe shpenzuar mjete për arsimin e mesëm të fëmijëve romë në vitin 2017 ka qenë Komuna e Ilindenit, e cila u ka ndihmuar gjithsej 3 nxënësve të përkatësisë etnike rome. Nga ana tjetër, komuna e vetme, e cila ka ndarë dhe shpenzuar mjete për arsimin e mesëm të fëmijëve me status të palakmueshëm social në vitin 2017 është Komuna e Ohrit me ndarjen e 216.000 denarëve.

Analizat nga përgjigjet që janë marrë përmes kërkesave për qasje të lirë treguan se 44 për qinde komunave që janë përgjigjur në këtë pyetje, kanë rregullore ose dokumente të tjera me të cilat rregullohet shuma ose dedikimi i mjeteve financiare për arsimin e mesëm profesional. Kështu, Qyteti i Shkupit ka miratuar Metodologji për shpërndarjen e bllokut të dotacioneve në arsimin e mesëm në Qytetin e Shkupit, Komuna e Tetovëska Vendim të Këshillit të Komunës, Komuna e Ohrit ka Metodologji për shpërndarjen e bllokut të dotacionit për arsimin fillor dhe të mesëm në Komunën e Ohrit (2012 dhe 2018), derisa Komuna e Strugëska marrë Vendim për përcaktimin e kritereve për shpërndarjen e bllokut të dotacioneve për arsimin e mesëm.

Të gjitha komunat që u përgjigjën në kërkesën për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik u përgjigjën pozitivisht në pyetjen e parashtruar se a kanë dorëzuar propozim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për numrin e nevojshëm të paraleleve, gjegjësisht nxënësve sipas profesioneve për vitin shkollor 2017/18.

**TABELA 45: FINANCIM I ARSIMIT PROFESIONAL NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE****Rekomandime**

- Komunat duhet të lidhen më mirë me shkollat dhe bashkësinë e biznesit në mjedisin e tyre dhe t'i identifikojnë nevojat e tyre reale për realizimin konsekuent të procesit arsimor.
- Duhet të përpilohen akte plotësuese që do ta rregullonin procesin e financimit të arsimit dhe trajnimit formal profesional nga komunat duke marrë parasysh specifikat e profesioneve.

## LITERATURA

- Dorléans, M. (2018). *Financing vocational education and skills development: A policy area for ETF support*. European Training Foundation. E kapshme në: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/financing-vocational-education-and-skills-development> [Qasje më 5 shtator të v.2018.]
- European Training Foundation (2015). *Cost and Financing Analysis in VET: Guidance note*. E kapshme në: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/cost-and-financing-analysis-vet-guidance-note> [Qasje më 5 shtator të v.2018.]
- European Training Foundation (2017). *VET governance partner country profiles - former Yugoslav Republic of Macedonia*. E kapshme në: <http://www.oecd.org/education/country-studies/41538706.pdf>. [Qasje më 5 shtator të v.2018.]
- Hoeckel, K. (2008). *Costs and Benefits in Vocational Education and Training*. Paris: OECD. E kapshme në: <http://www.oecd.org/education/country-studies/41538706.pdf>. [Qasje më 18 shtator të v.2018.]
- Hoftijzer, M., Stronkowski, P., & Rozenbaum, J. (2018). *Getting out of school and into the workplace: strengthening work-based learning in upper secondary technical education in Poland's Świętokrzyskie Region*. Washington D.C.: World Bank.
- Inter-agency Group on Technical and Vocational Education and Training (2014). *Proposed indicators for assessing technical and vocational education and training: working document*. E kapshme në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000260674> [Qasje më 25 gusht të v.2018.]
- Majumdar, P., & Teaero, T. (2015). *Research into the financing of technical and vocational education and training (TVET) in the Pacific : Kiribati : country report*. E kapshme në: [https://research.acer.edu.au/transitions\\_misc/20](https://research.acer.edu.au/transitions_misc/20) [Qasje më 11 shtator të v.2018.]
- National Comprehensive Center for Teacher Quality (2010). *Conducting a Cost Analysis for Educational Policies: Teacher Effectiveness*. E kapshme në: <https://gtlcenter.org/sites/default/files/docs/ConductingCostAnalysis.pdf> [Qasje më 3 shtator të v.2018.]
- Nikica Mojsoska-Blazevski, & Ristovska M. (2013). *Mapping of VET educational policies and practices for social inclusion and social cohesion Country Study: Former Yugoslav Republic of Macedonia*. European Training Foundation. E kapshme në: <http://www.lse.ac.uk/LSEE-Research-on-South-Eastern-Europe/Assets/Documents/Research/Research-Network/Research-Projects/Mapping-of-VET-Educational-Policies/FYROM-FINAL-Report.pdf> [Qasje më 11 shtator të v.2018.]

- Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë (2015). *Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor 2014/2015*. Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë
- Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë (2016). *Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor 2014/2015*. Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë
- Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë (2017). *Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor 2014/2015*. Shkup: Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë
- A. Isahi-Pallosi, L. Vasileska, L. Trpçeska, G. Spasovski, R. Stojkovska-Aleksova, dhe D. Crabtree (2014). *Inkluzioni në arsimin e mesëm profesional: doracak për punë me nxënësme nevoja të posaçme arsimore*. Shkup: Këshilli britanik në Maqedoni.
- Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë (2016). *Drejt arsimit inkluziv: raport nga hulumtimi i realizuar për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme në arsimin e rregullt fillor*. Shkup: Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë
- Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë (2018). *Përfshirje e fëmijëve dhe të rinjve me pengesë në arsimin e rregullt të mesëm: raport nga hulumtimi*. Shkup: Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë.
- Zh. Poposka, Z. Shavreski, dhe E.Kočoska(2015). *Ligjet dhe politikat e Republikës së Maqedonisë në fushën e pengesës*. Shkup: Hapni dritaret.

# SHTOJCA

## LIGJE

1. Ligji për arsim të mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018).
2. Ligji për arsim dhe trajnim profesional („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018)
3. Ligji për arsim të lartë, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 82/2018.
4. Ligji për entet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 32/2005; 120/2005 dhe 51/2011)
5. Ligji për Kornizë kombëtare të kualifikimeve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 137/2013 dhe 30/2016)
6. Ligji për Byronë për Zhvillimin e Arsimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 37/2006; 142/2008; 148/2009; 69/2013; 120/2013; 148/2013; 41/2014; 30/2016 dhe 64/2018)
7. Ligji për Qendrën Shtetërore të Provimeve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.142/2008; 148/2009; 41/2014; 55/2016; 142/2016 dhe 64/2018)
8. Ligji për universitete të hapura qytetare për mësim të përjetshëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 36/2011, 41/2014, 145/2015, 55/2016 dhe 64/2018)
9. Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 92/2007, 136/2011, 23/2013, 25/2013, 137/2013, 164/2013, 158/2014, 15/2015, 129/2015, 192/2015 dhe 30/2016)
10. Ligji për arsimin e të rriturve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018).
11. Ligji për shërbim pedagogjik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 18/2011, 41/2014, 55/2016 dhe 64/2018)
12. Ligji për marrëdhënie të punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018).
13. Ligji për libra shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018)

14. Ligji për zeytari, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 215/2015
15. Ligji për oda ekonomike, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.54/2002 dhe 84/2005
16. Ligji për inspektim të arsimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/2005 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 64/2018)
17. Ligji për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017

## DOKUMENTE STRATEGJIKE

1. Strategji për arsimin e të rriturve viti 2016-2020
2. Program për reforma në punësimin dhe politikën sociale 2020,
3. Strategji kombëtare për punësim 2016-2020,
4. Strategji kombëtare për të rinjtë viti 2016-2025,
5. Strategji për arsim dhe trajnim profesional në kontekst të mësimin të përhershëm 2013-2020 me plan veprimi,
6. Koncepti për modernizimin e arsimit teknik nga viti 2016,
7. Koncepti për arsim pas arsimit të mesëm viti 2010,
8. Koncepti për aftësim profesional nga viti 2010,
9. Konventa për të drejtat e personave me pengesë (KDPP),
10. Konventa për të drejtat e fëmijës (KDF)
11. Deklarata e UNESCO-s për arsim e bazuar në nevojat e posaçme nga Salamanka

## RREGULLORE, NORMATIVA, STANDARDE

1. Udhëzues për klasifikimin dhe kodimin e standardeve për profesion, viti 2017
2. Udhëzim për inspektorët shtetëror të arsimit për vlerësimin e përmbushjes së detyrave të punës të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në arsimin fillor dhe të mesëm
3. Metodologjia për përpilimin e standardeve të profesionit, viti 2017
4. Metodologjia për zhvillimin e standardeve për kualifikime, viti 2017
5. Normativ për kuadër mësimdhënës në arsimin e mesëm profesional, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, viti 2008
6. Normativ për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, viti 2008
7. Udhëzime për planifikimin e punës edukativo-arsimore të arsimtarëve sipas lëndëve profesionale në shkollat profesionale në RM, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional
8. Rregullore për kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve në shkollat fillore dhe të mesme sipas fushave
9. Rregullore për mënyrën e dhënies së provimit dhe vlerësimin të rezultateve të nxënësve në provimet e maturës shtetërore në arsimin e gjimnazit, atë profesional dhe të mesëm të artit

10. Rregullore për mënyrën e verifikimit të shkollës së mesme dhe për mënyrën e mbajtjes së regjistrave
11. Rregullore për maturë ndërkombëtare
12. Rregullore për kushtet dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e mesme publike
13. Rregullore e vëzhgimit, kontrollit dhe vlerësimit, dhënies së provimeve dhe avancimit të nxënësve në shkollën e mesme
14. Rregullore për mënyrën e mbajtjes, formën dhe përmbajtjen e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit në shkollat e mesme
15. Rregullore për mënyrën e dhënies së provimit dhe vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet e maturës shtetërore në arsimin e gjimnazit, atë profesional dhe të mesëm të artit
16. Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dosjes profesionale të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit profesional në shkollën e mesme
17. Rregullore për mënyrë e ndjekjes së mësimin, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të enteve të arsimit të lartë.
18. Rregullore për mënyrën dhe procedurën për ndarjen e diplomave për arsim të mbaruar të mesëm dhe për formularët e diplomave
19. Standarde për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve të punëdhënësit, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, viti 2012
20. Standard për kuadër profesional dhe kuadër tjetër për realizimin e trajnimit praktik të punëdhënësit, Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional, viti 2014

**TË ANKETUARIT**

Në tabelën janë përmendur institucionet prej të cilave janë grumbulluar informacione dhe të dhëna

SHKOLLA
SHMMQSH „Dr. Pançe Karagjozov” - Shkup
SHMQSH „Cvetan Dimov” - Shkup
SHMQSH “Vëllezërit Milladinov” - Shkup
SHMQSH “Marija KiriSkllodovska” - Shkup
SHMQSH „Shaip Jusuf” - Shkup
Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit “8 Shtatori” - Shkup
QAAM „Boro Petrushevski” - Shkup
SHMQSH “Vllado Tasevski” - Shkup
SHMQSH “Lazar Tanev” - Shkup
SHMQSH “Dimitar Vllahov” - Shkup
SHMPK “Ilinden”
SHMET „Mihajllo Pupin” - Shkup
QSHSHAR „Partenija Zografski” - Shkup
SHSHRFRSHD „Dimitar Vllahov” - Shkup
SHMSH për rehabilitim dhe arsim „Sh. Naumi i Ohrit” - Shkup
SHMK “Sh. Naumi i Ohrit” – Makedonski Brod
SHMK „Niko Nestor” - Strugë
SHMK “MirkoMileski” - Kërçovë
SHMK „Drita” – Kërçovë
QSHEMK „Sh. Naumi i Ohrit” - Ohër
SHKHT “Vanço Pitosheski” - Ohër
SHMPK „Sh. Kirili dhe Metodi” - Ohër
QMESHK „Dimitar Vllahov” - Strumicë
SHMK „Nikolla Karev” - Strumicë
SHMK “Josif Josifovski” - Gjevgjeli
SHMK “Goce Dellçev” - Vallandovë
SHMK “Kosta Susinov” - Radovish
SHMPK „Moshë Pijade” - Tetovë
SHMKM „Nikolla Shtejn” - Tetovë
SHMPK „Gjoce Stojçeski” - Tetovë

VETËQEVERISJE LOKALE
Qyteti I Shkupit
Komuna Ilinden
Komuna Tetovë
Komuna Strumicë
Komuna Radovish

Komuna Gjevgjeli
Komuna Vallandovë
Komuna Makedonski Brod
Komuna Ohër
Komuna Strugë
Komuna Kërçovë

PUNËDHËNËS I INSTITUCIONE
240 punëdhënëste të cilët është organizuar trajnimi praktik (Anketë elektronike )
Qendra për Arsimin e të Rriturve
Inspektorati Shtetëror i Arsimit
Qendra Shtetërore e Provimeve
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Qendra për Arsim të Mesëm Profesional
Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Vasill Gjorgov nr. 16 1000, Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut

